



# JEGHISHE ZARENC

Poezi

Përktheu nga origjinali  
Berzh Piranjani



**BOTIMET M&B**



JEGHISHE ZARENC

# POEZI

Përktheu nga origjinali  
Berzh Piranjani

Tiranë, 2022

Përgatiti për shtyp: Berzh Piranjani  
Redaktoi: Berzh Piranjani  
Art Grafik: Orest Muça

ISBN 9789928820006

Mundësuan botimin:  
Berzh dhe Varuzhan Piranjani

Çdo përdorim ose ribotim i këtij libri për qëllime komerciale ndalohet.

**BOTIMET M&B**

## Përmbajtja

Parathënie .....	4
Jeghishe Zarenc .....	5
Përmbledhje lirikash.....	9
Sajat Nova .....	9
Atdheut tim, Armenisë.....	19
1. Rrugës .....	21
2. Natës së pagjumë.....	22
3. Të vdekurit .....	26
Legjendë Danteske.....	27
Turma të çmendura (të dala mendsh).....	52
Ninullë vetvetes .....	62
Fjalë që nga larg .....	63
Përfytyrimi i vdekjes .....	64
Pa Titull .....	66
Pa Titull .....	66
Pa Titull .....	67
Me ardh për hatër të nënës .....	69
Kushtuar A.B. ....	70
Udhëtarët e rrugës së qumështit .....	72
Gjuha jonë .....	75
H.T. ....	76
H.T. ....	76
H.T. ....	76
A.M. ....	76
Shamiram.....	78
Poeti .....	80
Kalimtarit të rastësishëm.....	81
Artisti .....	82
Vjeshtës.....	83

Pagjumësi.....	84
Kujtimit të Vahan Derjanit.....	87
Soneti i kuq.....	89
Zarenc Name.....	91
Nëpër katër anët e historisë.....	116
Poema.....	116
Davidi i Sasunit.....	116
Përballë grumbullit Masis.....	145
Lavdi rrushit, verës dhe edukimit të mire.....	153
Elegji dhe poezi të tjera.....	168
Mëngjes Epik.....	168
Muzës.....	169
Këngë të djegura.....	170
Kënga e Oqeanit.....	170
Poetit të vdekur.....	174
Dy sonete kujtimit të Arpikut.....	175
Në hollin e pallatit të dimrit.....	177
Vahagut.....	178
Atila.....	179
Elegji, shkruar në Venedik.....	182
Kapedan Shavarshi.....	197
Vizioni i vdekjes.....	211
Pa titull.....	213
Muzës.....	214
Homo Sapiens.....	219
Djali me flokët kaçurrela.....	224
Nëpër udhëkryqet e historisë.....	227
Nausikës.....	237
Ylberi.....	245
Nga tmerri i rënies.....	246
Letër mikut tim poet, N.N, shkruar nga Erevani.....	248
Në Atdhe.....	254

## Parathënie

Jeghishe Zarenc është një nga majat më të larta të letërsisë Armene shumëshekullore. I ka kënduar Armenisë dhe forcës krijuese të popullit Armen, të shkuarës së lavdishme, episodeve historike tragjike, të ardhmes së ndritur.

Kuptimplotë janë fjalët e mrekullueshme përmbyllëse të Mardiros Sarjanit për të: “Nairi lindi Zarencin... pa piktura dhe germa të skalitura në shkëmb, pergamena me lule zbukuruar dhe tempuj të derdhur, por brenda detit të gjakut dhe detit të dhimbjes... ngriti kokën, pa diellin që shkëlqente... Dhe për të pastruar lotët e Atdheut të tij u zhyt në furtuna dhe kërkoi rrugëdalje”.

Jeghishe Zarenci në kohën e vet kryesisht ju kushtua aktivitetit të krijimit të teksteve mësimore; ka trajtuar çështje dhe parime për krijimin e teksteve shkollore dhe letërsisë për fëmijë në përgjithësi; atë detyrë ai e kreu me përgjegjësi dhe me bindjen e thellë, që me to duhet të merren vetëm artistë të nivelit të lartë, shkrimtarë, piktorë, edukatorë fëmijësh, botues, dizenjatorë, libralidhës, etj.

## JEGHISHE ZARENC

Jeghishe Abgar Solomonian (*Եղիշե Աբգար Սոլոմոնյան*) lindi më 13 Mars 1897, në Kars, në një familje që merrej me tregti qilimash. Në vitet 1908-1912 mësoi në shkollën reale të vendlindjes, ku edhe provoi për herë të parë të shkruante. Nuk arriti të marrë arsimimin e lartë. Për një kohë të shkurtër u regjistrua si student në Fakultetin e Letërsisë të themeluar nga Valeri Brusov. Në sajë të fuqisë së talentit, si edhe të punës së tij të pavarur u pajis me njohuri të shumta dhe të përgjithshme: “Oh, bota e letësisë është si një univers i pafund”, - ishte ky një përgjithësim i përpjekjeve personale të tij.

Fillimi i rrugës së tij letrare është përmbledhja e titulluar “Tre këngë vajzës me fytyrë të zbehtë nga trishtimi”, e përbërë nga tre vjersha (Kars 1914). Botimin e parë poezia e pa, fillimisht me qëllim inkurajimi për të ardhmen, në almanakun “Rini” (Tiflis, 1912. - Shënim B.P: Tiflis = Tbilisi i sotëm në Gjeorgji). Në verën e vitit 1915 ishte ushtar në grupimin ushtarak (ushtrinë) të vullnetarëve Nr. 6 të formuar në Kanakerum dhe bashkë me të mori pjesë në betejat për çlirimin e Armenisë, duke arritur deri në Van dhe Bitlis. Nën ndikimin e realitetit të vështirë të luftës shkroi poemën “Legjendë Danteske” (Tiflis, 1916).

Në fund të vitit 1916 arriti në Moskë, duke hyri si dëgjues i jashtëm në Universitetin e Shaniavskit. U krijuan dhe u përfunduan poezitë “Soma” dhe “Turma të çmendura”, të cilat, gjithashtu, u botuan si broshura më vete.

Në periudhën e Republikës së Parë Armene punoi si mësues në një fshat të vogël, të quajtur Bashkladiklar, në periferi të Karsit. Pas një referati të famshëm të Ministrit të Kulturës dhe Artit, Nikol Ahpaljan, u kthye

në Jerevan, duke u vlerësuar nga ana e ministrit me një pritje të ngrohtë dhe me emërim në ministri.

Zarenci ju përkushtua punës letrare-kulturore duke e kombinuar atë me punën krijuese. Në jetën e poetit një ngjarje e rëndësishme ishte dalja në dritë e botimit të veprës letrare “Përmbledhje letrare” nëpërmjet shtëpisë botuese shtetërore në Moskë. Krahas me botimet e reja (“Poemë mbi poemat – *Удѣлуууѣту*”, “Zarenc-name”, “Zjarr përvëlues - *Ողջալիզիլնի լրալի*”, “Libër këngësh”, etj.) në të ishin përfshirë gjithashtu edhe vepra të tijat të botuara më parë. Përmbledhja ishte tërësia e një aktiviteti dhjetëvjeçar. Përgjatë këtyre viteve ishte krijuar, gjithashtu, novela poetike “Toka e Nairit”, e cila për prozën Armene është një nga vlerat më të shënuara të saj.

“Kapedan Shavarshi” (1928) ishte një arritje krijuese, fillimi i një estetike të re, e cila u shfaq në formën e saj të përkryer në përmbledhjen “Agim epik”, (1930).

Atmosfera letrare dhe politike sa vinte paraqitej më e errët; rradhët e shkrimtarëve Armenë po rralloheshin,

Ka zbritur sot i tërë Heligoni

Këngët Nairiane – në bodrumin sterrë të zi...

Rreth emrit dhe personit të poetit të izoluar sa vinte e rëndohej atmosfera e thashethemeve të brendshme dhe akuzave politike. Ai u arrestua më 27 korrik 1937. Zarenci në kohën e hetuesisë poshtëruese i mbeti besnik ndërgjegjes së tij letrare dhe politike

Mardiros Sarjani në të gjallë të Zarencit ishte i afërt me të, ishte adhures i flaktë i talentit të pakrahasueshëm të poetit. Dashurinë dhe adhurimin për Zarencin piktori i talentuar e kishte shprehur që në vitin 1923, duke zbuluar në poetin 26 vjeçar, portretin e atij, që me vështrim të fiksuar shihte të ardhmen si të ishte një depërtues në universin e pafund. Krahas vizatimit të portretit, maska e paraqitur simbolizon pafundësinë dhe përjetësinë, me të folurën e pakuptueshme të sfinksit Egjiptian, dhe në të njëjtën kohë shpreh një shqetësim, përkundrejt një të ardhmeje plot trazira. Theksohet nënteksti i thellë i krijimtarisë.

Sarjani në mënyrë novatore është përpjekur të na e tregojë duke zbuluar thelbin e imazhit, duke e paraqitur Zarencin jo vetëm në momentin e dhënë, por edhe brenda procesit të zhvillimit. Portreti i

poetit pa dyshim është i vërtetë dhe plot ndjenjë. Ai shpreh një shpirt të brishtë dhe të ndjeshëm, që e depërton me mprehtësi thellë botën që na rrethon. Në qendër të vëmendjes së Sarjanit është bota e brendshme e ndërlikuar, kontradiktore dhe e pasur e Zarencit. Bukuria e portretit të pikturuar me mjeshtëri, dashuria dhe respekti i madh për Zarencin dhe Sarjanin shpëtoi kanavacën nga shkatërrimi gjatë diktaturës së Stalinit.

## PËRMBLEDHJE LIRIKASH

**Arpigut**

*Si rebel mos më qëndro, fol me mua,  
Si det me dallgë gjeminë ma ende;  
Si Sajat-Nova nuk do më shohësh, po vdes!*

### **Sajat - Nova**

\* \* \*

Gjithë ç'ka zjarr në shpirtin tim – gjithçka për ty,  
Gjithë ç'ka zjarr në gazin tim – gjithçka për ty,  
Gjithçka të jap, ta dhuroj, asnjë thëngjill të mos më mbetet,  
Që dimrit të ftohtë ti të mos mërdhish, – gjithçka për ty!

\* \* \*

Verës, i ëmbël, zheg i zjarrtë je, xhan,  
Stolis, arom' sheg' e portokall je, xhan,  
Dhe kur qëllon që ashpërsisht më vështron  
Si lajm i vdekjes së shpirtit më je, xhan!

Një ëndërr pashë. Prej Sajat-Novës pranë më erdhi me lirën në dorë,  
Me tasin e pruar të verës që kuqëlonte porsi zjarr në dorë,  
U ul, këngë t'ëmbra këndoi, me copën e perçes së vjetër në dorë.  
Dhe këndoi, a thua kupën e përflakur qiellore kish në dorë.  
Dhe këngët vijnë butë – butë; posi “hyri” mbuluar hyjni dhe atlas,  
Brenda ëndrrës më erdh' bukuroshja, ajo vet' ish ëndërr e ëmbël, plot gaz,  
Mbuluar me nur, shpirtin e Sajat-Novës e mbushi me fruta dhe fjal'afsh,  
Qëndroi – mbeti, me perçen arqëndisur hequr nga fytyra në dorë.

Dhe pa – dhe pa nga Sajat-Nova; i trishtuar porsi re e zezë ka mbet'.  
Dhe tha - Zarenc,- nga kjo bukuroshe veç një thëngjill i vjetër në shpirt ka mbet'.  
Shpirtin ma dogji, në pluhur e hi ma shndërroi, vetë zjarr e flakë mbet',  
Mos prit, pran' teje mere ti, që të vijë me flokët e artë në dorë.

Kaq u tha prej Sajat-Novës dhe u ngrit, u ngrit nga vendi; vrrenjt' si nata zi,  
Shkoi përsëri trishtuar dhe heshtur, në shpirt njëmij' maraze dhe dashuri,  
Ëndrra mbaroi, por ti mbete, figura jote e shtrenjtë ndriçuar mbet',  
Vetëm mbet', me lirën e Sajat- Novës në dorë, edhe shpirti im i shkret'.

Tregimtar si Sajat-Nova, këngë dhe ninulla un' do t'ju flas,  
Ditë e natë do të këndoj dhe gjithë ç'ka zemra do t'ju flas,  
Dhe për at' shpirt, që dashuri dhe këngë dashurie brenda mban,  
Dhe për at' shpirt si kopësht plot fruta parajsore un' do t'ju them.

Si yll me veshje vezulluese, përballë si ëndërr më dole ti,  
Pasioni yt zjarr ndezi në shpirtin tim si frymëzim i pakufi,  
Me erë të mirë shpirtin ma mbushe – si Vartastani, si Shirazi,  
Cilido qoftë frymëzimi, bukuroshe, - këngës me gaz do t'ja them.

Një shportë është bota, bukuroshe, - aty brenda qëndron edhe ti,  
Si lule e çelur, me vesën e mëngjesit paraqsor mbuluar ti,  
Në çastin kur brenda lagjes së shenjtë të Havlabarit më shfaqesh ti,  
Atë çast lotit të ëmbël të shpirtit vesë qiellore do t'i them!

Ja më dil, fytyrën të ta shoh njëherë, - trëndafil je, bukuroshe,  
Në këtë jetë boshe, për shpirtin tim e paçmuar je, bukuroshe,  
Dhe vendosa, që mos të them, njeri si unë je dhe ti, bukuroshe,  
Dhe që të më mbetet shpirti me ty, ah dhe uh do psherëtitj, po të them!

\* \* \*

Një bukuroshe të paçmuar pashë – në qytetin e Gjeorgjisë,  
Në qafë lule dhe nishan i pashë - në qytetin e Gjeorgjisë.

Në rrugicën e gjerë kish qëndruar, me petka atlas mbuluar,  
Kryet stolisur ar dhe shall i pashë - në qytetin e Gjeorgjisë.

Si vello e artë mbi fytyrë rrezja e diellit i kish rënë  
Buzë të kuqe gjak, plot afsh, i pashë – në qytetin e Gjeorgjisë.

Shkova, me sy e dogja, desha t'i them, si shpirt më je, edhe më shumë,  
Një shkëmb qëndruar para meje pashë – në qytetin e Gjeorgjisë.

Tani po thurr këngë hidhërimi, a thua është zjarr pasioni,  
Një dashnor të pavdekshëm unë pashë – në qytetin e Gjeorgjisë.

\* \* \*

Të binte zurnaja dua tani – të pi, të dehem gjer' në të gdhirë,  
Me çdo njeri mik le të bëhem – dhe i çiltër të jem gjer' në të gdhirë.

Në pajton qëndruar, rrugicës kaloj, që nga ballkoni të më shohësh,  
Dhe frymëzimi nga shpirti të më zbresë – lot të derdh gjer' në të gdhirë.

Erës, flladit mendtë ja dhashë, ndër vreshta e pijetore do të zbres,  
Për tryezat e shokëve, bukë e ver' do të jem, gjer' në të gdhirë.

Po shkoj – në prehër bukuroshesh të tjera kokën e nxehtë ta vendos,  
Dhe në atë të ëmbël shoqëri, do pi, do dehem gjer' në të gdhirë.

\* \* \*

Un' një dyqanxhi i pirë jam – brenda dyqanit më s'mbeti gjë,  
Me të gjithë u shtrova në sofër, sulltan, vezir, khan, - kush nuk mbet',  
Por vendin më të madh ta dhashë ty, këngë hyjnore të thurra,  
Bukuroshe, shpirt, zemër, tjetër ç'ti them të dashurës, - tjetër s'mbet'.

I lashë të gjitha, gjithçka kisha, porsi fllad më rrodhi kjo jet',  
Frymëzimi më erdh', ma preu rrugën porsi i Indisë det',  
Pijanec, shërbëtor turme u shndërrova si Sajat-Nova poet,  
I përmalluar prita fjalën tënde, tjetër gjë nuk më pat' mbet'.

Unë një dyqanxhi i pirë jam – brenda dyqanit gjë më s'mbet',  
Bukuroshe, shpirt, zemër, tjetër ç'ti them të dashurës, - tjetër s'mbet'.

\* \* \*

Në njerën dorë kam vodkë, në tjetrën verë kam.  
Të dyja për shëndetin tënd i pi, bukuroshe.  
Prej sulltanit, khanit, e dashur dëshpëruar jam,  
I ëmbël më vjen frymëzimi yt, bukuroshe.

Për shpirtin tim ëndërr e ëmbël më je ti tani,  
Ëndërr e shenjtë brenda gjumit më je ti tani,  
Larg prej meje – në Vartastan, Shiraz, më je tani,  
Nuk shuhet flaka e frymëzimit, bukuroshe.

Në njerën dorë kam vodkë, në tjetrën kam verë.  
Të dyja për shëndetin tënd i pi, bukuroshe.  
Frymëzimi shpatë le të bëhet, shpirtin tim le të ma nxjerrë –  
Në shpirtin tënd dashuri e ëmbël le të mbesë, bukuroshe.

JEGHISHE ZARENC

\* \* \*

Sa herë dëgjoj të bien këmbanat – ndër mend më vjen ti,  
Si tingull i ëmbël, ledhatare më je, bukuroshe.  
Sa herë afron pranvera – bashk' me të më vjen edhe ti,  
Si ujë pranvere vrullon vërshimi yt, bukuroshe.

Për këdo, endacak nëpër botë do të jem un' tani,  
Bartës i emrit tënd nëpër botë do të jem un' tani,  
Si fije letre nëpër botë do të jem unë tani,  
Si erë pranverore më valvite, ti, bukuroshe.

Akoma s'e ke kuptuar, çfarë je duke më bërë,  
Nga afsh i dashurisë mijra njerëz në varr po dërgon,  
Frymëzimi - pendë e artë, shpirti - fletore është,  
Humbje e shkruar me germa gjaku më je, bukuroshe.

\* \* \*

Sot rrugicës ton' kalove – buzët kupa vere ishin,  
Flokët si mëndafsh i artë, – sytë si almas të ishin

Shtangur mbeta në rrugicë, sytë turbull, kuq si vera,  
Mbi kryet tënd lodronte dielli, petkat rrezatonin.  
Vështrimin tënd kapa me sy, m'u duk se ish me dashuri,  
Faqet e tua, flakë të kuqe, porsi zjarri, skuqnin.

Tek këmbët desha të bie, por në vend i shtangur mbeta,  
Mbi ato faqe kuq si zjarr' syt' e tu të huaj ishin.

\* \* \*

Buzët e tua si porcelan i praruar mbushur plot zjarr janë, shpirt,  
Fjalët e tua pije paradisi, verë e pavdekshme janë, shpirt.

Sot do shtroj sofrën në shtëpi, qejfin do t'i bëj frymëzimit që më jep ti,  
Çfarë bëhet, në dhomë po të më vish, qoft' dhe herë e vetme të jetë, shpirt?

Qilimat më të bukur për ty do t'i shtroj, lule plot i kam mbuluar,  
Nën këmbët e tua, të dëshiruar presin – mbret mbi mbretër, khanë, shpirt.

Sytë e mi zjarr le të ndizen, dritë për vendin e shenjt' ku lahesh ti  
Defin dhe zurnanë kam përgatitur, përse të duhen mendimet, shpirt?

Po deshe ti, shpirtin të lirë po e le, zemrën nën këmbë ta vendos,  
Nga zemra ime gjak po më rrjedh – folmë, çfarë të duash do të bëj, shpirt.

\* \* \*

Pranvera vjen përsëri, lulja lulëzon,  
I dashuruari vazhdon mbetet po ai.  
Kalojnë vitet, me to njeriu ndryshon,  
Këng' e bilbilit mbi shkëmb mbetet përsëri.

Një tjetër bilbil në kopsht vjen e hyn me turr,  
Një tjetër poet gëzimit këngë i thurr,  
Çfar' s'arrij ta them un' – nesër e thotë ai.  
Ditët bëhen tym, vitet mbesin përsëri.

Mijra lule mbi këtë botë lulëzojnë,  
Mijra sy mbi këtë botë rrin' e vështrojnë,  
Mijra shpirtra mbi këtë botë lëngojnë,  
Pasioni bëhet zjarr, veç hiri mbetet.

Për një tjetër zemër temjani po tretet,  
Zambaku po çel, dhe lulet shtat po hedhin,  
Bukuroshja qan, dhe pik' e lotit që rrjedh –  
Mbi gur-mermer të varrit tim do të mbetet.

\* \* \*

Njëmijë e një libra lexova – libër të mençur nuk hasa,  
Njëmijë gra un' përqafova – përqafim dashuror nuk hasa.

Shkova larg deri në Francë, ku këngë dëgjova dhe poezi,  
Dhunti qiellore si dhunti e Sajat Novës kund nuk hasa.

Me varfanjakë u ula, me shërbëtorë qëndrova të pi,  
Në fjalët që nxorrën nga goja, një pikë të vërtet' nuk hasa.

Njëmij' bukuroshe ma dogjën shpirtin, me të gjitha rash' në dashuri -  
Më të zjarrt' e përvëlues se i shenjt'i përqafimi yt nuk hasa.

Në çdo vend ku fruta shihja, fytyrën e rrotullova me kërshtëri,  
Në vreshta rashë, frut më të mirë e më të ëmbël se ty nuk hasa.

\* \* \*

Këndova çdo lloj kënge – më e mira ninulla ish përsëri,  
Loja hyjnore, e pavdekshme, e Sajat Novës ish përsëri

Ashtu si në dyqanet e mëdhenj lloj – lloj frutash rradhitur rrin',  
Vend për frutat e pavdekshme – kopsht' i princeshës mbetet përsëri

Lulet vendosur mes kopshtit, sa mirë me ujë t'i ujisësh,  
Uji nga lulet marrë – vesë e mëngjesit kthehet përsëri.

Shko, po deshe, edhe në Francë, pallatet më madhështore shih,  
Po shpirtit m'i dashur vend – kopsht' i së dashurës mbetet përsëri.

Vaj për ty, Zarenc, pata të drejtë, vesh i vura së dashurës,  
Nga gjithçka m'e ëmbël rrugic' e së dashurës m'është përsëri.

\* \* \*

Sado të thërrasësh e vargje të thurrësh, mblidhe mendjen, mjaft është përsëri  
Edhe pa të dashurën e paçmuar bot' e madhe e mir' mbetet përsëri.

Çfarëdo të veshë, mëndafsh a atlas, fytyrën kuq, bukuroshe të bëhet  
Shpirtin gjelave t'ja u nxjerrë, e dashura jote, pulë mbetet përsëri.

Çfarëdo fanti apo zari të kesh, çfarëdo aftësi apo shans të kesh,  
Për shpirtin e dashuruar veç një anije e pashpresë mbetet përsëri.

Më e pakta - dashuro, në përfaqime zhytu, në kafaz të artë futu,  
Afshi i dashurisë për shpirtin një dhimbje e pashuar mbetet përsëri.

Vaj për ty, Zarenc, pata të drejtë, ngulite fort mirë në at' kokën tënde  
Fjala më e shenjtë për një grua - tradhtare gjakpirëse - mbetet përsëri.

\* \* \*

Tashmë të shumt' janë këngëtarët – vargje të shpirtit më nuk gjen,  
Kudo sot gjen budallallëkun, muzikë të shpirtit më nuk gjen,  
Kudo hedh këmbën – kopësht mund të gjesh, kopësht princeshe më nuk gjen,  
Bredhur kam pallat më pallat – si lagj' e së dashurës kund nuk gjen.

Kujt t'i këndoje unë tani, as ti nuk do, as edhe shtriga s'do,  
Të paktën prej t'ëmlave ninulla gishtin që flet mos e largo.  
Askush veshin s'ma vuri, por ti rënkimin e shpirtit tim dëgjo,  
Do desha shpirtin ta freskoj, vesën e lotëve më nuk e gjen.

Po them ta lë sazën mënjane, si gjith' njerëzit le të bëhem,  
Lule të jem – gjemba të kem, lule e paprekshme le të bëhem,  
Me armiqtë armik të jem, me të këqinjët i keq të bëhem,  
Malli për mua kur t'i marr', të thon', në tryezë kripë nuk gjen.

Njerëzit - kokrra rëre, bota është e gjerë, e mirë, Zarenc,

Fjal' e njeriut për shpirt'n e njeriut - dhimbje që s'shuhet, Zarenc,  
Fjalës së vyer vëri veshin po të them, se të mjafton, Zarenc,  
Ty nuk të duan, përderisa për shpirtin tënd shpirt në lagje s'gjen.

\* \* \*

Kur hyra me këngë në këtë bot' të vjetër, me saze – me fyell,  
Ç' do bëjë në këtë botë ky budalla i mjerë, - kështu thanë.

Kur turmës së qejflinjve këngë të ëmbla me shpirt u këndova,  
E ëmbël fjala jote, si përqaftim i verës, - kështu thanë.

Por për qejflinjtë e pashpirt' një vetmitar i trishtuar mbeta,  
Desha t'i lë, të largohem, - krenar dhe i keq është', - kështu thanë.

Nga dhimbja e shpirtit dhe i pashpres' një kupë raki un' piva,  
Pijanec - ky Zarenci, pijanec dhe i marrë, - kështu thanë.

Dhe dimrit në stuhin' e borës – këmbëzbathur, lakuriq mbeta.  
Jashtë - dimër, por brenda shpirtit tënd verë është, - kështu thanë.

U thash'- të pashpirt njerëz jeni ju, s'ma shihni trupin kruspullosur?  
Në këngë i paepur është' shpirti i Zarencit, - kështu thanë.

Pastaj vetëm qeshën, u gajasën, kur mbeta ashtu lakuriq.  
Në shekuj do shijohen ato këngët e tua, - kështu thanë.

\* \* \*

Bahçen kaluan, me vete aromën morën, sa keq, lulen s'e vunë re,  
Vështrim të thatë e të zbrazët hodhën, thelbin, shpirtëroren s'e vunë re.

Erdhën në shesh këngën të dëgjojn', dhe të pandjeshëm u larguan përsëri,  
Nga shpirti im një grep kisha hedhur në të, shpirtrat e tyre s'e vunë re.

U thava si fushë e shkretë gjatë verës, gjithë ç'kish mbetur shpirt dhe zjarr,  
Me bastunë të artë kapardisur, fushën e pafund hiç s'e vunë re.

Motër, e dashur, njeri i huaj, mik dhe i panjohur, të gjithë ata  
Pran' më kaluan, nën tingujt e këngës njeriun e gjallë s'e vunë re.

\* \* \*

Tani endem i pastrehë, ditë e natë këngës po ja them,  
Harruar kam emrin e afshit tënd, me dyshim, - plagë po ja them.

Afshi - dashuri e vjetër është', bukuroshe, si zjarri të djeg,  
Dhe dorën që jep kjo dashuri, dorë princeshe emrin ja them.

Rënkim nuk kam brenda shpirtit tim, si figurë e së dashurës  
Dashuroj hirin e shpirtit tim, frut i pavdekshëm emrin ja them.

\* \* \*

Nëpër botë një ditë do marr një rrugë pa kthim dhe do të shkoj,  
Pas nuk do të shoh, nuk do kërkoj lavdi dhe shpërblim, veç do të shkoj.

Prej këngëtarit Sajat Nova, unë prej tij këtë mësova,  
Që në këtë botë, ëndërr dhe lot', gjithçka është e kot' – prandaj po shkoj.

Sa për atë, që me zjarr'n e shpirtit e me mall e dashurova –  
Me erën le të shkojë, gjithçka tjetër do ta harroj – dhe do shkoj.

Dhe shkëlqim'n e bukuroshes, fytyr'n e përgjumur dhe të ëmbël  
Do ta harroj ... një grusht dhe të njomë me vete do marr dhe do shkoj.

Njeri i huaj për këtë jetë, i panjohur dhe pa emër,  
Këngët e mia po ju lë, ëndrrën e jetës time - dhe po shkoj.

## ATDHEUT TIM, ARMENISË

Njëmijë e një plagë ti ke parë – akoma do të shohësh,  
Mijra duar të huaja ke parë – akoma do të shohësh.

Ashtu si gjatë korrjes së verës duajt në fushë shpërndarë,  
Me mijra viktima në të ke parë – akoma do të shohësh.

Me kokën e rrahur nga era e thatë si e endacakut,  
Shumë ke parë për mijravjeçarë - akoma do të shohësh.

Të Narekacit, Shnorhalit, Nagash Hovnatanit vepra ke par' –  
Çfarë gjenish, mendje ndritur ke parë - akoma do të shohësh.

Tokë e Armenisë, që Zarencit tënd gjuhë dhe zë i dhe,  
Njëmijë e një këngë ti ke parë - akoma do të shohësh.

\* \* \*

Fjalën e ngrohtë si rreze-diell të Atdheut tim të ëmbël e dua,  
Tingullin vajtues të lirës së vjetër, telin me lot lagur e dua,  
Aromën e pemëve dhe luleve që përhapet si dielli kur lind,  
Dhe vallen e vajzave shtathedhura Nairiane\* unë e dua.

E dua qiellin tonë gri, ujët e kristalt', liqenin e ndriçuar,  
Diellin gjatë verës dhe dimrit stuhin' e borës, që gjëmon madhërisht,  
Muret e zinj aspak mikpritëse të kasolleve zhytur n'errësirë  
Dhe gurët mijravjeçarë të qyteteve tona të lashta i dua.

Kudo që të jem – kurr' nuk do i harroj unë këngët tona vajtimtare,  
Kurrë s'do harroj lutjen e shkruar me germa metali në librat tanë,  
Sado fort që të ma dërmojnë shpirtin tim plagët tona që kullojnë gjak  
Përsëri un' Atdheun tim të dashur, jetim dhe të përgjakur, e dua.

Për shpirtin tim të pikëlluar asnjë tjetër ngushëllim tanimë nuk ka,  
Si ball i Narekacit, Kushagit, me drit' kurorëzuar tjetër nuk ka,  
Bridh kudo nëpër botë, - si balli i bardhë i Araratit kund nuk ka,  
Si simbol të lavdisë së paarritshme, un' shkëmbin tim Masis e dua.

Nairi \* - krahinë pranë Liqenit Van (Në Turqi)

*Tre këngë vajzës me fytyrë të zbehtë nga trishtimi*

**Astik Gontahçjanit**

*Dhe ishte dashuria e fundit*

*E mbrëmjes së lashtë...*

**Albert Samain**

## **1. Rrugës**

Tundej karroca tek ecte me shpejtësi  
Nëpër rrugët plot llucë, fushës mespërmes.  
Binte shi pa pushim, ish ftoht' dhe lagështi.  
E trisht' po mbyllej dita dhe si me përtës'.

Tundej karroca tek vraponte-vraponte.  
Nëpër dhëmbë karrocjери diç këndonte.  
Një grua pranë meje kollitej hidhur.  
Lindje, perëndim, nata po i pushtonte.

Binte shi pa pushim, ish ftoht' dhe lagështi.  
Sorrat krakarishnin duke fluturuar.  
Gruaja e sëmur' qau me ngashëri.  
Era kaloi, dikë duke vajtuar.

Dhe karrocjери vazhdonte ashtu nën hund'  
Atë këngë pa ngjyrë të kohës së vet.  
Po shkonim. Ku? – s'e di. Nuk dukej të kish fund.  
Dhe ne shkonim. Pa fjalë. Pa zë. Dhe pa fjet' ...

## 2. Natës së pagjumë

Nuk arrij të fle...

Tani, kur aq shumë dua të fle,  
Gjithçka, gjithçka nga mendja ta largoj.  
Mendimet çliruar enden në heshtje;  
Dhe mendja, e çoroditur, bre dh e trishtuar  
Nëpër fushat e errta.

Në errësirën e natës dritë e llambadhes  
Qan me ngashërim, si agoni  
E vajzës që po vdes ..  
Në dyert dikush troket kalimthi;  
Dhe unë të kujtoj ty.

Si tingulli i këngës së harruar  
Drita e shpirtit më del nga poshtë gishtave  
Dhe pastaj një nga një rreshtohen përballë meje  
Figura, fytyra, që kishin humbur  
Pa lënë kujtim.

Atje, brenda errësirës, ja ku shfaqet  
Pamja jote e zbehtë dhe e trishtuar,  
Që ditëve pa emër nga mjegulla del  
Si visitore e zbehtë.

Dhe më kujtohet një ditë me shi,  
Një mbrëmje e largët;

Nga larg zhurma e këngëve gazmore,  
E dasmorëve në festë;  
Poshtë pikave të shiut që binte  
Aty po qëndroja unë ...

Eh, të flesh, të flesh ...  
Sytë i mbyll dhe fort i shtërngoj  
Dhe për asgjë nuk mendoj.  
Vallë, ndonjëherë a nuk kemi qenë bashkë ?!  
Ah, këngë thurra, heshtje dhe këngë,  
Të fle dua, nata po mbaron ....  
Çfarë - ëndërr, kllapi, apo dhimbja më mundon?

Dhimbje, dhimbje ish, pa dyshim,  
Ti kurrë, kurrë s'më buzëqeshe;  
Buzëqeshja yte veç dhimbje derdhte  
Në të dobtin shpirtin tim ...  
Un' ty të thirra, të thirra pa pushim,  
Kurrë, kurrë nuk erdhe ti,  
Dhe ndërsa dëshirova si rob i bindur  
Pranë teje të ri,  
Me dashurinë time të solla veç mërziti...

I huaj më ishte shpirti im për ty, ashtu si  
Dhe buqeta e luleve sjellë nga fusha të huaja,  
Lule dhimbjeje, lule vuajtjeje,  
Yje ëndërrimesh, shkëndija shpresash;  
Dhe lulekuqe të kuqe, të kuqe si dhimbje e ngratë,  
Me këto lule shpirtin zbukuruar ta solla si dhuratë,

Që shpirti yt i virgjër ta pije bashkë me dhimbjen ...  
Dhe s'po arrij ta kujtoj, se si një ditë,  
I huaj, pa njeri,  
Në prag të jetës së re të humba unë ty ...

Jo, ti ike, s'e di se ku.  
Ika edhe unë. Pikërisht atje  
Ku ti jeton prej një kohe të gjatë,  
Por s'munda të jetoj;  
S'ishte e mundur të shiheshin dritat e shtëpisë tënde,  
S'ishte e mundur të shihej e madhja rrugicë e jotja,  
Të cilat deri më tani s'kam mundur t'i harroj ...

Ta lëmë, ah, çfarë halli,  
A thua s'e di, se di askush,  
Përse në jetë kështu ndodh?  
Dashuria për ne – lot' edhe gjak,  
Dashuria për ne si çmim vdekjen ka,  
Kurse për gruan – lojë që me dehjen ngja' ...

Në këtë mbrëmje të heshtur e të pagjumë,  
Ah, nuk dua përsëri të rikujtoj  
Të shkuarën e pa mend dhe pa ngushëllim;  
Dhe, ti, përse më vjen ashtu pa pushim  
Dhe netëve të vona dëshiron të më shposh  
Në të dobtin shpirtin tim ?...

Prandaj ke ardhur ti këtu,  
Moj shfaqje tinëzare?  
Dëshiron në plagët e shpirtit tim të gërmosh,  
Thesaret e të cilit nuk deshe t'i pranosh? ...

O grua e paftyre, -  
Këtë shpirt të pavlerë, të kotë e me vese, ke nevojë  
Ta qeshësh, ta përqeshësh, të tallesh me të ti;

Dhe unë me gjithë shpirt nga dufi ulërij! ...  
Dëshiron, të të tregoj, se si papritmas  
Për mua ndryshoi gjithçka, çdo gjë,  
Dhe unë e humba rrugën e ëndrrës? ...

\* \* \*

Një mbrëmje binte shi. Ishte errësirë.  
Errësira kishte zbritur mbi shpirtin tim të nxirrë.  
Vetmia qante me gulçim atje  
Në të vjetrin, të pakthyeshin vend të ëndrrave.  
Dhe dola jashtë. Dhe eca gjatë  
Rrugëve me baltë.  
S'e di, se për ku, tashmë për mua  
Rrugë nuk kish...

Eca gjatë.  
Dhe, ja, ku përballë meje – një rrugicë e gjatë.  
Nga larg – në të verdhë, zjarre të turbullt.  
Dhe ju afrova atyre zjarreve,  
Të cilët një lajm të vjetër në shpirt më sollën ...  
Një lajm të vjetër, një sekret brenda shpirtit tim ruajtur;  
Dhe unë atë prag ngadalë e kapërceva, i ndruajtur ...

Dhe ... kjo më kujtohet,  
Një shtrat i vjetër – varrosur në mjegull.  
Dhe një trup lakuriq.  
Dhe e qara ime me gulçim, e trishtuar, ndrydhëse ...  
Dhe dola jashtë.  
Ishte ftohtë, erë, ndjeva të dridhur;  
Dhe kuptova, që jeta për mua ish një shaka e hidhur ...

Për mua vdiq çdo shenjtëri.  
Shko, e dashur!  
Le të hedhë jeta mbi kokën time furtunë e stuhi  
Le të derdhë edhe hi;  
Dhe s'kam asnjë pendesë që ëndrrën e vjetër  
Ta kthejë përsëri ...  
Shko, e dashur;  
Dhe më lejo për një çast nga mendja të të heq, -  
Dua të fle – ah, si mund të fle kështu, si pa të keq?!...

### **3. Të vdekurit**

Mbrëmja ishte e lagësht dhe me shi.  
Rrugët – të shkreta, zhyt' në qetësi.  
Dhe era në to kalonte vrullshëm,  
Një erë e fortë plot lagështi.

Dhe mbrëmja zhytej në errësi;  
Dhe në terr, nga larg, ca hije duken  
Që rreth zjarreve të rrugës enden,  
Dorëzuar turpit dhe mashtrimit.

Dhe ecja un' i heshtur, pa fjalë,  
Me vete emrin tënd duke thënë.  
Nga larg dëgjova dikë q'u zgërdhi  
Si nëpër ëndrrën e rrugës plot shi.

Dhe u ndjeva i lehtësuar në shpirtin tim  
Në mauzoleun tënd të harruar n'errësi.  
Njëri më tha, që gabim e kam, gabim...;  
Dhe nga larg dëgjohej e qara pa dobi e dikujt ...

# LEGJENDË DANTESKE

## I

Për rrugë u nisëm që herët në agim,  
Qielli blu i thellë na mrekullonte.  
I freskët, i lehtë shpirti yn' n'at' udhëtim,  
Të qeshur ishim ne, zemra na gufonte.  
Thërriste, thërriste kjo rrugë pa pushim  
Që përpara syve tanë gjarpëronte.

Dhe për të fundit herë kokën kthyem pas,  
Prej nga ku asgjë për ne nuk pati vlerë.  
Të shkuarën ta harrosh, gjurmët t'ja humbas,  
Ashtu si klithm' e ëndrrës humbet në erë.  
Asnjë trishtim bashkë me ne s'udhëtonte,  
Pastërri e agimit na mrekullonte.

Rrugës këndonim, hidhnim valle gazmore,  
Mbi sup na shkëlqente arma lyster me vaj.  
Si në ëndrrat e kaltërta fëminore,  
Gjithçka kështu buzëqeshte, ndjehej pafaj.  
As tek lamtumira shpirttrave rinore,  
As tek dyshimi i vdekjes nuk ndihej faj.

Përpara nesh shtrihej një fushë e pa an'.  
Dhe na përshëndeste me kallinjtë si ar  
Kjo botë e largët, e gjerë, e pa an,  
Që nga rrezet e diellit duket e lar'.  
Dhe rruga vet', e gjatë, sa syri s'e han ,  
Gjarpëronte në fushën e gjerë me bar.

Me hapa të lehtë dhe shpirt të lehtësuar  
Ecnim ne, të rinj, të gjallë, e plot fuqi.  
Shpirti yn' i gatshëm për të fluturuar,  
A thua se dikush na kish bërë magji? ...  
Malet e lartë na shihnin me krenari,  
Na thërrisnin – të shihnim në përjetësi.

Natë e vonë ish, kur hymë në një fshat.  
I ngritëm tendat shpejt e shpejt, si përherë,  
Dhe të qeshur, të qet', të sigurt', pa e zgjat  
Valles së vjetër ja morëm menjëherë.  
Kumbuan këngët dhe vargjet si ngahera  
Me kulmin në fund kur shkumëzoi vera.

Hëna tashmë në qiell lart ishte çuar  
Dhe qark përhapte një mjegull ngjyrë argjend,  
Dhe kur të lodhur hymë për të pushuar,  
Të pafuqishëm u shtrimë mbi bar nën tend'.  
- Ej, natën e mirë, o miq të paçmuar, -  
Dhe në gjum' të thell', të ëmbël ramë, në vend.

II

Kështu, të gëzuar, kaluam tre ditë.  
Pastaj para nesh u hap krejt pa kuptuar  
Një udhë për dreq; dhe thellë saj, në pafund  
Një kreshtë mundimesh nga zjarri kapluar.  
Dhe ashtu ngadal' dhimbja u kthye sérish  
Në shpirtin tonë të qet', që plot ëndrra ish.

Tashmë dhe qielli sikur kish ndryshuar.  
Mbi kokat tona shiu binte me rrebesh.  
Përpara nesh shfaqej një rrug' e rrënuar,  
Me mjegull të dendur fund' i saj mbuluar.  
Dhe shpirti ynë ashtu si dhe qielli,  
Nën shi kishte ftohtë, dridhej i munduar.

Pranë rrugës shtrirë pamë një kufomë.  
Qëndruam, pamë njeri tjetrin për një çast.  
Ishte kalbëzuar tashmë ashtu nën shi.  
Kujt fisi i përkiste - ah, kush ishte ai?!  
Tashmë çdo kujtim jetuar kësaj jete  
Ish fshirë, shiu e kish marrë me vete.

Qëndruam gjatë. Një mik, që ish ushtarak,  
Kufomën duke shtyrë, qeshi si i marr'.  
A s' ishte ai, që armë mbante me vete?  
A s'ish ai si ne, dashnor i kësaj jete?  
Dhe mendova, mos vallë edhe ne kështu  
Si kjo kufomë do shndërrohemi diku?

Dhe eca përpara. Nga përtej maleve  
Papritmas na u shfaq dielli i zjarrtë.  
Dhe e harrova un' at' trup të shformuar,  
Afshin e tokës thitha, një afsh plot freski,  
Dhe në shpirtin tim të hapur, të pastruar,  
Sërish bota derdhi plot freski dhe rini.

Duart e arta të diellit zbritën posht'  
Dhe përkëdhelën të njomurit e largët.  
Përmes barishteve dhe gjithnjë i zellshëm  
Qeshte një përrua në vrap të përjetshëm.  
Pastaj si shigjetë e hedhur lehtë - lehtë'  
Para meje një zog kaloi me të shpejt'

Ah, ju fusha të largëta ngjyrë ari,  
Ju lartësira të kaltra e të shndritshme ...  
Gjithçka më duket sikur shpirtit i thotë,  
Që në këtë bot' tekanjoze dhe të keqe,  
S'ka pse njeriu, i pagjumë, të qajë  
Veç që t'jetojë një orë në këtë botë.

Dhe befas nga brenda një pyetje më del,  
Ku vallë e gjetëm kaq energji e zell?  
A s'është në botë i thellë dyshimi,  
Se për çdo njeri mbi dhe s'ka fund mjerimi?  
Dhe çfarë kërkojmë ne nga jeta me marr'  
Si grabitqarë të marrë e ziliqar'?

Përse kjo ëndërr e botës qiellore  
Mbi kokën tonë vërvitet porsi qorre?

Përse mbi ne kaq shumë dhimbje, rrënime,  
Gjith' këto të këqia kur do pushojnë?  
Dhe cili gatuan kaq shumë mashtrime,  
Që jetën në skëterr' që djeg e shndërrojnë?

Mos vallë njerëzimi këtu nuk i sheh  
Kurr' të mirat e kësaj bote të largët,  
Ku dielli rrezaton kaq shumë' mrekulli,  
Që n'shpirtin e njeriut veç lumturi le,  
Ledhatim, frymëzim; e mbush me mirësi  
Për çdo fije bari e për çdo gur mbi dhe?

Ah, jo ... Satanai gajaset me këtë  
Butësi të ëmbël të fushave t'arta;  
Dhe sjell erë të thatë dhe thatësisirë,  
Djeg kallinjt' e artë dhe toka duket zi.  
Vazhdova përpara, në shpirt vranësisirë,  
Përçark përsëri pashë zullum, gjurrulldi. –

Dhe ja përsëri – ca kufoma këtu pash',  
Ndërsa pak më tutje – tufa me flokë grash.  
Dhe këtu, nën batanijet me gjak ngjyer,  
Hedhur thërrime buke me gjak përlyer.  
Kush është larguar prej këtu – marrosur,  
Pa qarë, i heshtur, me shpirt të ngurosur?...

Por ja këtu – një skelet i vockël dore.  
Trup nuk ka. Ka rënë ngadalë, pa zhurmë.  
Pak më tutje gjetëm kërcinjtë e çveshur,

Kurse pak më tutje – dhëmbë të shpërndarë.  
Kurse atje, mbi një copë shkëmbi ngjeshur,  
Një pushk' e vjetër, harruar ka të ngjarë.

Me zemër të ngrirë kaluam më tutje,  
Dhe nga vështrimet tona veç gjak pikonte.  
Si lunatikë të mpirë dhe hutuar,  
Syri ynë tashmë asgjë nuk shikonte.  
Mbi supe një brengë të rëndë ngarkuar,  
Të heshtur ecnim, gjak kudo kundërmonte.

Kur po binte nata u futëm në një fshat.  
Të tillë kish veç emrin, por s'kishte jetë.  
Ngrehina pa formë, pallat i rrënuar.  
Qëndruam, u ulëm pak për të pushuar.  
Dhe natën e tërë treguam histori,  
Anekdotat të paturp' dhe plot neveri ...

### III

Dhe përsëri, herët në mëngjes, në agim,  
U nisëm për udhë, të freskët, plot vullnet,  
Në një udhë që ishte vërtet e përpjet'.  
Por shpirtrat tanë s'u qanë, s'u ankuan,  
Por j'u kthyen qaramanit shpirtlëshuar,  
Ashpër, pa mëshirë, rreptë e qortuan.

Un' s'e harroj ngjitjen tonë të përpjetë  
Malit krenar që s'i dukej maja aspak.  
Gjë aq të bukur rrallë e ndesh në jetë,  
Që tregon vullnet të pamposhtur luftarak.

Ngjanim kalorës të lashtë në kalërim,  
Që sipër na shtynte i shenjti ëndërrim.

Sipër mbi kreshtat e akullta ne nganim,  
Dhe armë dhe mburoja mbi supe mbanim.  
Por rruga e acartë ish hileqare,  
Binim, rrëshqisnim, por përpara vazhdonim.  
Dhe si kafshë të shkathta dhe grabitqare  
Lartësitë e kaltra me sy kafshonim.

Rruga e vështirë, ngjitja e rëndë ish.  
Dhe atje s'kish njerëz, as edhe zogj nuk kish.  
Vargu yn' i miqve me sende ngarkuar  
Ngjitej hap pas hapi, ashtu pa nxituar.  
Dëbora binte si litar, nuk pushonte  
Na lidhte këmbët e poshtë na kërkonte.

Tashmë ish bërë mesditë, kur arritëm  
Në majën akull-acar të malit stërmadh;  
Mbi majën e bardhë të malit qëndruam,  
Ku s'kish as kafshë, as bimë dhe as jetë.  
Dhe"ah" na dol nga gjoksi, u lehtësuam  
Fort e ndjemë, që ishim gjallë, në jetë.

Me shikim krenar larg, thellë, po vështroja  
Largësin' e pafund me sy po kërkvoja.  
Mbi lartësi e pakufishme është' ndjenja  
E dashuris' për bot'n e shpirtit njerëzor.  
Pa fjalë u ndjeva, pata emocion,  
Dhe përbrenda ndjeva jetën që vlon, gjallon.

Në largësi të virgjëra isha tani  
Thellë brenda pafundësisë pa kufi;  
Duke marrë premtim thellë në shpirtin tim  
Të bëhesha shpirtmadh, njerëzor, edhe trim;  
Kur papritur, që nga larg, një mik ushtarak  
Pran' më thirri, me zërin që i dridhej pak.

U afrova ... dhe ngela i shtangur si gur.  
E shtrirë mbi dëborë gjendej një grua,  
Që ishte duke vdekur, pa fjal' e pa lot',  
Mbi fytyrë nderur një buzëqeshje kot.  
Me gishtat që dridheshin fort kish shtërnguar  
Thërrime buke si thesar i paçmuar.

Për herë të fundit përpëliti sytë,  
Fytyra j'u çel, nënqeshi ëmbël, dhe vdiq.  
E gjitha kjo e tmerrshme ish, ishte llahtar,  
Me fjal' nuk shprehej dot ajo që po ngjiste.  
Dhe në shpirtrat tan' të ndrydhur u ndez një zjarr,  
Një brengë e pafund dhe dhimbja këlthiste.

Të heshtur gërmuam në akull të vjetër  
Thjesht' e varrosëm, pa alelu, pa tjetër.  
Me duart e ngrira që dridhen si fugë,  
Me borën e ashpër sipër e stisëm.  
Pastaj si të vdekur u nisëm për rrugë,  
Ndërgjegjen e pavlerë aty braktisëm.

Dhe ecnim të lodhur, mërëzitur, zymtuar,  
Nëpër rrugën e shkretë, prishur, shkatërruar.

Mbi heshtjen e grupit që ecjen vazhdonte  
Një jehonë vdekje, e keqe, lartohej.  
Shpirti ynë memec si gur na rëndonte,  
Por dhimbje nuk ndiente, as nuk ankohej.

S'arrinim të ndienim për askënd mëshir',  
Në shpirtrat tanë ishte futur llahtari.  
Ndienim, që – një armik i zi, i pështir',  
Kurth na kish ngritur i fshehur aty pari.  
Prisnim një kundërshtar të keq të na dilte,  
Që veç plagë shkaktonte dhe vdekje sillte.

Dhe e shenjtë dukej kjo rrugë e pafund,  
Kjo rrugë e çmendur, ku fati të përkund.  
Dhe ecnim ne solemnisht, ngadal', pa nxitim  
Sikur ne të ishim nën të shenjtin betim.  
Ku për herë të fundit merrnim angazhim,  
Që askush të mos shmangej në këtë betim.

Dhe me karvane shumë rëndë ngarkuar,  
Po kthehej nga rruga një çfarëdo njeri.  
Çfarë kishte mbledhur, përse, kujt ja kish bler'?  
Për ne ish e errët, pa kuptim, plot çudi.  
Dukej miqësor ai ... por me gjakun tonë  
"Miqësor" u bë me ne një mbrëmje vonë ...

Dhe çdo gur tashmë për ne ishte një armik,  
Dhe çdo zhurmë e tij një kurth ish, një intrig'.  
Dhe ecnim ne madhërisht, pa pik' nxitimi  
Rrugës së shkretë me gjurmë shkatërrimi  
Ku qënie të gjall' tashmë syri nuk gjen,  
Ku dhimbja, mëshira, për njeriun nuk vlen.

## IV

Dhe pastaj, një ditë, ne hymë në një fshat,  
Që ndodhej pranë detit, aty, mu në breg.  
Ishte djegur i tëri. Përreth të pafat'  
Disa shtëpi ende vazhdonin me u djeg.  
Dhe ujrata e kaltërta të detit ndërkaq  
Të lashtën këng' të tyre vazhdonin në paq'.

Ashtu si qeshja e fëmijës së pafaj  
Përhapet mbi fytyrë, ashtu dhe valët,  
Të shkujdesura shushurisin, shkumbëzojn'  
Ndjekin njera tjetrën dhe para fluturojn'.  
Me britma të ëmbla na tregojnë pastaj  
Biseda dhe ëndrra fëminore pa faj.

Kurse fshati i vjetër shndrruar në rrënim,  
I lashtë, plot mister, si baba i qetë,  
Flinte gjumin e zi, të thellë e pa zgjim,  
Gjumin e zi si këto shtëpi pa jetë.  
Dhe nuk kuptonte bisedat keqndjellëse  
Të valëve të zellshme dhe fatthënëse.

Ndërkaq vallja e vreshtave gjelbëruar  
Përhapej deri larg, deri larg, larg mbi dhe.  
Natyra, hapur gjinjtë e saj gufuar,  
Si një grua epshore, e urtë, pa fe,  
E gatshme ish, çdo udhtari që kalonte  
Pasionin e saj vjeshtor t'i dhuronte.

Në vreshtën ku me dy shokë kisha shkuar  
Para nesh u shfaq – një det me rrush të shtrihej.

Ndaj kapriçove të fatit e nënshtruar,  
Nga zjarr' i diellit hyjnor po ushqejej.  
Erërat e përkundnin në gjum' ta vinin  
Me tingujt e valëve që shushurin.

U harrua për një çast kjo lodhja jonë  
Lodhja e shpirtrave, këmbëve me pluhur;  
Harruam për një çast atë zallamahi,  
Ne robër të natyrës me plot mrekulli,  
Dhe buzët tona, nga etje thar', kërkonin  
Frytet e bimës së vreshtit të shijonin;

Kur ndërmjet bimëve ... pamë një kufomë.  
Një i moshuar kish rën' i asfiksuar.  
Kish rënë i mbytur në gjak nën hardhitë,  
Atyre në hije mik u ishte shndruar ...  
Dhe sytë i ishin çapëlyer, sikur  
Diç donte të na pyeste i tmerruar.

U thërriti shokëve dhe u shemb përdhe.  
“Ujë, ujë”, - bëlbëzuan buzët e tij.  
U afrova tek pusi pa u vënë re,  
Dhe me të gjithë trupin ju vara atij,  
Desha t'i shoh fundin, nëse ujë kishte;  
Asgjë s'dukej në të. U ngrita. Bosh ishte

Dhe u vara poshtë, brenda, në thellësi.  
Nga larg më erdhi një shushurimë uji.  
Dhe tërhoqa sipër litarin e hollë.  
Ndjeva kovën të përplaset pas një guri.

Pastaj, një çast ... Dhe, papritur, se nga ku vall'  
M'u shfaqën shpirtra që kërcenin si të gjall'.

Me sy të çapëlyer po i vështroja  
Teksa në kovën me uj' kristal lodronin.  
Ashtu të zhytur me trupat deri në mes,  
Ngadalë, pa u shqetësuar, këndonin.  
Klithmën e gjoksit tim me zor e frenova,  
Dhe i heshtur nga pusi un' u largova

Kafshë të dehura, me hap të nxituar,  
Si dy lugetër nga prapa të përndjekur,  
Vrapuam të dalim jashtë të tmerruar;  
Dhe vështrimet tona ishin turbulluar,  
Nuk shihnin më asgjë, as vreshtin, as detin,  
Ku Vdekja helm, tashmë, të derdh kish filluar...

## V

Dhe ja një ditë, prej rrugës së mundimshme  
Rraskapitur, pa fuqi, për të pushuar  
Kaluam pragun e Qytetit të Vdekur;  
Rrugët plot mjegull, Qyteti i Mbaruar.  
Ndërkaq fytyrat tona tmerr pasqyronin,  
Dhe ethet e vdekjes që shpirtin trazonin.

Në Qytetin e Vdekur s'kish këmb' njeriu.  
Dhe ndërtesat shkretuar, në gërmadha shndrruar,  
Të errta, si qorre, me pamje mortore,

Përsipër shikonin me sy të zgavruar.  
Dhe nuk ishin në gjendje posht' të shikonin,  
Në tokë, ku sytë tan' ngultas vështronin.

Nuk e di përse – por hymë në një shtëpi.  
Pa dritë, si zgavrat e syrit pa ndriçim,  
Zgavrat e thella, si hon, të ballkoneve  
Të pagjuma, na shihnin neve me dyshim.  
Në prag të ndërtesës një mace po kalbej,  
Me plumb ishte qëlluar, përse, me ç'qëllim?

Hymë brenda. Mbi divan të thyer, pamë  
Shtrirë një grua, lakuriq, mbytur në gjak.  
Goja e hapur si zgavër kutërbonte,  
Të dukej se gajasej përlyer me gjak.  
Bëmën e fëlliqur ne na e tregonte  
Veç mollaqe e thar' dhe gjiri i përgjak

Trazimet e fundit m'u tretën nga koka,  
Tash truri më dukej sikur s'ish truri im.  
Dhe filluan vallen qielli dhe toka,  
Dhe dikush më tha t'ja mbath me vrap, me nxitim ...  
Po ku të shkosh, si të shpëtosh pa i parë  
Mollaqet lakuriq, ata gjinj të tharë?

Dhe at' nat' mbetëm aty për të pushuar ,  
Në Qytetin e Vdekur, shtëpit' pa njeri.  
Fantazmat e frikshme ishin grumbulluar,  
Duke kërcyer si të marrë në kllapi,  
Dhe valles satanike për t'ju bashkuar  
Mbinë edhe ca të vdekur, nga ku, se si?

Në një ndërtesë të Qytetit të Vdekur,  
Sytë mbërthyer n'errësirën e thellë,  
Shtrirë rrija unë – pa gjumë, i trembur.  
Dhe përpara meje, zjarre të kuq ndezur;  
Kërcenin përpjetë, këlthisnin, rënkonin  
Të vdekur gjithfar' sojesh, që të tmerronin.

Petka gjithfarë ngjyrash, trupa të vdekur,  
Kërcinj ngjyrë të kaltër, gjokse të zbehur,  
Bythë të fryra dhe të mbytura në gjak,  
Kërcenin plot vrull dhe dukeshin qesharak',  
Përpara syve të mi që shihnin me tmerr,  
Nga varrezat mbuluar me mjegull dhe terr ...

Këndonin, gulçisnin, mbytur ulurinin,  
Përqeshnin, skërmisnin, qanin, uturinin;  
Angullim' e dëshpërimit si gaz buçet,  
Gurgullimë e gazit të qarës i ngjet;  
Porsi vdekja, e rëndë, e thellë, pa kthim –  
Më dilte nga shpirti çdo zë, çdo psherëtim'.

Dhe gjëmonte në trurin tim të trullusur  
Ajo këngë satanike, plot histeri,  
Kthehej dhimbja e trishtimit të harruar,  
Dhe mua më dukej, që tani s'jam më ai.  
Dhe ndërkaq një kujtim i ëndrrës së shkuar  
Më endej në shpirt pa vullnet dhe pa fuqi.

Si fantazëm kërceja, po fluturoja,  
Ashtu si ata, luaja dhe gëzoja.

Dhe papritmas, zhurma e largët e tyre  
U kthye në këngë gazi, gaz fëminor.  
Dhe unë kuptova, që nga larg – shumë larg  
Ish deti që shfrynte në afshin mbrëmësor.

Fëmijë të shkathët, të gjall', të gëzuar,  
Porsi diell ngjante hëna kuq-ngjyr' alle,  
Të vdekurit të qeshur, lloj-lloj sajuar,  
Këndonin së bashku, qeshnin, hidhnin valle ...  
Hidheshin përpjetë mbuluar nga stolit',  
Dhe këngë i këndonin yllit Afërdit' ...

Të çmendur këndonin, sikur Afërdita  
Të jetonte aty – të thellave uja.  
Dhe sipër mbi tokë le të frynte stuhi,  
Që mbart me vete – pavdeksi, vërtetësi!  
Dhe mbetet gjithnjë e bukur dhe e virgjër  
Në hyjnin' e saj, hapësirat pa kufi.

Dhe kërcimi i të vdekurve vazhdonte  
Lunatik, i çmendur, i trisht', i gjakosur.  
Kënga e tyre si rrënkim tingëllonte,  
Një këngë satanike plot ankth mballosur.  
Dhe hidhnin valle në mes të errësirës  
Trupat mjegulluar, kërcinjte lakuriq ...

Dhe nën nanuritjen e detit me hënë  
U shkrin' mes tyre ëndërr, vdekje, dashuri;  
Në imazhin e përflakur të trurit tim

U ngjeshën bashk' dhe u tretën në largësi,  
Dhe errësira u ul mbi sytë tanë  
Dhe gjithçka u zhyt në dremetje, zbrazëti ...

## VI

Nga Qyteti i Vdekur dolëm në rrugë  
Mu përballë sherrit – ballë shesh betejës.  
Po shkonim ne, kryeneç' dhe të gëzuar  
Me u ndesh, të vdisnim duke u përleshur.  
Po armiku tërhiqej duke vrapuar  
Dhe ne me të akoma nuk ishim ndeshur.

Topat fort gjëmonin, vendi oshëtinte,  
Dhe shihnim me zemrën që na rregëtinte,  
Se si atje sipër, në malet e kaltërt  
Ky sherr - rrënim, goditje dhe plagë linte.  
Shtëpit' e fshatit në grumbuj hiri shndrronte,  
Dhe mbi to, tymi i kaltër fluturonte

Dhe ne vazhdonim përpara pa pushuar,  
Mbi malin me borë me kreshta të lartë.  
E zorshme ish rruga. Me sytë fiksuar  
Mbi armikun që ikte duke nxituar  
Një kreshtë mali përpara na tërhiqte  
Dhe me ndjenjën e luftës zemrën na digjte.

Kur për një çast u ndalëm për të pushuar,  
Ndenjëm në majën e malit që zbardhonte;  
Pashë larg. Poshtë një stuhi e tërbuar,  
Dhe, zhytur n'errësir', deti që gjëmonte.

Dhe ujrata që përplaseshin pa ndaluar  
Dhe rënkonin mbytur nga dhimbja shkaktuar.

Ngjyrë plumbi, gri, i errët dhe pa shkëlqim  
Hapej para meje det' prej erës rrahur.  
Hirnosur dukeshin ujrata e kaltërta  
Hirnosur dukej edhe botë e tërë.  
Dhe një mendim i thellë dhe plot trishtime  
Papritmas pushtoi tër' qënien time.

Dhe si deti i moçëm shpirti m'u rëndua.  
Dhe puna, që bëmë, qesharake m'u duk.  
Por, i heshtur, u ngrita, vazhdova të ec.  
Ndërkaq topat vazhdonin, gjëmonin tek-tuk.  
Një dyshim i heshtur në shpirt m'ishte stisur  
Dhe vetja m'u duk i lënë, i braktisur.

Dhe befasi qëndrova në mes të luginës.  
Një trup i pajetë shtrihej para meje.  
Një kalë i plagosur rënë pranë tij  
Tashmë përpëlitej në grahamat e vdekjes.  
Eh, pak më parë, nga kapistra çliruar,  
Nga ky ferr edhe mund të kishte shpëtuar.

Po ku do mund të shkoje moj kafshë e gjor'? ...  
A s'të solli këtu me të rrahur yt zot?  
Vallë s'e dinte ai, që në këtë ëndërr  
Vetëm Vdekja është zot, mizor, fuqiplot?  
Dhe përse shkatërrimin ai do ta donte,  
Për luftë të ashpër kush e ngacmonte?

Pa shih, tashmë i gjymtuar ka rënë ai.  
Është nxirë, shih, ka marrë ngjyrë plumbi.  
I pakallur, pa varr këtu do harrohet  
Të hap' një varr për të askush s'do kujtohet;  
Askush s'do trishtohet, që ai u bë viktim'  
E një tërbimi gjakatar, e pa kuptim.

Nuk e di përse, nuk e di si ngeca,  
Në fytyrë e pashë atë me trishtim;  
Dhe pastaj me të shpejtë përpara eca,  
Me keqardhjen që rëndonte në shpirtin tim.  
Dhe më tej, nga afsh' i tërbimit pushtuar,  
Vazhdonin betejën, duke shkatërruar.

Mes zjarrit dhe tymit dita përfundoi;  
Rrëzë malit qëndruam për të pushuar.  
Mes zjarrit dhe tymit armiku kaloi,  
Mbi supe disfatë edhe turp ngarkuar.  
Dhe çdo humbje, plagë, dhimbje që pësoi  
Perdja e natës së nxehtë e mbuloi.

Dhe nga fush' e betejës grupi u tërhoq  
Për në fshatin e largët, që të pushonte.  
Larg, në fushën e nxir' nga zjarri që e dogj,  
Kalliri i djegur ende tym lëshonte.  
Të lodhur, të uritur, pa fjal' ecnim ne,  
Nëpër natën vjeshtore mbuluar me re.

Bashkë me dy shokë po ecnim pa folur,  
Të lodhur, por plot vullnet të ushtarakut.

Si i vdekur i madh, shtrihej i trishtuar  
Deti, me mjegull, lagështirë, mbuluar.  
Po shkonim të heshtur, pa zë, se ku - s'e di,  
Po atij bregdeti – pa fund e pa kufi.

Kur nëpër mjegull u përvijua një mal  
Thanë, që fshati duhej të ishte atje.  
Ndërkohë kërcinjtë i ndjenim të ngrirë;  
Një nga shokët desh të flejë, të qëndrojë  
Nën qiell të hapur, në fshat pa arrirë,  
Madje mbi rrugë; të bëjë – çfar' të dojë!

Dhe mbeti atje. Unë eca përpara.  
Mbase atë e sjellin hipur mbi kalë.  
Ngjitja ish e rëndë, e rënd' edhe barra ...  
Më duhet të përmbledh gjithë forcat që kam,  
Të arrij – të flej i lodhur, rraskapitur,  
Që ëndrrat të ma çlodhin shpirt'n e drobitur

Në këmbë qëndroja. Era e tërbuar  
Gjoksin ma rrihte me forcë të tmerruar  
Shikimi po më fikej, m'ish errësuar,  
Mjegull e dendur në shpirt m'ish grumbulluar.  
Fuqi mbinjerëzore duke shpenzuar,  
Me kujdes, në heshtje ecjen kam vazhduar.

Fill i vetëm, pa shokë. Si një buf gjigant  
Me sytë qorruar nga grimcat e rërës  
Që era ngrinte lart. Një çast, posht' u vara,

Përsëri u çova dhe eca përpara.  
Kurrë s'kish qenë trupi aq i duruar,  
Dhe shpirti me fuqi vullneti bekuar.

Dhe nga fuqitë pothuajse u shtera.  
Isha pranë majës – gati në t'arritur.  
Kur papritur më hodhi në tokë era,  
Mu në prag humnere, pranë vdekjes ngjitur.  
Por, jo!... Me frik'n e vdekjes, nga errësira,  
U kapa pas gurëve, qëndrova ngritur.

Dhe eca. Kur ja!, ... Përball' meje, papritur,  
U shfaq një mjegull e artë drita-shumë.  
Oh, vërtet, tashmë në fshat kisha arritur.  
Kisha arritur. Ish mesnat', vonë shumë.  
Dhe mbështjell në kashtën e kasolles së ftoht'  
Bëra një gjum' të ëmbël, oh, çfarë gjumë!...

## VII

... filloi përleshja – llahtar dhe egërsi.  
Ne ishim në fushë. Nga malet me borë  
Ata zbrisnin poshtë – të shumtë, mizëri;  
Herë zbytheshin nga sulmi yn' i egër,  
Herë sulmonin viktima duke lënë,  
Herë ja mbathnin, herë vinin përsëri.

Dhe rresht pas rreshti në tokë ata binin  
Si bisha të egra duke uluritur.  
Por përsëri, të shumt', rradhë-ngjeshur, vinin  
Drejt nesh përposht' turreshin si të uritur.

Pastaj gjithçka u ngatërrua papritur -  
Dhe lufta vazhdoi me bajonet' ngritur.

Bajonetat ngjeshur trup me trup u ndeshëm,  
Në tokë ramë, për vdekje u përleshëm.  
Si bisha t'egra, dinake dhe mizore,  
Me etje të madhe jetën të shpëtonim,  
Po mundoheshim – që gjallë të qëndronim,  
Dhe luftonim, dhe egërsisht luftonim.

Në çaste si ato asgjë s'të vjen ndër mend,  
Se çfarë po bënim, idenë askush s'e kish.  
Një pjes' prej nesh tash përdhe kishte zënë vend,  
Pa frymë nën këmbët tona shtrirë ish.  
Ajo kacafytje e përgjakshme, e pamend,  
Nga kafshët e egra asnjë ndryshim nuk kish

Mbi trupat e shokëve tanë kalonim,  
Kufomat e tyre si mal i stivonim.  
Dhe energjitë tona më kot shpenzonim  
Mes një ankthi të madh që nuk e kuptonim.  
Dhe nuk dinim aspak, askush nuk kuptonte,  
Kjo vorbull e errët ne ku po na çonte?

Mbrëmja u ul. Errësirë. Terr i pafund.  
Gjithçka u mbulua nën perden e natës.  
Dhe ëndrra e errët e të Keqit posht' zbret  
Në atë fushë laramane e të shkret'.  
He, hej, të dashur shokë, mbeçi me shëndet,  
Ju, që me nder udhëtuat në këtë jet'!

Ndërkaq - si hileqarë - mbrapsht u tërhoqëm,  
Ndënë stuhitë e mbrëmjes së acartë.  
Kuptim nuk kish kjo udh' e marrë që ndoqëm; ,  
Ndërkaq ne ecnim, të bindur në disfatë.  
Aq marrëzisht - kurrë shpirti s'më kish dalë,  
Kurrë koka erë ashtu s'më kish marrë.

Vatra zjarri sikur kisha brenda shpirtit,  
Dhe brenda syve – gjuhët e zjarrit fushor.  
Por trupi yn', si qënie njerëzore,  
Të rronte donte. Siç pret një i dënuar  
Me sytë fiksuar tek Vdekja mizore,  
Me të tjerët ja mbatha për të shpëtuar.

Dhe brenda territ, si toptha të kuq ngjyer,  
Plumbat fluturonin, zhurmë pas lëshonin.  
Nga paniku satanik shokët mbërthyer  
Në tokë binin, nga vdekja nuk shpëtonin  
Dhe vazhdonin të binin shokë të vyer.  
Dhe për herë të fundit ne na kërkonin.

Dhe kur në qiell dielli u shfaq lehtë,  
Dhe nën dritën e tij njeri tjetrin pamë  
Si të vdekur ngjanim, dukeshim të zbehtë,  
Nuk e besonim se ishim ende gjallë;  
Me sy dhe pa zë njeri tjetrin kërkua,  
Në varr' të shpitrave tanë depërtua.

\* \* \* \* \*

Në fushat me borë ata kanë mbetë  
Bëhen ushqim i ujçërve, lukunisë,  
Atje ku merr fund dhe vuajtja e shkretë  
Dhe shpirti kthehet në shok i gjithësisë;  
Ku si kujtim për të dashurit në jetë  
Veç ca kafka të zgavruara kan' mbetë.

Shkretë është atje, tashmë errësuar,  
Veç era dëgjohet duke uturirë,  
Si muzik' dasme për Vdekjen e tërbuar,  
Në gjirin e dëborave akull ngrirë.  
Dhe kush do të shkojë ta shohë, kush guxon,  
Në botën përtej varrit Zotin që feston? ...

\* \* \* \* \*

Por ne mbetëm gjallë, kur merr frymë e ndjen  
Në këtë fshat gërmadhë, me mure përgjak',  
Ku në çdo shtëpi rrënojë dhe vdekje gjen,  
Ku çdo çast, nga çdo anë, sheh që pikon gjak,  
Ku çdo çast një plan i poshtër nga pas i vjen  
Fatkeqit të fatit të zellshëm dredharak.

Dhe tanimë, përditë, na ndodh shumë shpesh  
Braktisja e kufomave pa varrosur.  
Dhe ne me fytyra nga llahtari ngërdhesh  
Ushqim i hedhim humnerës së pasosur.  
Duke qenë i mbaruar mendjen s'e vret  
Në Botën e Përtejme çfar' fati të pret.

Dhe vera këtu me bollëk është derdhur,  
Në festën e kuqe pa dehur s'ka mbet' kush,  
Tanimë as edhe një pikë s'ka mbetur,  
As kemi çfarë shtrydhim në vreshtin me rrush.  
Gjithnjë në pritje është vdekja e majmur,  
Si - viktimë, si - xhelat', na përdor dikush ...

## VIII

... Dje u zgjova dhe dola herët në agim  
Dhe i heshtur qëndrova lart mbi një kodrin'.  
Nga larg, rridhte një përrua me kumbim,  
Qëndrova, mbajta vesh të tijin gurgullim'.  
Në qiellin e kaltër nuk kish re, as tym.  
Dhe un' harrova të përditshmin ankthin tim...

Ah!, vallja e fshatit që dikur ushtonte,  
Në fushat e gjelbërta larg në horizon',  
Nga ku një hidhërim i thellë shpërthente  
Dhe një trishtim shpirtëror i largët buron,  
Ku ëndërr e përjetshme – ngjan iluzion,  
Që mbi fusha t'arta shket, sikur fluturon ...

Gjithçka është aq e qetë dhe e virgjër,  
Sa ëndrrës së kuqe nuk arrij t'i besoj.  
Si mirazh zbret në shpirtin tim dhe më duket,  
Sikur në t'paqtën bot' të vjetër po jetoj.  
Mos vallë këtu të pashpresë jetojnë?  
Për mirësin' s'kan' arritur të dëgjojnë?...

Oh, nënë e mistereve të përjetshme,  
Që përmes dhimbjesh dhe dëshirash epushore  
Na sjell në jetë krijesa të pashtershme,  
Me mijra lindje dhe vdekje, lloje-lloje;  
Që botës i sjell në form' të vazhdueshme  
Prishje ekuilibrash vën' në peshore.

O ti, barbare, e çmendur, shëndetligë,  
Herë e ditur, herë shtazë që tmerron,  
Bar magjik që botën djeg sa herë që don,  
Shkop magjik që botë krijon kur dëshiron,  
Shpirt djallëzor, që pranë moçaleve rron,  
Ku s'vlen për asgjë – lutje e shenjt' që shëron!...

... dhe duhet ecur, ecur, ecur me durim,  
Me barrën e etjes për jetë ngarkuar;  
Me ec për hatër të një jete pa kuptim,  
Të shuash - dhe të ndezësh yjet e shuar,  
Që – kllapia që gjithësinë mjegullon  
Kurrë të mos tretet dhe Ëndërr - të mbetet! ...

1915 – 1916

## TURMA TË ÇMENDURA (të dala mendsh)

### I

Miqve të afërm e të largët, - botëve, diejve, -  
Shpirtrave si zjarr. -  
Gjithë atyre, të cilëve shpirti u digjet zjarr, -  
Gjithë atyre me shpirt si diell flak e zjarr, -  
Jetës, vdekjes, në këtë në këtë të llahtarshmen heshtje  
Shpirtrave që shkumbohen – përshëndetje, përshëndetje! –

### II

Ishte mbrëmje, një mbrëmje kuq si zjarr me shkëlqim.  
Dielli i zjarrtë, po ulej në gjirin e nënës, në perëndim.  
Mbi fusha, si gjak i ntrashur, mjegulla ish përhapur,  
Të dukej si helm, nga gjiri i diellit të zjarrtë i dalur.  
Dielli i nxehtë, po ulej në gjirin e nënës, në perëndim –  
Dhe mbi fusha kishte gjak, si pështymë e ndyrë që sjell helmim.  
Horizonti i ngjante një furre gjigante zjarri që kuqonte –  
Dhe me shkëlqimin e diellit që po ulej fushën e mbulonte.  
Dhe arat, fushat e pamat', në dallgëzim të purpurt ishin ndezur  
Nga rrezet e kuqe të diellit të mbrëmjes që po perëndonte. –  
Fusha, e kuqe si zjarr, pa anë e pa kufi,  
Përpara tyre shtrihej deri në pafundësi.  
Të ngjan sikur është det, i pa anë, pa fund e pa fillim –  
Të ngjan sikur është det që fshihet në të mbrëmjes mugullim.

## III

Nën diellin mbrëmësor, nga afshi i mbrëmjes që po zbriste pushtuar,  
 N'atë fushë të vjetër, turmat e dala mendsh ishin duke u coptuar.  
 Nga fshatrat dhe qytetet, nga stepat e largëta dhe të afërta,  
 Kishin ardhur ata përsëri, plot shpresë dhe zjarr, plot ëndrra të arta. –  
 Kush nga qyteti ishte larguar– mjegullën e vjetër kish braktisur, –  
 Mjegullën, që për jetën ishte kthyer në re tymi të helmatisur.  
 Kush kishte ardhur nga fshat i largët - pas kishte lënë të njomë tokën,  
 Mbi të cilën kalliri i artë nuk mundi kurrë ta nxjerrë kokën.  
 Kush nga stepat kishte ardhur, hapësirat e pafund ai pas kish lënë,  
 Horizontin madhështor, që për të ishte shndërruar në burg për të qenë.  
 Kush jetonte qyteteve të largta, ku mjegulla ish pa përcaktim,  
 Ai kish sjellë shpirtin tuberkuloz, si një flamur të kuq që ngjall besim. –  
 Kush kish ardhur, duke lënë pas terrin e pafund të fshatit të largët,  
 Kish sjell' me muskujt e tij forcën frutprodhuese të tokës së vlagët.  
 Kush nga stepat kishte ardhur, ku si skllav, bujkrob kishte pasë jetuar  
 Në syt' e kaltërt i gjeje madhësinë e stepave pasqyruar  
 Rebelë, të çmendur, të dalë mendsh, prej jetës së mëparshme larguar,  
 Në atë fushë të pafund ishin mbledhur dhe grindjen kishin filluar.

## IV

Dielli mbrëmësor, me dritën akoma ndezur, ulej, perëndonte.  
 Dhe turmat e dala mendsh, që po grindeshin duke kënduar, vështronte.  
 Fusha ish përball'; me ngjyrën e purpurt dhe rrezet e diellit të madh -  
 Pështjellur ish ajo, dhe nga pas, mbi rrugë, shfaqej qyteti i stërmadh. –  
 Shtrirë në plogështi, nën diellin mbrëmësor, pa kujdes pispillosur,  
 Ndriste qytet i vjetër, si një masë nga mijra nuanca njollosur.  
 Larg, larg, i pafund, shtrirë gjer' e gjatë, qyteti i vjetër dallonte  
 A thua ish i vdekur që nëpër mjegullën mbrëmësore notonte.  
 Ndërtesat kryelarta, që duket se rrinë pezull në ajrin e kuq  
 Pak nga pak po zhyteshin në errësi, të pa ngjyra dhe të hirta.

Nga larg duken dritaret e xhamta, që prej zjarrit të ndezur  
Shkëlqenin nën rrezet e fundit të diellit të përflakur;  
Përballë diellit shkëlqenin si vullkane të zjarrita;  
Dhe një shqetësim i mprehtë në shpirt ata i kish kapur ...  
Dhe në shpirt'n e zbeht' të qiellit, si me gozhdë mbërthyer,  
Shkëlqenin oxhakë gjigantë, pis, si me gjak përlyer.  
Nga grykat e tyre nuk çfrynte tym, që drejt qiellit të lartohej,  
Dhe qielli i kuq mbrëmësor nga tym i tyre aspak s'rëndohej. –  
Ishte veç mjegulla e mbrëmjes që ngrihej sipër dalëngadalë –  
Dhe nëpër mjegullën po humbisnin edhe oxhakët e metaltë. -

## V

Por nga qyteti drejt jugut, triumfues dhe madhështor,  
Dukej që së largu stacioni gjigant hekurudhor.  
Her' -her' siren' e trenit çante ajrin e mjegulluar –  
A thua se atje po therrnin një shtazë të tërbuar!  
Nga larg piskama e zërit të tij shpresëthyer ndihej  
Dhe si lajmi i një vdekje pa kthim nëpër fushë shtrihej. –  
Përpara tij shtrihej stacioni i trenit, madhështor. –  
Dhe nga nyja e tij, nëpër fushë - i shtrirë gjatësor,  
Drejt veriut, drejt jugut, perëndimit si edhe lindjes –  
Përhapeshin kudo linjat e transportit hekurudhor. –  
Si damar' të hekurt të stacionit pranë qytetit  
Larg, larg shtriheshin linjat e hekurudhave të rrjetit.  
Si damarë të hekurt, të mbërthyer fort në të tokës gjì,  
Ngjiteshin pak nga pak, deri sa zhdukeshin si pa u ndi!  
Dhe kryqëzimi i rrugëve - një lëmsh i ngatërruar;  
Stacioni, si enigmë, si vigan i ngurtësuar.  
Në mes ky lëmsh linjash mbyllej, thua nyje kish formuar,  
Dhe turmat e dala mendsh vazhdonin grindjen e tërbuar.  
A thua nxitur nga një dorë fitimtare, hyjnore,  
Me këng' luftonin, në stacion të hynin me fitore.

## VI

Grindeshin. Ndërkohë frynte një flad i heshtur mbrëmësor.  
 Përpara shtrihej qyteti i lasht', një armik shekullor.  
 Gjigant si sfinks, me grumbujt ngjyr'- kuq që tokën mbulonin,  
 Rrug'n e kuqe u kish prer' turmave që diell kërkonin.  
 Dhe stacioni, që shfaqej madhështor në at' muzg të kuq,  
 Fitimtar qëndronte para tij, porsì qen vigan gërmuq.  
 Si zotërues vullnetesh aty fitimtar qëndronte  
 Dhe marshimin e rrugëve të hekurta po vrojtonte.  
 Në drejtim të veriut, drejt përpara, hallkë pas hallke  
 Shpërndareshin përmbi tokë trasetë në formë dallge.  
 Armiku ishte fshehur në llogoren që dallgëzonte  
 Dhe me duart e përgjakura vazhdonte ta zgjeronte.  
 Në të ngrohtin gji të tokës fshehur rri pusi tinzare  
 Fërkon duart n'fshehtësi, duart fajtoje, gjakatare.  
 Vazhdonin grindjen, afroreshin, pak nga pak përparonin.  
 Shpërthimet nga armët metalike shumë fort ushtonin. –  
 Ajo grindje të ngjante me këngë, që nëpër muzg kumbonte,  
 Një pushkë të kërciste, shih, pasionin si gufontel!

## VII

Grindeshin, përpara shkonin, vazhdonin duke luftuar  
 Dhe mbrëmjes nëpër fusha vdekja gajasej pa pushuar.  
 Këndohej, tingujt me krismat e armëve përziheshin,  
 Vazhdonin ata përpara shkonin dhe me zjarr grindeshin.  
 Këngë ish shpirti i çdokujt, këngë ish vështrim i zjarrtë;  
 Digjej shpirti i çdokujt, si përflakej agim i artë.  
 Këngë ngjante diell i vjetër me ndriçimin mbrëmësor;  
 Turmat e marra vazhdonin luftën dhe këndonin si në kor!

## VIII

Dhe këndonte njëri, tmerrsisht fuqishëm, si t'ish i hardallosur,  
Lavde i thurte shokut të tij nga grindja dalë i gjakosur. –  
Porsi skifter, kënga atë e çonte larg, shumë larg, rrezikshëm, –  
Dhe grindej ai duke kënduar, me buzëqeshje dhe i frikshëm.  
Diell i mbrëmjes për në gji të nënës nxitonte. Ai këndonte.  
Dhe mbrëmjeve në fusha – zëri i tij si këmbanë gjëmonte.  
Ngjante me këmban' që kumbonte fort, që gjith' bota ta dëgjonte –  
Me trishtim të thell' e të pafund, me zjarr ai këndonte, këndonte. –

## IX

“ ... Nga stepat, nga pyjet, nga qytetet e largëta apo të afërta –  
Shpirtrat tanë të rinuar po sjellim, plot shpresë dhe të zjarrta.  
Këtu tashmë veç grindje ka, vdekje ka, pasiguria ka pllakosur, -  
Dhe ne shpirtin tonë - flamur i kuq, përballë vdekjes kemi shpalosur.  
Në gjirin e nënës, i përgjakur, hyn ky diell i vjetër shekullor;  
Dhe ne na buzëqesh kjo botë e përgjakur në këtë çast mbrëmësor!  
Dhe me shpirta të dalë mendsh luftojmë ne dhe kënga jonë ushtonte;  
Bota gjoksin i kish vën' një armiku që me mijëra numëronte!  
Dhe pa dëshpërim grindeshim ne, dhe na qeshte vdekja që rrinte zgjuar  
Shumica, ah, do t'i sakrifikojmë shpirtrat tan' me trishtim ngarkuar –  
Si trishtimi ynë i kuq është ky marshim kryelartë dhe mizor  
Qëlloni, qëlloni, miqt' e mi të dalë mendsh, hiç të mos ju vijë zor!”.

## X

... Në gji të nënës po futej dielli, rrezet e tij ende të nxehta.  
Dhe grindeshin pa u zbrapsur turmat e dala nga ato mendt e veta.  
Brenda syve, një flak' të kuqe, dhe në shpirt një zjarr të kuq ata kishin,  
Me fuqit' e fundit në një grindje të ashpër, pa hile, futur ishin.  
Me këngë prej të marri, të ndezur nga pasioni, përpara shkonin  
Dhe armiku ja dha vrapit i tmerruar, këmbët s'dinin ku e çonin. –  
Muzg, në gji të nënës zhytej e fundmja rreze e diellit mbrëmësor,  
Kur me një sulm të guximshëm e pushtuan stacionin hekurudhor!

## XI

Errësirë është tanimë. Nata, thellë, poshtë ka zbritur.  
 Errësirë është tanimë, terri i plotë ka mbërritur.  
 Në stacionin hekurudhor, ku asnjë dritë nuk ka nderur,  
 Turma të dala mendsh, përbërë nga mijra vetë, janë mbledhur. –  
 Kubetë prej hekuri, kryelarta, n'atë terr nuk dallohen,  
 Në stacion s'kanë nderur drita, nga armiku t'mos zbulohen.  
 Në pritje rrinë, në largësitë e errta sytë fiksuar,  
 Nata zbriti plotësisht, tanimë stacionin ka mbuluar. –  
 Presin, deri sa të dalë drita mundohen pak të pushojnë  
 Dhe në mëngjes sërish të dalin, me sulm qytetin të pushtojnë.  
 Sytë e ngulur në terr'n e thellë, me zemër dridhur, pa shërim,  
 Presin agimin që grindjen të vazhdojnë, presin me padurim.  
 Pak më përpara, kur në fushë përgjakeshin me armë në dor' –  
 Qyteti aq pranë u dukej me at' stacion hekurudhor ...  
 Erdhën ata, luftuan, stacionin e madh me këng' pushtuan –  
 Ndërsa armiku ja dha vrapit për në qytet ku u strehuan.  
 Presin, deri sa të dalë drita mundohen pak të pushojnë  
 Dhe në mëngjes sërish të dalin, me sulm qytetin të pushtojnë.

## XII

Dhe brenda territ mijëvjeçar, n'at nat' të thellë e të pafund,  
 U mblohdën ata në stacionin hekurudhor, atje në fund.  
 Fusha është përballë, ajo në errësirë është zhytur.  
 As zë dëgjohet, as erë nuk fryn, çdo gjë në terr është zhytur.  
 Fusha është përballë, e pakufi, nga terri është mbuluar,  
 Ku, pa sy, pa dritë, dyshim i thellë, i errët, ka qëndruar.  
 Dihaste porsi qen në errësirën që sa vinte zmadhohej, -  
 Dihaste në mjegullën e dendur, dhe si ujk tinzar afrohej.  
 Në terr, sytë çapëlyer, dyshimi i vjetër ka qëndruar  
 Stacionin që ndodhej përballë tij rrinte duke shikuar.

Errësira dukej sikur lëvizte, dhe në terr sytë e tij –  
Shikonin sytë e kaltërt të turmave të dala mendsh tani. –  
Dhe me shqetësim të trazuar, me vështrim të tensionuar,  
Në largësit' e errta, turmat e marra rri duke vështruar.  
Me sy blu, n'atë terr të thell', të trisht', ata lëviznin pa pushim –  
Dhe kët' mbrëmje në stacion, ndihej lehtë', si i mbytur, një zhurmim

### XIII

Me ushtri të shumta përballë stacionit gjigant rreshtuar,  
Me sytë si diej – fushën e errët ishin duke vrojtuar.  
Përballë është terr, dhe nëpër terrin, që si humnerë hapej,  
Larg, shumë larg, një si topti, që digjej me drita të kuqe, shfaqej.  
Përballë syve, n'atë terr, përballë shikimeve që prisnin, –  
Larg në terr, dritat e atij topti si një pik e kuqe ndrisnin.  
Nëpër natë – kuq, kuq, dukej flak' e tij në terr duke vibruar,  
Rrinë ndezur dritat, që ushtria të rrij' gati, të rrij' zgjuar.  
Në errësirë, që nga larg, si një kokë e kuqe qeni ngjan –  
Që me flakën e tij sinjalin – “gati për betejë” – ndezur mban .  
- Në qytet ndodhet mizëria, ku panik dhe ethe ka tani.  
Si një armik i dalë mendsh prej frikës rri ai n'gatishmëri.  
Dhe nga larg aq i dukshëm dhe stërmadh, flakë i kuq, ai zjarri —  
Ngjan si pikë e kuqe gjaku brenda mendjes së një të marri.  
Mbërthyer nga ethet e agonisë në të fundit shans shpresojn', –  
Syt' mbërthyer n'pikën e kuqe turmat e marra rrin' e vështrojn!

### XIV

Atë nat' të errët, me sytë në pikën e kuqe fiksuar,  
Turmat e dala mendsh po prisnin agimin, duke ndenjor zgjuar.  
Dhe ndizej në shpirtrat e tyre pus të errët të dhe pa tundim  
Ajo pikë e errët, që nga larg i ngjan vullkanit në shpërthim.  
Si teh i skuqur futej në shpirtrat e tyre, duke i çpuar –

Dhe helm e zjarr, dhe ëndrra plot mbi këtë botë duke lëshuar  
 Në shpirtrat e tyre po troket breng' e vjetër, mijëvjeçare –  
 Ethe fut tani dhe ankth në shpirtrat e tyre si qelibare.  
 Në sytë e kaltërt, nga gjaku ndezur, një dëshirë shkëlqente –  
 Dhe nga sytë me miliona cirka, gjak edhe helm shpërthente.  
 Ziente në shpirtrat e tyre vreri prej vitesh grumbulluar –  
 Dhe ndizej në sytë e kaltër i përgjakshëm dhe i tërbuar.  
 Dhe me sytë e përgjakur, mbi pikën e kuqe fort fiksuar,  
 Turmat e dala mendsh tashmë agimin prisnin si të ngujuar.

## XV

Natë pas nate, terri në shpirtin e tyre thellë ka zbritur,  
 Që me shqetësim pret një krismë zjarri në agim, për t'u ngritur.  
 Nat' ka në shpirtin e tyre të madh, por në terrin e pakufi –  
 Ka qiej sykaltër, horizonte të paan', pafund, pakufi.  
 Dhe në syt' e tyre të kaltër, ku kish zbritur nata tinzare,  
 Sheh agime dhe mëngjese, sheh me mijëra flakëza, zjarre.  
 Forca e muskujve të tyre mbi tokën e njom' tendosur rri, -  
 Dhe po të duan, diejve u japin ritëm dhe drejtim të ri!  
 Dhe po të duan, diej të tjerë, të rinj hedhin nëpër qiejt.  
 Dhe po të duan, nga qiejt e lartë poshtë i sjellin diejt!  
 Dhe po të duan, me vrullin e trimit dhe të botës ndezur zjarr –  
 Mund të bëjnë shumë gjëra, që s'i bën dot asnjë turmë e marr'!

## XVI

Dhe tretet nata e errët, po agon, mëngjesi po troket.  
 Orët e pritjes së ftoht' e pa dobi ngelen pas, koha rrëshqet.  
 Nga fusha tani po vinte fresku, fladi i qet' i agimit –  
 Dhe pik' e kuqe zbehej, po shuhej zjarri – burim i ndriçimit  
 Tashmë terri ishte holluar, dalngadalë po davaritej –  
 Në lindje, nga një krah vigan i zjarrit', errësira plasaritej.

Nga larg ndihej i mprehtë të frynte në kët' gjysëmterr agimi –  
Qetë, qetë, erëmirë, një flad i çuditshëm, flad freskimi.  
Errësira po lëvizte gjithashtu dhe nga larg i sterrosur  
Dukej tashmë qyteti si një masë e errët e dreqosur.  
Muret e ndërtesave kryelartë po dilnin në drit' tashmë,  
Po kështu edhe oxhaqet vigane prej hekuri - një nga një...  
Dhe shpirtërat e ndezur të turmave ankthi po i helmatis,  
Në qiejt e syve kaltërosh' është' ndezur ethja e agonis'...  
Me sy të ndezur po shohin masën e madhe të errët si varr,  
Dhe ndizet shpirti i tyre, si dielli i madh që digjet zjarr ...  
- Tani përpara do të shkojnë, qytetin e madh do ta pushtojn',  
Dhe mbi të do derdhen vrerin e tyre mijra njerëz që luftojn'.  
Do të shkatërrojnë dhe rrënojnë, vendin pluhur do ta shndërrojnë –  
Atë qytet shekullor do ta shkatërrojnë, do ta rrënojnë.  
Do ta djegin, mbi djegurinat do të kërcejnë si të marrë,  
Zjarr përvëlues dhe thëngjij do të mbesë në tokën e vvarë. –  
Dhe hirin e mbetur do ta ridjegin, që mos ketë mundësi  
Jeta e vjetër, ashtu si Feniksi, të ringjallet përsëri ...  
T'ja japin erës atë hi, që ta marrë e mbrapsht mos ta kthejë –  
Po ta çoj' drejt largësive ku akoma s'kanë lindur diej ...

## XVII

... N'agim, kur si zambak mahnitës në horizontin e përflaktë,  
Kur si sinjal beteje - flakë i kuq u shfaq dielli i zjarhtë,  
Kur në lindje u shfaq dielli, me dritë të re ndezur tani,  
Turmat e dala mendsh jashtë stacionit u derdhën mizëri!  
Para ish fusha e pafund, mjegulla ngjyrën e diellit kish,  
Dhe në qetësin' e mëngjesit, nëpër mjegullën që avull ish,  
Posi një cirk i madh gjigant, laraman, shumëngjyrësh, i lartë –  
Pranë kufijve të rrugës dukej qyteti i gurtë qartë!

Sytë e fiksuar larg, shumë larg, në diellin që digjej zjarr,  
Në largësit', ku dielli digjte, grindeshin ata pa u ndar';  
Me grupe të ngjeshur, mijraemrash, nga afsh' i diellit ndezur,  
Drejt Diellit po shkonin turmat e dala mendsh, trurë të nxehur!

\* \* \* \* \*  
\* \* \* \* \*

**Korrik, 1918**

## NINULLË VETVETES

Duke lën' në Kars, breg-lumit, shtëpin' time me gur' palatuar,  
Duke lënë Karsin, vreshtat dhe tokën time të bekuar  
Dhe "Mbeçi me shëndet!" Karine Kotançjanit pa i uruar –  
Në qytete të huaj tashmë i vetëm endem, i hutuar.

I vetëm tash po rri; përreth njerëz, përreth fytyra lloj lloje,  
Përreth bota zhurmon, e pabarabartë jeta njerëzore,  
Dhe, "Kush je?", "Çfarë bën?", askush nuk pyet, dukem lënë pas dore  
Fytyrat, ah, duken të atilla, thua gdhendur me kosore.

Gri, këng' e mërzitshme dhe e çmendur më duket kjo jeta ime,  
Si plag' e hapur në shpirtin e dikujt më ngjan kjo jeta ime,  
Dhe përse – dhe përse plot mall i këndoj tani un' vetes time  
Shpirtin mbushur plumb të rëndë përgjatë viteve me trishtime.

Por bota përreth, le të marroset, apo të çmendet sa të doj' –  
Un' – sakat dhe i dal' mendsh, si emigrant i përjetshëm do jetoj,  
Drejt Gjithësisë së pafund yjore, drejt qiellit do të shkoj –  
Dhe në rrugët e ëndrrave të vjetra dhe hyjnore do kaloj,

Dhe për gjithë fajet falje do ketë tashmë shpirti im,  
Nga syt' e njerëzve larg do shkoj, do largohem un' pa kthim,  
N'e pafshi Karine Kotançjanin në Kars, nëpër qytet –  
Të m'i thoni: "Zarenci tha – mbeç me shëndet, mbeç me shëndet!"

1919

## FJALË QË NGA LARG

Brenda syve të mi zjarre shuar pa fund mund të shikosh  
Dhe brenda shpirtit, të pa shpresë, yj' të shuar shumë dallon.  
Jetën time, që kujtim është shndrruar, nga larg mos e mallkosh,  
Jeta do më shkoj', do më fiket – por kam këngën, që jeton.  
Jeta do më shkoj', do më fiket, porsi zjarri në moçal,  
Pa qëllim dhe më kot, pa t'ardhme, pa shpresë e ngushëllim.  
Brenda këngëve – ti e di? – askush nuk e di në jam gjall'  
Ngjan se tjetër kush këndon trishtim'n e kaltërt të shpirtit tim.  
Përjet' i heshtur dhe pa fjal', bredh tani un' i hutuar,  
Askush, as unë vetë, ç'është jeta ime nuk e kupton,  
Dinë vetëm, që në jetë disa këngë un' kam shkruar,  
Dhe un' e di, që ti e kupton, që dikush të dashuron.  
Buzëqeshjes tënde plot dritë, shpirtit tënd un' i këndoj,  
Syve të tu, fytyrës tënde mbushur me të shenjt' trishtim,  
Jetës falur pavdeksis' – dashuris' së thell' un' i këndoj  
Dhe trishtimit të krahëve, që s'të dhanë kurr' përqaqim!  
Po afrohet, motra ime, ah, mbrëmja dalëngadalë,  
Çfar' të bëj, që nga trishtimi mos më plasë shpirti mua,  
Si, si ta pranoj gotën e zbrazur të jetës, pa fjalë,  
Që duart mos më dridhen, që ditët të më falin mua.  
Ndoshta, befaz do të dyshoj, vetes s'kam për t'i besuar,  
Dhe trishtimi yt i shenjt' në shpirtin tim ngjan i gabuar!  
– Çfar' të bëj, motra ime, motër, që nga larg mos kem mallkim  
Mbi të shkretët krahët e mi, që s'të dhanë kurr' përqaqim!

## PËRFYTYRIMI I VDEKJES (Vizioni i vdekjes)

Si tel që vibron i violinçelit të braktisur,  
Më dridhet shpirti nga një dëshpërim i madh paditur  
Kulmi i dëshpërimit është ai - harpa e fundit,  
Një litar i ashpër dhe dy drunj drejt qiellit ngritur.  
Si përbuzje e errët për fatin tim, ose ndoshta  
Një premtim i vjetër, që i pambajtur, duhet prishur,  
Drurët, që shërbejnë për varje, në mes qytetit rrin',  
Dhe fatkeqin presin, ashtu të ftoht', në këmbë ngritur.  
Ngritur jan', të heshtur, dy drunj, me njeri tjetrin lidhur,  
Dhe në mes qëndron, lakuriq, dhe fort duke u dridhur  
Një litar ngjyr' gri, si i këtyre ditëve trishtim,  
Trishtim i shuar në shpirtin tim Nairian jetim.  
Përreth po bie një mbrëmje pa gjallëri, pa jetë,  
Dhe një heshtje e paformë, e trishtë, shumë e qetë,  
Si trishtimi i ditëve, si dhimbja e pasosur  
E vdekjes, si ky shpirti im pa lajme, i burgosur.  
Dhe dyqanet lënë bosh, ata njerëz të trishtuar,  
Që përqark atyre drurëve janë grumbulluar,  
Aq pranë harpës së drunjtë të vdekjes, harpës së brishtë' –  
Çfarë po duan, pa dëshirë, dhe aq shumë të trisht'?  
Dhe vërtet, kush ëndërron të sjell' kaq shumë hidhërim? –  
Dhe kush i shndrroi agimet plot dritë të shpirtit tim  
Në një mbrëmje të pa zjarr, ku mungon drit' e diellit,  
Kush i shndrroi në litar dhe dy drunj ngrit' drejt qiellit?

Ndoshta unë jam ai, që me shpirtin tim të trazuar  
 Nuk ju solla që nga larg atë zjarrin e kërkuar,  
 Dhe desha, që as dhe një harpë të mos pëshpërisë  
 Të ardhmen e shkëlqyer, kurorën e Nairisë!

Po iki tani. Dhe me një trishtim që s'gjen qetësim,  
 Me ëndrrat dhe pasionet e mia si këngëtar,  
 Me këngët e ditëve të mia që më s'kan' shkëlqim  
 Me dashurin' e fundit si Nairian ëndërrtar;  
 Një natë po shkoj i përhumbur dhe i mbaruar,  
 Si një lugat i ndjekur, si një fantazmë që vjell vrerë;  
 Atij trekëmbëshi i jap qafën i dëshpëruar  
 Dhe këndoj vajtueshëm unë, pa zë dhe pa ndërprerë!  
 Askush, veç meje, mos të bëhet viktim' - këtë kërkoj',  
 Trekëmbësh të tjer' pran' të varurit të mos ket' ngritur,  
 Dhe nëpër syt' e mi prej të varuri le të shikojn',  
 Tokën time të përflak', të ardhmen kurorë-ndritur.  
 Dhe nëpër syt' e mi prej të varuri le të shikojn',  
 Të ardhmen e ditëve të tua plot dritë, shkëlqim, -  
 Askush, veç meje, mos të bëhet viktim' - këtë kërkoj',  
 Asnjë hije mos vij' pran' të varurit - trupit tim!

## PA TITULL

Unë i dua ata, çdo herë që jam  
Faqe të ndryshme libri duke shfletuar  
Njeri nxehtë qan, ose pa dashur lutet,  
Tjetri mallkim hedh mbi unin e rrënuar.

Ah!, në çdo rresht të tyre, aty në çdo fjal'  
Jetë unë gjej, ose – farën e vdekjes;  
Ah!, me të njëjtin vrull drejt vdekjes njerin shtyjn'  
Dhe drejt jetës – tjetrin, me trishtim e ndryjn!

## PA TITULL

Ata po vijnë pa u dukur, pa u vënë re,  
Ashtu si gjaku i kuq që rrjedh nëpër damarë,  
O jetë, ose vdekje sjellin për të gjithë ne  
Hedhin fatin tonë në largësi të paparë.

Dhe çfarë ka në kufi të rrugës ku na çojnë?  
Ç'frut' do sjellë pun' e tyre, e mendoni?  
Gjithnjë e panjohur do jet' për ne, si për shpirtin  
Rrjedh' e gjakut, që çon në shpërthime pasioni.

## PA TITULL

### Gruas dhe mikes, Izabelës

Dita e vdekjes time po zbret e heshtur,  
Hijerëndë po ulet mbi këtë qytet,  
Si re e errët apo trishtim i vjetër,  
Apo si lajm fatkeqish shkruar mbi gazet'.  
Si grua e njohur, e ve apo pa fat,  
Si mikeshë që pamjen e trishtimit ka,  
Fillimisht lajmi qarkullon në rrugicë,  
Pastaj vjen te dera – shkel prakun, hyn brenda!  
Ndërkaq një gazetashitës plak, i rrudhur,  
Thuajse i verbër, punonjës i bindur,  
Me hapa të shpejta shkon shtëpi më shtëpi,  
Shfaqet në çdo prag, dhe pret të dalë njeri.  
Si mik i errët rrëshqet ndërmjet shtëpive,  
Qëndron i padukshëm dhe posi një hije,  
Qëndron si një heshtje e keqe, e vvarë,  
Që mbi gjithë qytetin është shpërndarë.  
Në mes të natës, për një çast, i pagojë,  
Me krejt shpirtin, që papritur i bllokuar,  
Si hëna e largët tashmë ka qëndruar  
Fytyra ime, përjetësisht e shuar.  
Dhe njerëz deri dje të huaj për mua,  
Që fytyrën kurrë nuk ma kanë parë,  
Dhe njerëz që nganjëher' vetëm me mua  
Fantazitë e tyre u kanë ngarë,  
Dhe njerëz që dikur s'njihnin këngën time,  
Njerëz, që ishin jehon' e jetës sime,

Sot veç dëshmitar' të ndryshëm kanë mbetur  
Dhe kujtojnë, që prej kohësh un' kam vdekur;  
Të gjithë këta, nga lajm i vdekjes sime,  
Si njerëz që fatkeqësit' i tmerrojnë,  
Të çuditur më ndjenë mua aq pranë  
Dhe papritur aq të dashur dhe të afërm ...  
Dhe ashtu si ngrihet pluhuri mbi tokë,  
Ashtu si kujtimi në shpirtra përzihet,  
Duke dal' nga hon i kohës së shkuar  
Hija ime në fluturim do të ngrihet.  
Dhe nëpër qytete, dhe fshatrat mbetur shurdh,  
Kalimtar' që s'njiheshin mes tyre më par',  
Në sytë dhe në vështrimet e hutuar  
Të njëjtin pikëllim kan' për të lexuar ...  
Dhe me fytyra dhe me sy të trishtuar  
Të njëjtin lajm të zi kan' për të njoftuar,  
Me ndjes' të pafund ndaj këngëve të mia,  
Dhe për gjithë fajet tashmë të harruar' ...  
Ndoshta dikush librin tim dikur do ta gjej',  
Do ta shfletoj' ngadal', rreshta do të lexoj',  
Me lëvizje të turbullt faqet do t'i kthej',  
Dhe trishtimi nga kujtimet do ta rrëmbej'.  
Dhe ndoshta e vetme në dhomën e qetë,  
Kokën përkulur mbi portretin tim të zbeht',  
Një grua do më shoh' në syt' e trishtuar,  
Dhe un' do ndjej syt' e saj duke lotuar.

\* \* \* \* \*

Dhe ashtu si ndodh në jetë, vite më pas  
Në kujtime befas shfaqet e shkuara,  
Ndoshta edhe në ëndrrat e harruara  
Si dhe në librat e kujtimeve shkruar!  
Atë që isha, që e imja ish dikur,  
Në asnjë libër nuk e gjen të përmendet  
Dhe në asnjë libër në botë të shkruar,  
Në asnjë libër, dhe në asgjë të shkruar!

## ME ARDH PËR HATËR TË NËNËS

Kujtoj fytyrën tënde të plakur, e ëmbla dhe e shtrenjta nëna ime,  
Rrudhat dhe vijat e ndriçuara, e ëmbla dhe e shtrenjta nëna ime.

Ja ku qëndron përpara shtëpisë dhe pemës së gjelbëruar të manit,  
Mbi fytyrë hija të ka rënë, e ëmbla dhe e shtrenjta nëna ime.

Qëndron e heshtur dhe e trishtuar, ditët e vjetra je duke kujtuar,  
Që kanë ardhur dhe kanë shkuar, e ëmbla dhe e shtrenjta nëna ime.

Dhe kujton ti birin tënd, që prej kohësh, prej shumë kohësh është larguar,  
Vallë ku larg ndodhet tani ai, e ëmbla dhe e shtrenjta nëna ime?

Vallë a e di ku ndodhet ai, është gjallë dhe mirë, apo vdekur,  
Dhe pas kujt dere qëndron dhe troket, e ëmbla dhe e shtrenjta nëna ime?

Dhe kur i lodhur ka ardhur, dhe kur i gënjyer në dashuri ka qenë,  
Në përqaftim të kujt ka lënguar, e ëmbla dhe e shtrenjta nëna ime?

Në mendime të trishta je zhytur ti, dhe pema e manit të nanuris  
Në hidhërimin tënd të pakufi, e ëmbla dhe e shtrenjta nëna ime.

Dhe lotët e hidhërimit t'u kthyen përsëri, pik-pik bien një nga një  
Mbi duart e tua të plakura, e ëmbla dhe e shtrenjta nëna ime!

## KUSHTUAR A.B.

... Dhe për fjalët e tua si të mermerta,  
Të lashta, erëmir', si ato të vjetra  
Gdhendur në gur në kishat tona pa dyer,  
Të pashkatërrueshmet shkrimet e lashta, -  
Dhe veprat e tua, si "Mirron" i shenjtë  
Në tas të pastër prej argjendi ruajtur  
Për bekimet, shenjtërimet e përhershme,  
Si shenjtërim i shpirtit ton' "Nairian", -  
Për "Mirhavin" tënd – dhe kujtimin e ndritur,  
Të Arpenikut shenjtëruar përjetsisht  
Në "Lulen e Alpeve" aq erëmirë, -  
Që kundërmon si aromë fluturake -  
Dhe më së fundi për "Farëmbjellësin" tënd  
Gjigant, heroik, që me duart e mëdha,  
Mbi brazdat e jetës sonë kaq mjerane  
Shpërndan shkëlqimin dhe farën shoqërore  
Për të gjitha këto, - edhe për "Kajsinë"  
E tokës tënde të lasht' mijravjeçare  
Që në shekuj për paqe ka ëndërruar  
Kënga kumbon, - dhe populli yn' për sa koh',  
Që ka të paktën një cep toke nën diell,  
Këng' vëllazërimi përherë do këndo', -  
Për të gjith' këto, o, miku im i shkretë,

Me këngët e mia un' tash po të bekoj!  
Për të gjitha këto, - si dhe për të trishtin  
Fatin tënd kaq tragjik, që tashmë përsëri  
Në këngën tënde të çiltër shfaq madhështi –  
Unë ty ta shtrij dorën plot vëllazëri!  
Dhe të thurr vargje të sinqerta përsëri  
Me buzët e mia, si në ditët dikur, -  
Kur akoma një burrë fisnik ishe ti,  
Dhe un' poeti yt isha për miqt' e mi!

**Shënime B.P.:**

1. *Mirroni* - [mirrë - vaj ulliri aromatik që përdoret në kishë për pagëzime dhe vjen nga fjala “mirros” që përdoret në kishë, lyerja me vaj]
2. *Kajsia* – fruti kombëtar Armen

# UDHËTARËT E RRUGËS SË QUMËSHTIT

## Vihanit të dashur

И ТАК МЫ ЖИВЕМ, ЧТО НЕЛЬЗЯ НАМ НЕ ЖИТЬ  
Dhe kështu jetojmë, sepse nuk mund të mos jetojmë?

Dy udhtar' të Kashtës së Kumtrit ne jemi,  
Dy udhtarë me rrobat rrugëve shqyer.  
Dhe e duam trazimin që në shpirt kemi,  
Nga trishtimet dhe dashuritë ushqyer.  
Dhe e duam trazimin në shpirtin tonë,  
Çdo lloj dashurie, trishtimi kalimtar.  
Dhe duam, nga mëngjesi në mbrëmje vonë,  
Rrugëve të bredhim, përjetë ëndërrtar.  
Largësitë e rrugëve qiellore,  
Të magjishme, ruajm' ne në sytë tanë  
Dhe kalojmë nëpër rrugën tokësore,  
Ku plot njerëz ëndërruan dhe më s'janë.  
Si mjegull na shkoi ne fëmijëria,  
Gri, pa diell, e pakthysmja fëmijëri.  
Si kllapi na shkoi ne fëmijëria,  
U larguam. Dhe më s'u kthyem në shtëpi.  
Të heshtur vazhduam, ecëm pa pushuar,  
Largësit' hyjnore duke ëndërruar.  
Kërkim i përjetshëm u shndrrua jeta jon',  
E errët, e kot', e çuditshme jeta jon'.  
Dhe në ditët laramane, ngjyra – ngjyra  
Me flakë të gjallë u ndez shpirti ynë, -

Por sytë tanë – askund diell nuk panë,  
 Dhe as largësi të ndritshme - shpirtrat tanë.  
 Dhe sytë tanë përherë mjegulluar  
 Kërkuan në sytë rastësorë çdokund  
 Rugët e Qumështit ngjyr' ar i kulluar,  
 Atë vend të largët, pa kufi, të pa fund.  
 Por në syt' e tyre askund ky vend s'u gjet,  
 As në shpirtra – diej që shkëlqenin si ar,  
 Dhe u shfaq nga vështrimet tona i pajet'  
 Shpirti ynë jetim, ky shpirt ëndërrimtar  
 Dhe dëshirova një lavd Zotit t'i këndoj,  
 Dashurin' e ndritshme dhe bukën të lëvdoj,  
 Shpirti m'u mbush ... por s'e di përse, s'e kuptoj, –  
 Mërzis' së ditëve gri pashë t'i këndoj...  
 Në sytë e mi thellë mbeti varrosur  
 Një përrallëz me sykaltërtën e lumtur;  
 Dhe m'u ndrydh shpirti, pa dritë, shterp ngurrosur.  
 Mos vall' në jetë askush s'na ka kuptuar,  
 Dhe qeshën haptazi para syve tanë?  
 ... Trishtimet tona kanë ironizuar –  
 Dhe shkuan. Asnjë dritë nuk sollën pranë.  
 Motra qeshi, shoku vuri buzën në gaz,  
 Të tjerë pasi na shanë, shkuan më pas.  
 Veç prostituta më puthi nëpër mjegull,  
 Dhe i marri përshëndeti me gjys' zëri.  
 S'ka gjë, që ditët tona si ethet shkuan,  
 Një jet' të tër' në kllapi u torturuam,  
 - Do qeshim, vdekjes - të qeshur j'u gëzuam,  
 Dhe n'ëndërr ëndërruam dhe u larguam ...

\* \* \*

Në ditët e mia të bëhem i madh dhe i pavarur dhe kam dëshiruar,  
Në ditët e mia unë desha jetën ta shuaja duke dashuruar.  
Në ditët e mia ish shumë vështirë të bësh diçka, diçka të paharruar,  
Në ditët e mia ish histori shfaqja e çdo fjale, çdo fjal' ish e çmuar.

Në ditët e mia vetëm kënga e tyre ishte e madhe dhe e çmuar,  
Që shtytje i kishte dhënë jetës, akoma të pagdhundur, të paformuar,  
Në ditët e mia ish shumë vështirë kënga, kënga që jetës i thurret,  
Çdo fjalë – qoftë edhe një fjalëz, ishte madhështi, ose – dështim i errët.

Por në ditët e mia po lindte sërish nga e para botë e bekuar, -  
Dhe i madh jam unë, një marshim i madh nga Historia më ish parashkruar!  
Këngën e dit've të mia, nëse tani nga vargjet e mia do e dëgjosh –  
E thellë dhe madhështore është, si unë – i madh, për këtë do m'vlerësosh!

Dhe nëse do të kem diçka, me të cilën mund të krenohem, ai do jetë,  
Ritmi i ditëve plot vrull, zëri im i patrembur i ditëve të mia!  
Përshëndetje ditëve të mia, frymës së pafund të ditëve të mia,  
Dhe krahasuar me ato dit' të mëdha – s'jeni asgjë për këngët e mia!

Por nëse ka në këngën time ndonjë tingull, apo fjal' nga ditët e mia  
Në to do mbetem si vullkan i përjetshëm, dhe nga vdekja do zgjohem përsëri!  
I madh jam dhe madhështor me ditët e mia, zjarr i përjetshëm – këtë e di,  
Përshëndetje, kënga ime, gëzimi im, libri pa fund i dit've të mia!

## GJUHA JONË

Gjuha jonë është ledhatare dhe si asnjë,  
Burrërore është, e ashpër; nga ana tjetër  
E shndritshme është, si far që ndezur rri gjithnjë,  
Dritë e pashuar që prej shekujsh shumë' të vjetër.

Dhe mjeshtra, të thjesht' dhe gjenial', kanë punuar,  
Si mermer gjatë viteve e kanë latuar  
Dhe ndonjëherë shkëlqen ajo porsi kristali,  
Dhe ndonjëherë ashpërsohet, porsi gur mali.

Por gjithnjë e ka ruajtur ajo shpirtin gjallë;  
Dhe nëqoftëse sot e godasim ndonjëherë,  
E bëjmë se dëshirojmë që ndryshk të mos zerë  
Nga mendimet e reja që sjellim herë-herë.

Kjo vjen ngaqë shpirtit tonë të sotëm në shpërthim  
Ajo tashmë nuk është' e mundur t'i jet' kufizim  
As muzikës aq të çuditshme të Derianit,  
As mrekullis' së pergamenës së Narekanit.

Dhe aspak këngëtarit të shkëlqyer të Lorit,  
Dialektit të lasht' fshatarak të Tuman'janit,  
Pasi ai vjen – me gjuhën si produkt i hekurt  
Dhe me mendimet aq të thella dhe tokësore!

**H.T.**

Unë lexoj atë dhe them, -

Ky Lorias i aftë, gjenial,

Një ditë bashkë me Homerin, Kjutin, të barabartë, për qejf ishin ulur,

Dhe kupën mbante bashkë me ta, lëvdata jepnin e merrnin,

Ashtu si gjyshërit e tyre bënë dikur me njeri tjetrin në raste gostish.

1933, IV, 15

**H.T.**

Ai i madh ishte me tokë, me gjak. – Rrënjët në tokë kishte ai.

Këngët e tij – me djersën e fshatit Nairian i njomte ai.

Në këngët e tij gjeniale – shkëlqente dielli i tokës së tij. –

Ai i madh ishte me tokë, me gjak. – Rrënjët në tokë kishte ai.

1933, IV, 17

**H.T.**

Ai ish më i madh, se sa u bë. – Si qielli i pakufishëm,

Si oqeani i madh, shpirti i tij përmbloodhi gjithë jetën e pafund.

Dhe, qëndruar në brigjet e shpirtit, ai vështronte me shikim të ndritshëm –

Dhe ndiqte këngë dhe mendime, dhe shihnte ëndrra me sy hapur ...

1933, IV, 15

**A.M.**

Qielli Nairian ish brenda teje, me rrezet plot me zjarr,

Shkatërrues për tokën tonë ti erdhe si varkë për shpëtim.

Dhe halleve, që kishim që nga kohët e lashta, u dhe drejtim;

Dielli Nairian ish brenda teje, me rrezet plot me zjarr,

1933, IV, 16

# 1

Natën, krejt i sëmurë, dalë mendsh,  
Për të artin diell ëndërrova.  
Përreth asnjë zë, as pëshpërim' s'kish –  
Përreth, nat' edhe hën', - pa ngjyrë ish.

Të artin diell un' ëndërrova,  
Botën e të marrit dëshirova,  
Frym'n e dijes ta dua kërkova,  
Të fjalës plot zjarr, që diell më ngjan, -

Por përreth, aq zbehtë, aq butë ish –  
Nuk kish fjalë, dhe as diell nuk kish ...

## SHAMIRAM

Një mbrëmje në rrugicë e pashë atë.  
Një peri syzezë, vetë – Shamirami.

Dy nuska të lashta m'u duk se më vari;  
Dy të puthura – në rrug', tek trotuari.

Pastaj më drejtoi në kështjell'n e vjetër.  
Fenerët e qeshur rrugën na ndriçuan.

Ndonëse shumë vite kishin kaluar,  
Si n'ëndërr ish, veç trupi – pak i rrëguar.

Për të vlen të thuhet - dukej vajzë e re,  
Por në syt' e shuar nuk kishte më hare.

1916

\* \* \*

Këng'n e vet qyteti është duke kënduar,  
Ndërsa unë – i heshtur dhe i trishtuar  
Mbi urë po qëndroj tani i menduar  
Dhe shoh ujët e bollshëm duke vrapuar.  
Shoh i qetë, i përhumbur, i harruar.  
Shkojnë ujrât e pafund duke vrapuar.

Përmes shkumës ja ku duket një Najadë  
Më kapi për duarsh dhe pran' saj më thirri.  
Pastaj si n'ëndrrën e fëmijës në gjumë –  
Filloi të përzjejë të bardhën shkumë,  
Dukej sikur ngutej urën të kalonte,  
Që t'arrinte ujin që nuk po ndalonte.

1916

\* \* \*

E di, pa dyshim, që do të vdes një ditë,  
Dhe rrug' e jetës sime do të përfundoj'.  
Por t'harruarat këngët e mia, dritë  
Do të më bëhen, nën tokë do depërtojn'.

Dielli sërish do shfaqë i gëzuar,  
Katër rreze si thesare të ndriçuar.  
Dhe nëna për një çast s'ka për ta besuar,  
Që unë kam lindur, jetuar dhe shkuar.

Dhe kur të vdes, arkivoli të mbërthehet,  
Fajet do fshihen, fjal' t'ëmbra do të thonë,  
Dhe jet' e shkuar në legjendë do kthehet,  
Si ditët e mia pa kthim, plot jehonë!

1916

## POETI

Për mua e keqja në të mir' u shndrrua,  
Dita e pangjyrë – ëndërr e magjishme;  
Gjithë ngjyrat e kësaj bote i dua,  
Të tokave larg dhe yjeve të ndritshme.  
Dhe këngët e udhtarëve shkalafitur,  
Vrap'n e karrocave, rrugët e qytetit,  
Që në ëndërr të largët kthehen papritur,  
Që vazhdon ta joshë shpirtin e poetit.  
Kur buzët e gruas un' jam duke puthur,  
Buzë, që me mijra njerëz kanë puthur –  
Rri me shpres', se simotrat e tyre buzë  
Akoma të virgjëra janë – pa puthur.  
E kush e kupton çfarë kërkon poeti,  
Ndërsa e sheh rrugicave duke bredhur?  
Shpirti i tij hyjnor, me krahë pajisur,  
Larg, përmbi yje fluturimin ka nisur.  
E kush e kupton, se përse ndodh që ai  
Ndërsa puth buzët e puthura të gruas,  
Në po at' çast i lutet ai përsëri  
Simotrës së largët që nënë hije rri?  
Kush e dëgjon at' këngën e shpirtit të tij,  
Këngën e marrë, apo të të dalit mendsh?  
Por duke vdekur buzëqesh, dhe thot' ai,  
- Qofsh bekuar, Jet'! E hatashme ishe ti!

## KALIMTARIT TË RASTËSISHËM

Edhe ne të dy, gjithashtu, në këtë bot' ku kthimi s'ekziston  
Po jetojmë, qëndrojmë, shkojm' – po ku?; po njëlloj e ardhmja jon'.

Ndal kalimtar. Qëndro. Të shohim. Le të shihemi – ndoshta tok  
Papritmas qeshim, dhe pa qenë të njohur - bëhemi si shok'.

Qëndro, mos u largo, ku po vrapon, ku po shkon me kaq nxitim,  
Mos shpreson të gjesh qeshjen e artë si zjarr brenda syrit tim?

S'je i gëzuar që jemi gjall' – dhe njeri tjetrin po takojm'?  
Për ku nxiton o vdekatar, rrugë pa kthim është kjo ku shkojm'!

Edhe un', i vetëm, i trishtuar, shkoj – në udhën pa kufi,  
Rrugën e ëndrrës, ku këtë mbrëmje si i verbër hyre ti.

I verbër hyre ti, nuk pe dhe u largove nëpër mjegull;  
Por un' gjatë do ta kujtoj fytyrën tënde ashtu turbull.

Do të mbaj mend, si kujtim do ruaj, që në këtë rrug' pa kthim  
Dikush shkoi; ishte mbrëmje, ishte mbrëmje plot me mjegullim ...

## ARTISTI (në kujtim të P. Aghamjanit)

“Shpirti im – si tempull plot me drita brenda,  
Shpirti im - si pus i mbushur plot me ëndrra;  
Të Mirën dhe të Keqen, brenda shpirtit  
Si zjarret i dogja – për hir të Mjeshtrit!  
Nëpër damarët e mij mbretërorë  
Rrjedh i Hamletit, Lirit, gjaku mbretnor  
Un’ – emra pa fund, un’ – fluturim dhe zënk’,  
Unë – i pasionit zjarri hyjnor ...  
Kur brenga një mbrëmje më kish pushtuar,  
U shfaq në figurën e Mjeshtrit – im at’ ...  
Dhe nëpër kujtime duke gërmuar  
Shpirti më dënosi, thashë kaq e pat!  
Dhe mua, në ankthin e marrëzisë  
Në të Maurit kështjell’ mbretërore  
Shpirti më plasi, zjarri i dalldisë  
Në makth m’u shndrrua, dhimbje ç’njerëzore!  
Dhe i marrosur, vetëm, durova dhimbjet,  
E Desdemonës që lindte – nga Mjeshtri!  
- Turma, ndërkaq, shpirtin tim, si Hagoji,  
Ashtu kryqëzuar në varr e çoi!”

\* \* \*

Shkumë e purpurtë, shkumë posi ar,  
Do përhapem katër anësh dhe do derdh  
Pika-pika këngët e mia plot zjarr;  
Me këngë të qesh për gjithçka në kët’ bot’,  
Që kur të vdes të ndjej, që ndonse shkuan  
Ditët e mia, ato nuk shkuan kot.

# VJESHTËS

## I

Një shtresë të hollë resh dielli argjendonte,  
Dhe drita e tij në retë vende-vende shponte.

Qetë-qetë ngjyrë argjendi ngrihet dielli;  
Porsi akull tretet ngjyrë qumështi qielli.

Dhe me një vështrim të ftohtë, ashtu sikur më kot,  
Rrëshqasin dritat, njera – tjetrën pa e kapur dot.

1919

## II

Vjeshta po i shkund gjethet e verdha tani,  
Dhe shiu fluturon nëpër fusha tani.

Oh, shpirti im, i heshtur je dhe kënga t'është e trisht',  
Të gjitha shpresat e ëmbla po m'i rrënon tani.

Porsi pranver', si gjelbërim kaloi zjarri yt,  
Dhe era lulet e vyshkura po i mbledh tani!

1919

## PAGJUMËSI

Trokasin, trokasin, kuajt këmbët trokasin  
Trokthojnë në errësirë, patkonjtë trokasin,  
Patkonjtë kërcasin, me forcë tokën godasin,  
Natës së pafund në rrugën ku mund të humbasin.  
Herë jan' afër, herë larg, patkonjtë kërcasin,  
Ecin, ecin kuajt, sikur prapa u vjen ndjekja,  
I ndej në tëmthat e mi patkonjtë të kërcasin, -  
E panjohur është bota, ecën edhe vdekja ...

1919

\* \* \*

Zhurmon në shpirtin tim natë për natë një trishtim,  
Zhurmon, si një erë e shurdhët dhe në largësi,  
Zhurmon, derisa drita të shfaqet si me dyshim,  
Dhe numëron ditët e mia, çastet një nga një.

Në mesnat', në qetësi, një zhurmë që s'e kap dot,  
Shurdhët troket në zemrën, trurin dhe në shpirtin tim;  
Dhe duket sikur kënga e saj nga një tjetër bot',  
Krejt tjetër, po afrohet që nga larg në shpirtin tim.

Befas brenda meje zgjohet një kaos mijvjeçar,  
 Dridhet, lëkundet, si oqeani i tërbuar,  
 Si koha e paformë, e vrullshme, gjithnjë zgjuar,  
 I pavendosur, n'errësirë, si i hutuar.

Dhe herë tingëllon si një këng' në mjegullën e paan',  
 Dhe herë si një fëmi' i sëmur', i pafuqi, që qan,  
 Dhe herë ulërin si qen, trishtueshëm, shpresëhumbur,  
 I heshtur dhe lunatik, natës së qetë i përhumur.

Dhe dëgjon këngën e atij kaosi t'errët shpirti im,  
 Zhurmën e turbullt të tij, ulërimat mbushur plot tërbim.  
 Dhe po ashtu do të rrjedhë jeta ime, unë e di,  
 Deri sa të shuhet në oqean të kripur përgjithnji!

1919

\* \* \*

Është errësirë, natë është. Në terr po pres.  
 Dhoma është pa dritë, e heshtur është mbrëmja.  
 Nata zhytur brenda errësirës rrjedh edhe flet,  
 Dyshimi dhe ankthi zemrën ma grryen, po ma vret.

I heshtur jam. Po dëgjoj. E pafund është nata.  
 Ndërkaq errësira shtohet, shtohet, dhe veç shtohet.  
 Dhe shpirti im kujton ato ankthe aq të gjata,  
 Me ankthe dhe vdekje, ah, shtëpia më mbulohet.

U shkulën Cerberët. Në errësirë diç' po thon'.  
 Pëshpërisin të padukshëm – por shpirti m'i dëgjon.  
 Çdo tingull për mua enigmë dhe ankth do të mbes'  
 E vështirë si vdekja është pritja e pashpres'!

1919

Tani po kujtoj gjithë ditët e mia të vjetra dhe të shkuara,  
Ditët e mia plot dritë dhe me krahë, të vjetra dhe të shkuara.

Dhe më ngjan se ato përsëri duke fërshëlyer do të më kthehen  
Të zjarrta si fëmijët - ditët e mia të vjetra dhe të shkuara.

Por ato vijnë të heshtura, dhe të lodhura, dhe të trishtuara,  
Si udhtare pa rregull - ditët e mia të vjetra dhe të shkuara.

Si shtegtare janë ato, nga shtëpia me kohë të larguara  
Dhe tani sërish po vijn' - ditët e mia të vjetra dhe të shkuara.

Dhe rrinë tani në heshtje mbi shpirtin tim të plakur, të trishtuara,  
Dhe ndihen të lodhura - ditët e mia të vjetra dhe të shkuara.

Dhe nuk thërrasin askërkënd; janë të heshtura dhe të menduara -  
Gjum' kërkajn' dhe qetësi - ditët e mia të vjetra dhe të shkuara.

**1920**

# KUJTIMIT TË VAHAN DERJANIT

## I

Vahan Derjan, o miku im, kujtimit tënd si t'i këndoj,  
Sonte errët është', para meje heshtja le të mbretëroj'.  
Mbi shpirtin tim një shtëllung' e errët reje le të zbresë,  
Era le të sjell' lajmin mortar dhe shiu të dënesë.  
Dhe gjethet e verdha të vjeshtës qark le të më rrin' shtruar  
Dhe të zbukurojn', Vahan Derjan, udh'n prej teje përshkuar.  
Dhe nëpër mjegull, këngë të trishta me tinguj të pastër  
Le ta nanurisin trishtimin tënd, miku im i largët!

## II

Tashmë ti s'je më në këtë botë, je larguar,  
Dhe kënga jote tanimë vërtet ka pushuar,  
Por shpirti ma ndjen, që ti do të kthehesh përsëri,  
Kur të zbresë mbrëmja dhe të filloj' të bjerë shi.

Kur të zbresë mbrëmja dhe ca kujtime të vjetra,  
Gjemba të së shkuarës, hidhur të lëndojnë kot,  
Si jetim do vish dhe do këndosh dashurin' tënde,  
Dashuri që ndoshta e fundit është në këtë bot'.

Si jetim ti do vish dhe përsëri kënga jote  
Në shpirtrat tanë mall dhe dashuri do të ndezë,  
Në shpirtrat tanë të pa diell kjo kënga jote  
Ëndrra të pavdekshme dhe shpresa për drit' do ndezë.

Dhe do rindjejm', që ti pranë shpirtrave tanë je,  
Si zjarri, që vlon gjakun tonë të sëmurë, ngjan,  
Që kënga jote plot dritë mall në shpirt sjell për ne,  
O, miku im i largët, miku im, Vahan Derjan!

### III

Ti – dritërrezatues, shkove dhe më s'je,  
Ti – fluror, pa trup, i pakufishëm më je,  
Ti, një tjetër ëndërr e hareshme më je.

Në shpirtin tonë përjetësisht ndeze ti  
Zjarre të fsheht' e të pashuar ndeze ti.  
Thesare drit'-lëshuese shpërndave ti.

Dhe asnjëherë, kurrë nuk do të zbehet  
Kandili yt në terrin e shpirtrave tan',  
Ky kandil – që një mall të largët gjallë mban.

## SONETI I KUQ

Poeti është gjithnjë pranë njerëzve,  
kur kërcet shtërngata.  
BRJUSOV

Si kamë nga këllëfi i ditëve që kanë shkuar  
Del e rënd' dhe e purpurt, të ardhmen ndriçon an' e mbanë,  
Dhe nuk hyn përsëri në këllëfin me pluhur mbuluar,  
As varroset bashk' me ditët, që u dogjën dhe më s'janë.

Çfarë kërkon, o të shkretë, kjo e juaja marrëzi,  
Dhe trishtim' i pashpres' për vdekjen që i vjen botës suaj,  
Atij, që ditët i dhan' jetë, dhe këndoi poezi  
S'i hyn në sy shqetësimi dhe llahtar i ankthit tuaj.

E mençur është tani, nga mllef i ditëve të tërhiqesh  
Ashtu si futja e shpatës së pluhurosur në këllëf  
Kur pa dashur të duhet me kundërshtarin të përballesh.

Dhe unë, poet i ditur, tashmë përsëri po këndoj,  
Ditët tërhiqen, mbesin pas, largohen dhe më nuk i shikon,  
Dhe nxiton kënga ime, shigjet', drejt të Ardhmes që ndriçon ...

**1921**

2

Vallë kë do të takoj, kë do përshëndes,  
Kujt do ja dëgjoj fjalën që në shpirt të prek?  
Kush do të më shfaqet me fytyrën që qesh,  
Me përqaftim'n e mikut që vërtet më desh?

Kush do të të puthë, me dënese kush qan,  
Kush do të mrekullohet me vrullet intime?  
Ndoshta diku jashtë, dikë kjo botë mban,  
Që bashkë me mua vuan jetën time.

Ndoshta nga këngët plot mllef që nxjerr shpirti im,  
Nëpër fjalët e shkruara për shpirtin tim,  
Për ëndrrën e largët të dikujt jam gabim,  
Dhe për ëndrrën e singert' të hedhur me besim.

Ndoshta, në ëndrrën e tij duke jetuar,  
Po këndoj të thellat shqetësime të tij;  
Dhe më ngjan se në këtë' botë të trishtuar,  
Vetes po i këndoj, jetës së vetmuar.

- Përshëndetje ty, kushdo që je, mik i panjohur,  
Paqe dhe qetësi për ty, o vëlla i largët!  
- Përshëndetje juve, të palindur të së ardhmes!  
- Përshëndetje juve, vëllazërisht dhe miqësisht,  
Juve që kaluat në humner' të diturisë,  
Me buzëqeshjen e trishtuar të mirësisë!

## ZARENC – NAME

Mendimet tuaja un' për një çast  
Sot do t'ja jap këngëve të gurta. –  
- Një poet i pastreh', i uritur,  
Ky jam unë – Jeghishe Zarenci.

Kam ardhur që larg, që prej Iranit.  
Babai im është – Khani Makun.  
Në shpirtin tim – diell i Iranit,  
Diell i Iranit është në shpirtin tim.

Kurse në gjakun tim këndon i imi,  
I pafundmi Nairian trishtimi ...

Ndërsa nëpër trurin tim dogja  
Zjarrin flakë të kuq Moskovit.

Në shpirtin tim arom' e lules,  
Ndërsa në tru – zjarr le t'më hyjë.

- Ndërsa tani, njerëz, dëgjoni,  
Shah-Namen e Zarencit poet ...

I

Porsi dielli zjarr i artë  
Nga Irani hedhur në Nairi,  
Nga Nairi hedhur në Moskë,  
Jetës time tash i këndoj,  
Me diell,  
Me gjak,  
Me ar.

Dhe me çfarë mrekullie do mund ta kthej  
Timonin drejt ditëve të paqena?

Kënga ime le t'ju marrë juve fluturim,

Nairi,

Kars,

Fëmijëri ..

Në Kars jam unë tani,  
Përsëri,  
Përsëri

Me buzë fëminore të varura,  
Nënë po shikoj  
Përsëri;  
Gjinjtë si dy hinka ...

Ende në shpirt një shigjetë më qëndron,  
E lidhur me harkun e ditëve të mia.

Nga larg – troket ankthi.

Ja dhe babai, xhyben veshur ...

Fytyra e tij si tabaka argjendi,  
Mbi të hunda, me një çarje thike.  
Nirvanë e bardhë – përmbi flokë  
I ka derdhur kohën pa dashuri.  
Ndërkohë nëna shkon për ujë,  
Mbi kokë, vellon e Teheranit ...  
Vërshëllen era e Nairit;  
Dëshiroj të ulëras.  
Para duarve më shfaqet  
Shpirti, si djalë jetim,  
Dëshiron – diellin përvëlues të jugut,  
Dëshiron lindjen e diellit ...  
Dhe kur nëna dëborës së rënë mbi flokët e saj  
I shtie kënanë e errët me shkëlqim ari,  
Duket sikur, nëpërmjet flokëve  
Unë mund të shkoj në Teheran.  
Unë mund të shkoj në Indi,  
Të zotëroj thesaret e Shahut ...

Fëmijëri ..., zog me krahë të artë ...  
Flori i verdhëremë i së shkuarës...

## II

Kam lindur në qytetin Maku,  
Nën diellin rrezeartë, i rritur,  
Nën ajrin e nxehtë në cep të Hormuzit,  
Në vitin 1897.

Dielli i Iranit ka derdhur  
Lulet e Shirazit në shpirtin tim.

Por era e trishtë Nairiane  
Shpirtin tim me trishtim e ka ngarkuar.  
Dhe përpara meje i sapo zgjuar  
Një qytet i vjetër kishte qëndruar. –

Në Kars, qytet pa ngjyrë, u rrita  
Atdheun larg duke lënë.

Sytë, ashtu si edhe krahët  
Ende dremisnin të hutuar;  
Kur më pushtoi një trishtim i hershëm,  
Si shtëpin' për shërbyesin e vjetër.

(Ai ish rritur në shtëpinë tonë,  
Kish qenë që në kohë të gjyshit tim.  
Kishte mbetur, i lodhur dhe i plakur,  
Priste, që në qiell të shkonte.  
Ne atij “gjysh” i thërrisnim,  
Ai më çonte mua në rrugicë,  
Kishte qejf çdo gjë ta derdhte,  
Betohej për tokën Nairiane ...)

Ulur në shtëpizën atërore,  
Ai gërhiste si macja e shtëpisë.

Por shpirti im me pikëllim ngarkuar  
Ëndërronte diell edhe gaz.

Dhe për sa kohë ish ai, trishtimi i vjetër,  
Mbuluar kish diell dhe Iran;  
Si një mësues tashmë i plakur  
Një ditë më çoi në shkollën pran'.

N'atë diell dhe Iran mbuluar,  
Ai, si gjyryk duke gulçuar,  
Mbi të trurit cipë më ngjiti,  
Shkrime të vjetra më nguliti ...

(Në shpirtin tim  
Prej kujt  
Do ta dija,  
Që rryma e këtyre shkrimeve të vjetra  
Për krahët e pamposhtura të shpirtit tim  
Do të çelte qiej të pafund?

Që më pas,  
Vite më pas  
Nëpërmjet tregimeve të shumta,  
Anijeve të mia me vela të bardha  
Ai do t'u jepte më shumë erë edhe diell ...)?

Fëmijëria ime e qetë, e kaltër,  
Si disk i argjendtë i hënës  
Rënë mbi liqen më je ti.

Ti ishe – dhe tani nuk je më ti,  
Përballë diellit ti, i butë, hangar;

Por vërtet i tillë ishe ti?

### III

Dhe ja tani – unë jam fëmijë  
Katërmbëdhjetë, pesëmbëdhjetë vjeçar.

Tashmë ty – ty do të këndo,  
I ndrituri miku im i largët.

Astik. – Atë emrin tënd  
Thellë në shpirtin tim e ruaj – ndezur.

Që si vela e rënë përmbi det  
Atje të mbetet ajo përjet'.

Oh, jo rallë, por shpesh, miku im,  
Që të mos mërdhij ky shpirti im  
Un' kujtoj herë pas here, sipas rastit,  
Vreshtin e gjelbër të qytetit të Karsit ...

Dhe kujtoj –  
Çfarë?  
S'e di. -  
Më kujtohet n'atë verë  
Buzëqeshja jote –  
Trishtimi,  
Pa krahë  
Këmisha ime – e mban mend? – e bardhë ...

E mban mend? ...

Ah, çfarë të mbash mend? ...

Ah, nuk ka gjë për të mbajtur mend! ...

Vjeshta  
Gjethe këputi –  
Fluturat e kujtimeve të zbehta ...

Më fal ti mua,  
Më fal miku im,  
Për gjithçka të ndritur që ke krijuar –  
Unë një fëmijë i pamend isha  
Katërbëdhjetë, pesëmbëdhjetë vjeçar ...

## IV

Dhe  
Ja-  
Në vitin dymbëdhjetë-  
Për herë të parë .. atje ..  
Të parën puthje dhashë-  
Ty ...  
Kujtim pa krahë.

Unë dëshiroja - vapë,  
Iran ...  
Lule të kuqe të Shirazit. –

Por gjeta ...  
Mbi ...  
Shtrat ...  
Hallakatur ... një trup ... të ftohtë ...  
Më fal, Astik Gondahçjan,  
Miku im i ndritur ...  
Më fal ...

Unë ...

Pas kësaj ...  
Kalova nëpër botë -  
Por atë që lashë, mbrapsht nuk e solla ...

I dashur,  
I ndritur  
Gondahçjan-

Më fal ... o ...  
Më fal ...  
Më fal ...

## V

Dhe ja  
Për të parën  
Herë ...  
Atje ... në po atë vit-  
U shfaq një tjetër i paqenë  
Emri ... Toka Nairi.  
U shfaq.  
Sikur s'ishte.  
Sikur s'kishte lule.

Erdhi-  
Mbi supe  
Një trishtim të pafund na ngarkoi.

U duk sikur -  
Jam duke parë nëpër mjegull  
Një vajzë të kaltër, të kaltëroshe. -

E ngjashme ishte – me pluhur të lashtë  
E ngjashme ishte – me një fatkeqe të gjakosur.

Mbi buzët e bardha  
Kishte ... plagë të verdhëreme.

I dhashë asaj shpirtin tim-  
Desha, që asaj t'i këndoj ...

\* \* \* \* \*

## VI

Oh, këndoi asaj -  
Të parës,  
Të parës ..

“Tre këngë” ...  
Astik Gondahçjan,  
Do t'i këndoj  
Të shkretit hirit tim

Dhe kurrë, kurrë  
S'do të pendohem ...

## VII

Dhe vetes mendim të ri  
S'i solla -  
Dhe as vreshtit të Karsit -  
Në fund të viteve pesëmbëdhjetë -

U zgjova ... në rradhët e ushtrisë.

Vullnetar.

Ushtria Armene.

Armë. Pushkë. Bomba

Dhe ja, miq të rinj, lloj-lloj.

Nga Nju Jorku, nga Bazeli, nga Stambolli ...

Vdekje!

Vdekje!

Vdekje!

Përgjithësisht, publikisht.

E ushtarit, vajzës, nuses. -

Unë kujtoja – atje,

Nën gjëmimin e tmerrshëm të bombave

Që të gjej fytyrën tënde plot dritë.

Por gjeta ... trupa të drunjtë,

Dhe pashë një tokë, të cilën ti

E braktise nga dyndja jonë e zezë.

Dhe zbriti trishtimi i vjetër

Dhe shpirtin ma ndrydhi, ma ndrydhi ...

Dhe përballë meje plot qartësi

Ndriçoi udha jote si për mrekulli...

## VIII

(Po pastaj, çfarë, që - në po atë vit  
Shtypshkronja “Progres” në Tiflis  
Njoftoi për krahun tim të thyer  
Në betejën e përgjakshme ...  
Dhe në vitrinën e pluhurosur të “Libri”-t  
Vendosi një broshurë të vogël.

Vjershat e mia kujt vall’ i sollën trishtim,  
Po vargjet e mia të zjarrta Danteske?)

## IX

Por  
Pastaj -  
Në vitin e pesëmbëdhjetë -  
Kur erdha, arrita në Moskë -  
Ndjeva një dridhje të madhe  
Në krah ... Një dhimbje të frikshme.

U duk sikur -  
Tashmë po arrija  
Skajin fundor të botës, -

Por si një mburojë prej ari  
U ngrit dielli i Iranit ...

Papritmas në shpirtin tim lulëzuan  
Lulet e Shirazit të largët ...

Oh, shpirti im, me kokë poshtë re -  
U kape ... pas flokëve të vajzës.

Të zgjuan vitet e largëta -  
Si nga hingëllimë e kuajve ...

U zgjua një e zjarrtë dashuri ...

Karine.

Karine Kotançjan ...

## IX

“Ylberi” ...

Dielli është andej, -  
Në mes të pikëllimit Nairian,  
Zjarr i burgosur në shpirtin tim  
Dhe donte patjetër të shuhej.

Dielli i Iranit ishte përvëlues -  
Kaltërsia e Nairit ish plot dritë ...

Dhe pikëllimi – mbytës, ndrydhës, -  
I përzier me zjarrin ngjyrë ari.

(Në botën që në terr akoma ish  
Si dielli Nairian - nuk kish...).

XI

Në Moskë.  
Tetëmbëdhjetë vjeç.

Në shpirtin tim – diell i Iranit.

Dhe deshi dielli i babëzitur  
Të gëlltiste vitin që po fillonte.

Janar ...  
Shkurt ...  
Njëzet e gjashtë.

Plasi, si guri prej ngricës. -  
Dielli, puntor i zellshëm,  
U rrokullis me vrull të hatashëm.  
Çfarë? ...

- Vigan,  
Një gur i stërmadh,  
Që qëndruar kish mbi shpatullat tona.  
Thëthinte gjakun tonë, i babëzitur, -  
Dhe na fuste një të ftohtë polar.

U rrokullis.  
Dhe ashtu kot,  
I lëkundur,  
Priti për një çast, nuk shkoi.  
Ishte hapur – një e çarë e pa fund.

Kishte goditur një makinë të vjetër.

\* \* \* \* \*

Kishte qëndruar në fillim të rrugës,  
Pas kish lënë - vite të errët.

Dukej si e trembur nga vrapi ...  
Karine ...  
Karine e marrë ...

## **XII**

Në shpirtin tim – diell i Iranit  
Ish përpirë porsì zjarr.  
Dhe i fortë – si granit,  
Trishtimi i vjetër Nairian.

Vallë më kot skifter i epsheve të tua  
Më ndoqi pas për vite të tërë?...

Hidhërim ish bukuria jote mishtore -

Karine ...

E ëmbël – Karine ...

XIII

Si guri – ngelur në mes të rrugës,  
Që do rrokulliset përsëri -

Në shpirtin tim me hidhërim pa fund  
Po priste e fundit fatkeqësi.

Mik i fortë, si granit,  
Dëshpërimi yt i lodhur prej mjerimit tim -  
Që diellin e artë Iranian  
E përzinte me trishtimin Nairian ...

Dhe ja tani -  
Qershor,  
Korrik ...  
Dhe ja tani -  
Shtator,  
Tetor ...

Çekiçi goditi – kudhrën.  
U derdhën predha gjigante.

Dhe predhat – me këngë të përgjakura  
Goditën në errësirën e trurit tim .

Dhe nëpërmjet predhave të kuqe  
Ëndrrat ja dërgova – erës.

U rrokullis, si granit,  
Pikëllimi yt i lodhur prej mjerimit tim.

Dhe dielli i artë Iranian  
U mpleks me pikëllimin Nairian ...

## XIV

Tetëmbëdhjetë.

Vite jetë.

Mbrëmje. Kthim. Mëngjes herët.

U çlirua nga zinxhirët e vjetër

Shpirti im, me dhimbje të madhe.

Tetëmbëdhjetë.

Vite të zjarrta.

Flakë e kuqe - në zjarrin e gjallë.

Një tingull të ri në shpirtin tim

Zgjoi dielli – Nairian.

Zjarr ishte.

Zjarr personal.

Plagë të rënda të përgjakura.

Dhe pikëllimi yt - zjarr përcëllues,

Papritmas shpirtin - si diell ma ndezi.

Flakë e gjallë. Hare. Dhe me një

Energji të pashterur ngarkuar

Shpirti im pa fre ka fluturuar ...

Kështu ishte në vitin tetëmbëdhjetë. –

Soma...

Lusi Tarrajan

**XV**

(Një verë e kuqe-flakë po rrjedh,  
Dhe afsh po ndez në shpirtin tim,  
Nëpër gjakun tim të nxehtë po kalon  
Dhe këput vargoin që më shtërngon.  
Ajo andej është – jashtë është ajo,  
Si grua, si e re Nairiane;  
Të dehur jan' nga pirja si të marr'  
Dhe botën degdisin ata në zjarr.

Ajo atje është - Lusi Tarrajan  
Nëpër lule, nëpër diellin e Shirazit,  
Mbi fushat Nairiane,

Mbi fushat e pafund të Skutisë ...

Dhe në shpirtrat e gjithë atyre,  
Që botën degdisën në zjarr.  
E largëta botë u dogj zjarr!  
– Këtu ishte në atë vit të kuq!).

**XVI**

Ushtria e Kuqe.

U derdhen përrenjtë e zinj.

Mbi fushat e paanë,  
Përplasin krahët e tu të ndritur.

\* \* \* \* \*

Stacion i trenit.

Ushtri.

Ushtri.

Ushtarakë të kuq.

Mbrëmje.

Dhe mbi ushtritë e kuqe  
Është përplasur errësira e zezë.

Thellë,  
Errësirë,

Pritje e tmerrshme,  
Nga larg, zjarre të turbullt.

Mëngjes herët – shkojmë, fuqishëm,-  
E coptojmë zinxhirin e armikut.

\* \* \* \* \*

Këtu ishte – viti 19.  
Oh, sa shumë ankth kish në trurin tim!

Dhe shpirtin zjarrit ja dhashë,  
Që ta përpijnë flakët verdhoshe.

Këtu ishte.  
Viti 19.  
Ushtria e Kuqe ishte mbledhur.

Dhe në sytë e hapur të të gjithëve  
Kishte një hare të pakufi.

Dhe pranë, ishte aq pranë  
Duke ardhur bota e re e ëndërruar ...

Besonte – madje edhe gjethi  
Që ... do të vijë, E Shumëpritura do të vijë!

Po qëndronte ajo tek dera  
Dhe dukej sikur  
Entuziazmin kish diell në ball'.

Dhe ty kurrë s'të harrova –

Tarrajan ...  
Stacion i trenit Tihoreck

## XVII

Dhe mos vallë  
Unë  
S'e këndova  
Betejën tuaj,  
Shokë të kuq? ...

Pashë vijën e hekurt –  
Kuptova, që e gjitha - e jona ishte.

Dhe në flakët e kuqe zjarrvënësit  
Duke u djegur, synuan njeri tjetrin,  
Shiun e pikëllimit Nairian  
Dhe diellin tënd të artë Iranian.

Kuptova; që ju të bashkoheni  
Dhe të derdheni si një trup i vetëm –  
Më përpara duhen bashkuar dritat  
E Parisit, Pekinit, me njeri tjetrin.

Dhe pija e lashtë Vedike përsëri  
Do të depërtojë në shpirtra të pastër.  
Por unë e kam gjetur rrugën tani,  
Ende të virgjër, pa formë, të ashpër!)

## XVIII

Më dukej sikur me mall të pafund  
Më thërriste toka në Nairi,

Në fund të viteve nëntëmbëdhjet'  
U ktheva përsëri në Armeni

Atje – në tokën e Nairit,  
Me një tjetër dëshirë të vjetër,  
Tashmë Droni, kryetar grupi,  
Po shpjegonte flamurin trengjyrësh.

Po e shpjegonte – në qytetin e Erevanit  
Pranë Masisit të lashtë.

Dhe silueta ngjyrë dheu  
Kishin mbushur qytetin e uritur.

Si gur zbriti dëshpërimi,  
Dhe mbi shpatulla  
Më rëndoi.

Dhe përsëri, përsëri të pashë ty –  
Fëmijëri ...  
Malli im ...

Kars.

\* \* \* \* \*

**XIX**

Kars.

Në vitin nëntëmbëdhjetë.

Në fund të viteve nëntëmbëdhjetë

I njëjti qiell ishte, kazan i diellit.

E njëjta pëshpërim' e ujit gurgullues.

Por dielli më kot lodhej të shponte

Sytë e qorruar të ndërtesave.

E kotë ish gurgullimë e ujit

Që ndihej nga i largëti Nairi ...

Njerëz parë në ëndrën feminare

Si njerëz të ndritur, maja lavdie,

Të njohurit e mi – tashmë nuk ishin ...

Ishte kthyer me dhimbje therrëse

Fëmijëria ime e kaltërt -

E plepit tim të gjelbër plot shkëlqim ...

Dhe përse po gëzonte ky shpirti im,

Kur një ditë një kritik shumë serioz

Duke shkelur sallën akademisë,

Përhapi lajmin nëpër gjithë botën,

Që kish lindur një poet – poet i madh? ...

Dhe lindi kështu një këngëtar i zjarrt'

Dhe solli me vete këngë të zjarrta. –

Ngazëllehu, botë Nairiane!

Ngazëllehu ... Jeghishe Zarenc! ...

XX

Jerevan.  
Njëzet vjeç.  
Shkurt,  
Mars,  
Maj.

Përshëndetje, shoku Tavakal!  
Musaxhel!  
Saruhan!  
Avis !...

Përshëndetje, të gjithëve ju, përshëndetje!  
Vullnetit tuaj – prej hekuri,  
Graniti.

Zjarrit flakë të kuq Moskovit,  
Lules, kuq si zjarri, të Iranit.

\* \* \* \* \*

Jerevan.  
Një Maji.  
Në rrugicën Astafjan – turma njerëzish.

Dalë së bashku gjithë hare –  
Çanë rrugicën për në xhade.

Dhe tani – flamurë të kuq.  
Përpara Masisit të lashtë ...

Kush do të vijë – le të vijë,  
Të ndizet,

Shpata vringëllon, zembr' e çmendur brohoret.

Zigzage –

Përshkuan kuajt e garave,  
U lidhën, Jerevan – Moskov.  
U shembën ndërtesat e vjetra  
Nën goditjet e krahëve të hekurt.

Dhe në shpirtin tim u derdhën të ndritshme  
Të nesërmet... Nga po vijnë vallë? ...  
Mbledhur si një trup i vetëm  
Qëndronte i qeshur Nairi ...

## XXI

Njëzet e një.  
Fragmenti njëzet e një.

Çfarë ndodhi në vitin njëzet e një?-  
E ardhmja le të ngulet në shpirtin tim,  
Diell përgjithnjë le të jet' shpirti tim.-

I dashur lexues! Shpirtin tënd tani  
Kënga ime le ta shpojë si me thik',  
Në Ushtrinë e Kuqe të vërtetë ...  
- I pari Nairian... isha un' vet'.

Dhe u pa në Masisin e lashtë  
Atë ditë për herë të parë  
Si një ëndërr e bërë e vërtet'  
Lufta e puntorit Nairian ...

Por  
Kur  
Pas ushtrisë u kthyem në shtëpi,  
Tashmë mua më priste  
Në tokën e Nairit ... një grua,  
Sytë – të ndezur nga zjarri,  
Buzët – lule Shirazi.

Sa shumë fytyra para meje shkuan  
Por shpirti im prej teje le të dehet;  
– Ah, sa shumë un' ty të dua,  
Arpik, e shndritshmja Arpik...

## XXII

Tani unë në Moskë jetoj  
Brenda kokës, stuhi të arta.

Brenda kokës njëfarë Robert Ouen  
Tashmë të ardhmen e ndritshme po shikon.

Poema po shkruaj, këngë.  
Ëndërroj – Të Ardhmen pa kufi.

Nairi, unë ty të dua,  
Të dua edhe ty, Irani im i zjarrtë.

Tashmë unë jam larg... Oh, jo,  
Tashmë jam akoma më afër teje;  
Ashtu si shigjeta në hark tendosur,  
Përpara gazelës që vrapon.

Shpirti im tre shigjeta kishte  
Të ngulura fort që nga koha e harqeve.-

Tani të treja kanë fluturuar –  
Kanë goditur – zjarrin e gëzimit.

Unë, nuk kam, nuk kam për t'ju harruar,  
Juve për mua në një jeni shndrruar.

Ne, me shpejtësi, si shigjetë me tre sqepa,  
Jemi gati për fluturim – Indokin', Pekin.

Pranoni, më merrni tani mua –  
Zjarrin flakërues të Moskës,

I arti im, Irani im i artë,  
I largëti im, Nairi i largët, ...

## NËPËR KATËR ANËT E HISTORISË POEMA

### DAVIDI I SASUNIT

Të kthehemi - mallkimin ton' le të themi  
Së pari për Mirzamelik'n, mbretin e marr'  
Të kthehemi - mallkimin sërish të themi  
Për Ohanin – me huqe, princin hileqar.  
Të kthehemi – ta përsërisim kët' mallkim  
Për të gjith' ata princërit tan' të tjerë  
Që na sollën vdekje, rrënim, dhe çkrishterim.  
Pastaj lavdi dhe këngë le t'i thurrim ne  
Luanit - Mher, viganit, trimit heroik,  
Davidit, djalit të tij po aq heroik,  
Mherit, atij djalit të tij të pavdekshëm;  
Që pastaj gjithë njerëzve të Sasunit,  
Ndenjur dikur mbi këta male të kaltër,  
U dhuroi kët' legjend' kaq të ndriçuar,  
Dhe shkoi pa lën' gjurm', n'ëndërr për t'u shndrruar.

Pastaj të fillojm', me rimë zbukuruar,  
 Legjendën që flet për David'n e Sasunit,  
 Që do të mbetet hyjnore – e bekuar;  
 Legjendën fjal'-art', në mençuri bazuar.

I

Mheri, së gjalli si diell rrezatoi,  
 Dhe Sasunin për dyzet vjet e drejtoi.  
 Burrë i vërtetë ish, dhe trim i çartur.  
 Në luftra të shumta i kishte drejtuar,  
 Përballë armiqve shumë të fuqishëm,  
 Që me forca të shumta kishin sulmuar  
 Tokëzën e Sasunit për të pushtuar;  
 Me këto hordhi sa herë kish luftuar  
 Me kordhën e mprehtë ai kish fituar.  
 Ishte burrë i thjeshtë dhe trim; të zjarrtë  
 E kishte kalin, shpata i vezullonte,  
 Dhe fuqia kurrë atij s'i shterronte,  
 Se popull i thjeshtë ja shumëfishonte.  
 Dhe i pamposhtur ish me kordhën e mprehtë  
 Dhe me njerëzit e thjeshtë dhe të shenjtë.

II

Në kohën e Mherit në tok'n e Sasunit  
 Jetonte një popull i thjeshtë dhe fshatar,  
 Që s'kish pasur akoma një princ të aftë,  
 Veç princa shpirtzinj, të këqinj edhe barbar';  
 Dhe jetonte në malet e kaltërt ai  
 Me punë të thjeshtë dhe me djersën e tij.

Luanin – Mher, trimin tonë kish ngarkuar  
Mbi ta si princ detyrën për të ushtruar;  
Dhe ndër male ai akoma jetonte  
Një jetë të lirë, ashtu siç e donte.

### III

Oh, tabllo ideale t'jetës fshatare,  
Të kohrave të lashta, të vjetra fare,  
Kur njerëzimi me krenari vazhdonte,  
Me pun' të vërtet' dhe të shenjt' të jetonte;  
O agime të lasht', që bartni shkëlqimin  
E ditëve të rinisë së njerëzis',  
Kur në malet e kaltërt ende s'kish çelur  
Filizi i zi i dhunës dhe egërsis',  
Kur qeverisnin akoma nëpër botë  
Kreshnikë të thjeshtë dhe trima të zotë!

### IV

Kështu qeverisi ai, kreshniku yn'  
Dyzetë vjet. – Dhe pastaj, butë, si dëbor',  
Mbi të vjetrit flokë të tij, mbi kokën e zjarrtë  
Zbriti mjegulla dhe i ftohti dimëror.  
U shndrrua në një plak të dobët flokëbardh',  
Dhe dal'-ngadal' kreshnikun e moçëm dhe trim  
Filloi të mbështjellë, ashtu si mbrëmja,  
Trishtimi vdekjeprurës dhe i pashërim.  
Zhytur n'mendime kreshniku i vjetër ish;  
Trashëgimtar' në kët' botë lënë nuk kish.

## V

Meditonte ai, kreshniku i vjetër,  
 Si do ta linte tokën pa një zot tjetër,  
 Malet e larta dhe fushat e pasura,  
 Njerëzit e thjesht', pa fuqi, të pa ditur,  
 Përball' armiqve të ligj, të babëzitur.  
 Mendonte ai, kreshniku i shenjt' si zot,  
 Që lavdia e tij do të shkonte më kot,  
 Që tokën e tij të fuqishme, hyjnore,  
 Armiq të fuqishëm, mizor', ëndërronin  
 Të nesërmen në pre dhe copa ta shndrronin.  
 Dhe kështu, në prak pleqërie afruar,  
 Meditonte ai në shpirt i trazuar,  
 Dhe pran' tij në heshtje, ashtu të trishtuar,  
 Rrinte njerëzia duke medituar.

## VI

Të ndodhte, ndërkohë, si kishte mundësi,  
 E ardhmja të ish aq e errët, pus i zi,  
 Pa trashëgimtar mbetur, pa farefisni,  
 Në gjithë këtë botë plot me njerëzi?  
 Në tokën e kaltërt kish vallë mundësi,  
 Të zbresë aq shumë trishtim i zi,  
 Dhe të mos hapet papritmas, si me magji,  
 Dera e shpëtimit për zjarrin që do vij?  
 Dhe ja – një ditë të qeshur dhe të shndritshme,  
 Një mrekulli e pafund dhe e fuqishme  
 Luanit – Mher, tashmë të thinjur, ja behu;  
 Një djalë si drit' e diellit i leu.

## VII

Leu një djalë si dritë e diellit,  
Tanimë trashëgimtar i Luan-Mherit;  
David ja vuri emrin ati plak atij,  
Dhe bekimin i dha jetës, fatit të tij,  
Që at' respekt që la mbi tok', atë kujtim  
Ta ndriçojë me fort dhe t'i japë shkëlqim.  
Dhe duke parë Davidin e tij fëmi',  
Në shpirt ai u lumturua përsëri,  
S'i t'ish rikthyer në tokë ai vetë,  
Përmes mrekullisë hyjnore të shenjtë;  
Si të kish ardhur vetë në këtë botë,  
Për të mbetur zjarr-hyjnor, njeri i shenjtë!

## VIII

E dinte tashmë, kreshniku në agoni,  
Se Davidi leshverdh' kreshnik ish, si ai;  
Dhe në lartësin' e kaltërt, madhështore,  
Sa herë të shfaqej rrezik a shkatërrim,  
David i Sasunit do të ngjitej sipër,  
Si kreshniku i ri, si i riu Mher trim.  
E dinte, se tani, në tok'n e Sasunit,  
Pranë njerëzve të thjeshtë dhe të shenjtë,  
Fatkeqësi të shumta sikur të zbrisnin,  
Pavarësisht sa kohë ato do zgjasin,  
Këtu është' Davidi, ky kreshniku ynë,  
Gjithnjë në krah të popullit tij të shenjtë  
Dhe të ndershëm, të fuqishëm, të vërtetë!

Ju gëzua thell' në shpirt krushqisë së tij,  
 Thua se nga dje ish lindur vetë ai,  
 Për të parë ditën brenda territ të zi;  
 Djalin përsëri me mall e përqafoi,  
 Fytyrëqeshur fort atë e shtërngoi,  
 Pastaj sytë krenarë i mbylli ai,  
 Duke marrë pas vetes dhe gruan e tij!

## IX

Si vdiq Mheri plak, bashkë me gruan-nanë,  
 Djalin e posalindur pas duke lanë,  
 Princat e Sasunit erdhën, edhe thanë,  
 Se kal' i Mherit atyre u përkiste,  
 Dhe u shtruan si zotër të qeverisnin,  
 Mall edhe gjithçka që Mherit i përkisnin.  
 Erdhën princërit, u turrën dhe për lanë  
 Tokat e Mherit, kuajt e tij, çfar' panë;  
 Ushtrit' e Mherit i shkrinë, i shpërndanë,  
 Dhe tokat e Mherit ndërmjet tyre ndanë.  
 Dhe pastaj, si morën tokat në zotërim,  
 Me Ohanin, intrigantin, lanë takim,  
 Gjoja i urtë dhe largpamës si zotni,  
 Burrë i besuar, princ dhe i madh njeri,  
 Për t'i drejtuar dhe qeverisur ai.

**X**

Ohani – bataqçi u shndrrua në princ!  
Dhe kur Ohani në princ na u shndrrua,  
Armët e zjarrit të princ Luanit-Mher,  
Kuajt e kuq të shpejt', shpatat e mprehta,  
I mbloodhi, dhe me to mbushi një shpellë.  
Lavdin' e shkëlqyer e la në harres';  
Pastaj shpatën e mpreht' të Luanit-Mher  
Dhe armët e zjarrit fshehu me kujdes;  
Në fund, shkriu ushtrin' e tij të pafund.  
Pastaj mbloodhi dhe mori në zotërim,  
Floririn e shumtë të Luanit-Mher;  
Në shpirt u mbush me drithërim, ngazëllim,  
Prej arit të pamasë syri ju err.  
Harroi famën që Mher kish gëzuar,  
Ari i mbledhur e tundoi thellë,  
Harroi që prej armiqve sulmuar  
Veç Mheri çlirim dhe shpresë kish sjellë.  
Kreshnikun David, djaloshin leshverdhë,  
Në malet tona si bari e nisi,  
Dimër e verë kopen' të kullosi;  
Në mbrëmje për të fjetur e sajdisi  
Pran' një plake, grua e ve, me qëllim  
Që përjet' të harroj', që kreshniku Mher  
Një shpatë të shndritshme kish mbajtur me nder,  
Dhe kuaj të kuq, armë të zjarra.  
Kështu u përpoq t'i largoj' çdo kujtim  
Për armët e kreshnikut, babait trim.

## XI

O, Luani-Mher, fshatar i thjeshtë ti,  
 Mbrojtës i liris' prej të keqit shpirtzi,  
 Krah i popullit, prijës i fuqishëm,  
 Zot i pathyeshëm dhe i pavdekshëm!  
 Deri sa koha të vinte përsëri,  
 Që foshnja David të çohet prej gjumit,  
 Ohani batakçi, ky princ kaq shpirtzi  
 Shum' djers' e mund do i shtonte zullumit;  
 Dhe lirisë dhe gjith' ç'kish vlerë për ne  
 I dha goditje gjithshkatërruese!

## XII

Mirzameliku, ky mbret i lig, demon,  
 Kur dëgjoji një ditë se në kët' bot',  
 Luani-Mher në Sasun më nuk jeton,  
 Që princat sundues ishin shtuar plot,  
 Mbi malet Sasun ishin shndrruar në zot,  
 Erdhi, përshkoi lëndinë edhe mal,  
 Si dimër i rëndë, stuhi apo val'.  
 Ohani, një ditë sipër ish ngjitur,  
 Tokën Armene e pa të rrethuar,  
 Pa fortesa, flakët e zjarrit ngritur,  
 Dhe ngriu në vend, i gjithi tmerruar,  
 Dhe shkoi të kërkoj' me përlësi  
 Shpëtimin nga ky mizor, demon shpirtzi.

### XIII

Shkoi Ohani ynë, me ah - me uf,  
Përpara mbretit mizor, faqeziu,  
Kokën përkuli me farefisn – tuf,  
Gjithçka është e jotja – ulëriu;  
Arin që shndriste atij i dhuroi,  
Sasunin krejt në robëri e çoi.  
“Mirë” – pranoi Meliku i tmershëm,  
“Jetën tuaj” – tha ngadal’ – “do ta kursej,  
Vetëm se dua që bashkë me tokën,  
Të vijn’ të gjithë, i madh e i vogël,  
Nën shpatën time të përkulin kokën;  
Që në Sasun askërkush të mos mbesë,  
Që shpat’ e pushkë mbi mua të qesë”

### XIV

Ohani me hile emëruar princ  
Kokën uli para Melikut demon,  
Pastaj lëshoi një urdhër të frikshëm,  
Që gjithë njerëzia e Sasunit  
Të vijë, posht’ shpatës së tij të kaloj’,  
Shpatës së rëndë dhe me shkëlqim gjaku.  
Dhe populli kryelartë i Sasunit,  
Lënë shkretë, nënshshtruar dhe përlur  
J’u nënshtrua vullnetit mizor t’Ohanit  
Nën shpat’ të Melikut shkoi kok’ulur.  
Meliku, me parzmoren që shkëlqente,  
Mbi fron, i tmershëm dhe i madh, qëndronte  
Dhe njerëzia, i madh e i vogël,

Nën shpatën prej çeliku i kalonte.  
 Por kur i erdhi rradha Davidit vet,  
 Nuk ju afrua shpatës së të ligut,  
 “Nuk kaloj” – tha i vendosur, plot vullnet,  
 “Posht’ asaj shpate të Mirzamelikut”.

## XV

Rrotulloi ata sy të përgjakur  
 Mbi Davidin Mirzameliku i zi,  
 Goditi fort me kamzhik kalin e tij,  
 Pastaj e shtyu drejt Davidit fëmi,  
 Që thundrat e kalit, që trokëllonin,  
 Ta shkelnin atë, ta shtypnin, coptonin.  
 Por djaloshi David, me buzë në gaz,  
 Si një fëmijë që luan me zjarrin,  
 Mbërtheu nga frerët kal’n e Melikut,  
 Dhe iku; u tmerr’ kali dhe Meliku;  
 Dhe mbeti Meliku, ai gjakatar,  
 Varur tek frerët e kalit në llahtar.  
 Ulëriu Meliku me tmerr, u çorr,  
 Shpatën prej çeliku vezullues nxorr’,  
 Që ta godasë me goditje tërthor,  
 Përgjys’ ta ndajë Davidin fëminor.  
 Ndërkaq një plak u afrua tek ai,  
 Një fshatar i thjeshtë, flokët plot thinja,  
 “Fale!” – bëlbëzoi – “Është’ ende fëmi,  
 Gjith’ Sasuni ka sjellë kokën tek ty,  
 O, Mirzamelik, përse të trembesh ti

Nga një jetim qumështor, shih, axhami?”  
E vështroi Meliku plakun fshatar,  
Pa shpatën e tij, pa rreth tij plot ushtar’,  
Vështroi princërit Sasunianë,  
Dhe njerëzinë, në robër të kthyer,  
Dhe u afrua, Davidin duke par’;  
“Po e fal” – tha, - “Por ta dini, ndonjë dit’,  
Ndonjë e keqe mbi kok’ në më rëntë,  
Prej tij do më vij’, kryeneçit David”!  
Këto tha, kalin e tij fshikulloi,  
Mblodhi pastaj ushtrin’ e tij mizëri,  
Nga tok’ e Sasunit u ngrit e shkoi;  
Por njerëzit i dërgoi përsëri,  
Gjithçka që i takonte shpëtimtarit  
Të mblidhej, të çohet pranë Mirzait.

## XVI

Dhe erdhën Badini dhe Kozbadini,  
Të ngazëllyer një ditë në Sasun,  
Me vete sollën thasë të shumt’, pafund,  
Që thesaret e depove, gjithë ç’mund  
T’i mbledhin, t’i çojnë. – Duart fërkoi  
Ohani me huqe, ky princ ziliqar  
Dhe tagrambledhësit shkoi takoi.  
Pastaj, nga gropa e thell’ shkoi të nxjerr’  
Thesarin e fshehur të Luanit-Mher,  
Dhe me një zell të madh, që të lë pa goj’,  
Një nga një filloi të numërojë  
Thesarin e Luanit Mher; që sërish  
Dor’ e fuqishme e Mirzamelikut

Përjet' të sundojë, të mbretërojë.  
 Tani ushtria e Mherit nuk ishte më,  
 Që t'i dërmojë ata, t'i thërmojë.

## XVII

Ndërkoh' vogëlushi flokëverd' David  
 Në oborrin e plakës së rrëguar,  
 Nga beteja me zogjtë i posadal',  
 Me një tufë bari jeshil në dorë,  
 Hidhej përpjet, luante i gëzuar.  
 Davidit të vogël plaka i thërret:  
 "Or David" – i thirri – "Largohu bir,  
 Ti çfar' kërkon në arën time të shkret'?  
 Kallinjte e artë përse i thërmon?  
 Kalliri rrobet t'i çjerr, t'i shkatërron!  
 Badinin dhe Kozbadinin s'i shikon,  
 Që arin e tët eti po përvetson?  
 Në trupin tënd forcë ka, shumë fuqi,  
 Shko, mor David, shko shiko, përpigu ti,  
 Që mos ta marrin arin e tët eti!"  
 "Po kush po ja jep arin e tim eti  
 Badin, Kozbadinit?" – pyet Davidi,  
 Që nga ky lajm fort i çuditur mbeti.  
 "Ohani batakçi po ja jep mbretit,  
 M'rzamelikut, thesarin e tët eti!"  
 Kështu u përgjigj plaka, sytë me lot.  
 Vogëlushi David u ngrit dhe shkoi,  
 Thesarit të babait t'i dilte zot.

**XVIII**

Shkoi edhe pa; në dhomën e vjetër  
Badini dhe Kozbadini qëndronte,  
Ndërsa Ohani me çehre meiti  
Verdhushkat prej floriri numëronte,  
Dengjet vendosur në qoshe të murit,  
Ashtu si tufat e lirit të korrur.  
Davidi pa, vështroi nga Badini,  
Pastaj u kthye për nga Kozbadini,  
Ohanit qetë j'u afrua më pas  
Dhe e largoi nga tufa me thas';  
Tha: - "Më lër mua t'i numëroj, Badi,  
Verdhushkat e Mherit, që janë flori!"  
Pastaj prej thasëve derdhi floririn,  
Mori një en' boshe, ajrin peshoi,  
Hapi një thes, brenda tij e lëshoi.  
Dhe duke buzëqeshur i tha: - "Ja një!"  
U zemërua Kozbadini dhe tha,  
"Ma hiqni sysh këtë djalosh budalla,  
Jepni Mirzamelikut çfar' i takon,  
Se ndryshe nga themelet e shkatërron  
Sasunin pa zot, që nuk ka kush e mbron,  
Dhe Sasunin vet' në shkretëtir' e shndrron!"  
U mërzi Davidi kur e dëgjoi,  
Urrejtjen e pafund s'mundi ta frenoj',  
U kthye – një cop' bakri në dor' ngjiti  
Mbi qerosin Kozbadin e vërviti.  
Pastaj i bëri zë Ohanit vetë,  
"Hej batakçi" – thirri – "shko fli i qetë,  
Mirzameliku, shtat' koka le të ket',  
Çfar' ka ndër mend, le të vij', ta bëjë vet'!"

## XIX

Shkoi Badini edhe Kozbadini,  
 Mirzamelikut j'u ankuan, j'u qan',  
 Gjyqin i bënë Davidit trim, pastaj  
 Lëvduan mirësinë e Sasunit,  
 Dhe sjelljen e mirë të princit Ohan.  
 Mirzameliku, ky mbret demon i zi,  
 U inatos si dimër plot egërsi,  
 Pastaj një urdhër të rreptë lëshoi,  
 Që shpejt të mblidhet një e madhe ushtri.  
 Njëmij' e pesëqind djelmosha të rinj,  
 Njëmij' e pesëqind fshatarë trupderdh',  
 Njëmij' e pesëqind burra flokëzinj,  
 Njëmijë e pesëqind burra leshverdh',  
 Që të shkojnë Sasunin ta pushtojnë,  
 Pastaj ta rrënojnë, në tok' ta rrafshojnë,  
 Që njerëzinë në robër t'i shndërrojnë,  
 Çfarë mbetet në Misir t'i dëbojnë.

## XX

Të Mirzamelikut ushtri të bujshme,  
 Pushtuan tërë shkëmbinjt' e Sasunit,  
 E mbushën çdo cep me britma të kujshme,  
 Me hingëllima kuajsh, trokëllima,  
 Dhe krahinë, mbushur me plot mrekulli,  
 E mbyti vaji, zjarri, tymi i zi.  
 Ohani frikacak, princ Armen, herët  
 Një mëngjes u çua dhe pa një ushtri,  
 Kish ardhur Mirzameliku me hordhi,  
 Vdekje kundërmonthe fushata e tij,  
 Dhe shpirti i tij u mbush me vrer të zi.  
 Shkoi pastaj pranë Davidit ai,

I tha: - “Ore, David, djalosh i marrë,  
Po të sjell lajmin vdekjendjellës, të zi!”  
“Ore David, - thirri – “David” - bërtiti  
Dita e shkatërrimit na arriti,  
Me ushtri të panumërta ka sosur  
Mirzameliku, mbreti i xhindosur;  
Ikim, or David, le të ikim!” – i tha,  
“Le t’ja japim atij atë detyrim,  
Le të ikim, or David, ar t’i çojmë,  
Dhe me dredhi shpëtimin ta kërkojmë,  
Që hakmarrjen e egër mos t’ushtrojë,  
Tokën e Sasunit mos ta rrënojë”.  
I thot’ Davidi Ohanit batakçi:  
“Jo, Frikacak” – i tha – “largohu, shko fii!  
Në mëngjes, do të marr hark dhe shigjetë,  
Tek ai do të shkoj – Me të do luftoj”.

## XXI

U zgjua Davidi herët në mëngjes,  
U ngrit – hark dhe shigjet’ mbi sup ngarkoi,  
Pranë mbretit Mirza u nis edhe shkoi,  
At’ far’ të keqe ta ftoj’ në betejë,  
Dhe gjën’ e rrëmbyer prej tij, si lumë,  
Ta marrë, në tokën tonë ta kthejë.  
Ndodhi që plaka e shkret’ atë e pa,  
“Ore, David” – i thirri – “Ku shkon? – i tha.  
Davidi u gjegj: - “Unë atje po shkoj  
Mirzamelikun në betejë ta ftoj,  
Për Sasunin tonë sherr do të kërkoj  
Mirzamelikun nga toka ta dëboj”!  
Plaka i tha: - “David, ore djal’ fshatar,  
Përse bëhesh kaq naiv dhe kaq i marr’,  
Thirri mendjes, mos vrapo si er’ mali,

Ai po pret që në pritë t'i dalësh;  
 Mirzamelikun, bashkë me banditë,  
 Me hark e shigjet' si do ta ndalësh?"  
 "Po at'here si t'ja bëj" – Davidi tha,  
 "Top nuk kam, as njëmijë armë nuk kam!"  
 "Se çfarë të bësh, – plakë e gjorë i tha, –  
 - "Nuk di të them, or David, në gjendje s'jam,  
 Por di që Mheri kish arm' me shumicë,  
 Kishte kalin e kuq që turfullonte,  
 Pa kish' edhe shpatën që vezullonte".  
 Davidi mblodhi vetullat, pastaj tha: -  
 - "Po ku janë armët që im atë la?"  
 "Hej, or David i marrë" – plaka i tha, -  
 - "Tek Ohani batakçi shko shih, – i tha, -  
 Çfarë armë yt atë në depo kish,  
 Çfarë topa yt atë në depo la,  
 T'i ruaj' ja dha Ohanit batakçi,  
 Shko, merri mbrapsht, or David flokëflori!"  
 Plaka e mençur kështu këshilloi  
 Kreshnikun David; ai e dëgjo.  
 "Besim – i tha - mos ki tek tjetër njeri,  
 Po s'ta dha me dashje – me zor merrja ti"!

## XXII

Fort i zemëruar Davidi shkoi,  
 Në shtëpinë e Ohanit ndaloi,  
 Trokiti fort, oborr' dhe der' gjëmoi;  
 "Ohan" – thirri – "dil jashtë – po të kërkoj,  
 Armët e Mherit të m'i japësh tani,  
 Me armët e tij në betejë do shkoj!"  
 Ohani, i trembur, doli në oborr,  
 "Çfarë armësh thua or David i gjor',  
 Një djalosh naiv mbete ti përherë,

Sot nga të fryu në kokë kjo erë?”  
Davidi tha: - Ohan, or princ batakçi,  
Mheri kishte një mburojë prej ari,  
Mheri kish pa fund edhe armë zjarri,  
Mheri kish kalë qimekuq që shndrriste,  
Mheri kish edhe shpat’ që rrëzëlliste.  
Silli, nxirri pushk’, topa, edhe çfar’ thash’  
Dhe nëse jo” – tha – “Me zor do të t’i marr!”  
Ohani, me frik’, duke turfulluar,  
Foli – “ David, ty kush të ka treguar?”  
U gjegj Davidi: - “Plaka jonë e gjor’,  
Prandaj, Ohan, armët m’i nxirr në oborr,  
Do shkoj, kështu i vetëm do përleshem,  
Mirzamelikun nga Sasuni ta shporr!”

### XXIII

E pa hileqari, rrugëdalje s’ka,  
Solli armët, mburojën, edhe gjithçka;  
Solli armën që zjarr e flak lëshonte,  
Solli edhe kalin që turfullonte,  
Solli edhe shpatën që vezullonte.  
Pastaj kur Davidi kalin shaloi,  
Me jelek argjendi trupin mbuloi,  
Dhe mori në dorë shpatën që shndrriste,  
Ju kthye Davidit, i mërmëriste:  
“ Sa keq, për kalin e zjarrtë të Mherit,  
Armët e vyera, thesaret pafund,  
Sa keq për frerët e kalit të Mherit!”  
Davidi dëgjoi, u kthye, e pa;  
- “Hej, or Ohan hileqar, – briti, - or dreq”,  
“Mbylle atë gojë të keqe,!” – i tha, -  
- “Për djaloshin David vallë s’të vjen keq?”  
Ohani nga frika fjalën e drodhi,

“Sa keq për djaloshin David se ç’po heq”,  
 Nga sytë një rradhë lotësh i rrodhi,  
 Ndërkaq rrënkoi dhe pastaj u ndje keq.  
 Kreshniku David më fjal’ nuk lëshoi,  
 Emrin e Mherit të ndritur kujtoi,  
 Pastaj kalin grahu, rrugën vazhdoi...

## XXIV

Kreshniku David të zjarrtin kal grahu,  
 T’Mirzamelikut ushtri të arrinte;  
 Kur ushtrin’ e arriti, u ndal dhe pa,  
 Ushtri e Mirzamelikut fund nuk ka,  
 Ish shtrirë në lëndin’ dhe mal, po flinte.  
 Kreshniku David për një çast kur e pa,  
 Me vete, me mendjen fëminore tha:  
 - “Si kallinj gruri do mund t’i korr ata  
 Sikur tani të shkoj, të hyj pa u ngut,  
 Por do mendojnë, na kapi në gjumë,  
 Davidi erdhi e shkoi si hajdut”.

Ahere Davidi trim zë lëshoi:  
 “Ejani, ushtri gjumashe, u çoni  
 Që në gjumë ju rashë të mos thoni,  
 Si hajdut Davidin të mos kujtoni!  
 Ushtri e tërë u zgjua menjëher’,  
 Ulurima, krisma u ndjenë në er’,  
 Hingëllima kuajsh, kërcitje patkonjsh,  
 Zhurma armësh, zjarr dhe flakë, edhe tmerr ...

Davidi mbërtheu kalin e zjarrtë,  
 Si furtun’ u lëshua me gjith’ fuqi,  
 Xixa nxorrën gurët, toka gjëmoi,  
 Dielli u duk se ngjyrë ndryshoi,  
 Kur shpata shkëndi të zjarrta lëshoi.  
 Me shpatën e zjarrt’ si rufe godiste,

Si bar i korrte, si mizat i vriste,  
Ushtarët e ushtrisë të Melikut,  
Që prej ditësh në Sasun kish vërshuar,  
Si karkalecat tokën kish mbuluar.  
I frikshëm ish Davidi dhe madhështor,  
Si ushtar i vërtetë, trim, burrëror,  
Me shpatën e atit të vet luftonte,  
Emrin kreshnik si Mheri meritonte.  
Pa zemërimin e fuqishëm të tij  
Mirzameliku edhe ushtria mbar',  
Një plak thinjosh doli përballë atij,  
Nga tok' e Mirzait i ardhur ushtar.  
"David, - ushtari plak i tha ngadalë, -  
-Ballë nesh në betej' përse ke dalë,  
A s'e di, që Meliku, ky mbret demon,  
Që ne na solli, Sasunin e pushton?  
Ore David – thirri – sa naiv që je,  
Kreshnik David, fshatar edhe ti si ne,  
Mirzameliku është' armiku që ke;  
Në qofsh kreshnik, shko, me mençuri  
Hakun merri Mirzamelikut të zi!"  
"Mirë!, - e pranoi Davidi i jon', -  
- Po ku ndodhet tani Meliku demon?"  
"Atje është, - ju përgjigj ushtari plak,  
Në tendë akoma të flejë vazhdon,  
Atje ku do të shohësh tym edhe flak' –  
Atje është tani Meliku demon".

## XXV

Dëgjoi Davidi – kalit i thirri,  
Dhe ju bind kal' i zjarrtë, e kuptoi,  
Siç i bindet kosës një tuf' kalliri,  
Mori vrull fuqishëm dhe fluturoi,

Dhe shkoi, përpara tendës qëndroi,  
 Përpara asaj, në mes të së cilës,  
 Si prej një furre, zjarr dhe flakë dilte,  
 Dhe topa tymi si shtëllunga villte.  
 - “Or Melik” – thirri me një zë që kumbon  
 Ky Kreshniku David Melikun demon,  
 -“Or Melik” – thirri – “eja, gjumin e le,  
 Dil, të ndeshemi, me rradh’ të qëllojmë ne,  
 Dhe pastaj ta shohim vërtet aq trim je,  
 Sa njerëzinë, nënshtuar nga frika,  
 Ke sjellë mbi Sasun të sulmojë ne!”  
 Zërin e tij Meliku e ndëgjoi,  
 U ngrit, për një çast i ngrysur qëndroi,  
 Pa krenar ushtrinë e tij të paan’,  
 Pastaj thirri Davidin e vogël pran’,  
 At’ gojën e madhe hapi pamasë,  
 Dhe kreshnikut David zuri t’i fryjë,  
 Që si një pupël e lehtë, me gjasë,  
 Nga fush’ e Sasunit ta nxjerr’, ta shtyjë.  
 Davidi flokëverdh’ si shkëmb qëndroi  
 Atje ku ish mbeti, e përballoi.

## XXVI

U ngrit nga vendi ky Meliku demon,  
 I ndrydhur nga tmerrri për pak desh shkallon,  
 Mbajti frymën një çast, veten kontrollon,  
 Pastaj buzagaz Davidin e vështron;  
 -“Eja brenda” – i tha – “ or David i ri,  
 Qëndrojmë bashkë, flasim me qetësi,  
 Flasim njerëzisht dhe pastaj përsëri  
 Dalim njeri pas tjetrit, unë dhe ti,

Hipur përmbi kuaj, me armë pajis',  
Provojmë ne forcat përpara ushtris'".  
Ore David, fshatar naiv mbete ti,  
Nuk i ngjave tët eti, Mherit zotni,  
Në rradaken tënde çfarë ere fryn  
Kur sprova e vdekjes në betej' të shtyn;  
Sa shum' i beson këtij gjasme miku,  
Këtij kundërshtari, këtij armiku,  
Ohani ky, apo Mirzameliku!  
Dhe ja, Meliku i zi, ky mbret demon,  
Me buzagaz mashtrues brenda të fton,  
Ky intrigant, hileqar dhe gjakatar,  
Mbi ty, or David, hak kërkon të marrë!  
Davidi naiv, fare pa dyshuar,  
I besoi të keqit, brenda hyri,  
Edhe ra në një gropë të gërmuar  
Nga Meliku, që e kishte mashtruar.

## XXVII

Davidi ynë në gropë përfundon;  
Përçark errësirë, asgjë nuk dallon;  
Sipër, Meliku gjaksor, i tronditur  
Prej frikës së çmendur që e kaploi,  
Me një gur të madh, gjigant, e mbuloi.  
Davidi mbeti në grop', n'errësirë,  
I pambrojtur, ndërsa jashtë i nxirrë,  
Mirzameliku, ky mbret egërsirë,  
Hidhej si i tërbuar, në gaz shkrirë.  
Dhe në atë çast mbi Sasun gjëma ra  
Vdekja e parakohshme u shfaq mbi ta.  
Dhe Davidit, thell' në gropë fundosur,  
Nga thirrjet për ndihmë i telekosur,  
Dhe të mos e zgjasim bisedën më kot

Në atë çast të zi, me shpresë në Zot,  
 Një ndihmë i erdhi, nga nuk e pret dot,  
 Nga Ohani frikacak, ky princ i kot'.  
 Princi Armen, servil, kishte qëndruar,  
 Ashtu shpirtzi, për vdekje i tmerruar,  
 Përulësisht Melikun po shikonte,  
 Ndërkohë njerëzinë urdhëronte;  
 Të mblidheshin dhe për atë të dërgojn'  
 Dyzet gra të çala miell të thërmojn',  
 Dyzet gra të tjera, devet' të ngarkojn',  
 Dyzet vajza, si pranvera, t'i shtërngojn'  
 Si dashnore pran' Melikut të shkojnë.  
 Pastaj Ohani i zellshëm, plot tërbim  
 Mblodhi flori, thesare, pa numërim  
 Pranë Mirzamelikut u ul në bisht,  
 Hyri kok'ulur, përulësisht i kërkoi'  
 Tok'n e Sasunit si dhurat' ta pranoj'  
 Dhe njerëzit si robër përjetësisht;  
 Dhe si për të ashtu dhe për Mirzën mbar'  
 Të vijë, arin që i takon, ta marr'.  
 Mbreti dëgjoi, qeshi me ligësi,  
 Bruroi – toka u drodh nga zër' i tij,  
 Pastaj vendosi një urdhër të lëshoj',  
 Popullin e Sasunit ta detyroj',  
 Detyrimin e Melikut të ngarkoj'  
 Dhe në tokën e Mirzës si rob të shkoj'.  
 Ohani e dëgjoi, pastaj shkoi  
 Dhe njerëzis', kruspullosur nga frika,  
 Për urdhërin e tmerrshëm i tregoi.  
 U çua e përlotur gjith' dëshpërim  
 Krahin' e Armenisë, mbetur jetim,  
 Dhe zëri, që mbarë Sasuni ngriti,  
 Veshin e kreshnikut David arriti,  
 Që në grop'n e errët ku e kishin zhyt,  
 Zjarr edhe shkëndija po nxirrte nga syt'.

U përmend; për një çast Davidi kujton  
Lavdinë e shkëlqyer të Luanit-Mher,  
Kujton shpatën e ndritshme që shkëndijon,  
Mbledh gjithë fuqitë e tij menjëher’,  
Shpatën e shndritshme e fërkon, e lëmon,  
Dhe gurin godet, e çan, - mes tij kalon.

## XXVIII

Pastaj Davidi nga vrima jasht’ u derdh,  
- “Ore Melik,” – thirri – mbret mizor, më prit,  
Unë kam dalë, çast i vdekjes të erdh!”  
Pastaj, me zë të frikshëm, thirri ai:  
- “Hej, dil në shesh, ti mbret hileqar, pa nder,  
Hip mbi kal, mbërthe armë dhe mburojë,  
Që ballë për ballë për të fundit her’,  
Për vdekje të luftojm’, kush të fitojë!”  
Përballë i doli Meliku i zi,  
E vështroi, qeshi me hipokrizi,  
Vështroi armët që ndrisnin si ari,  
Pa kalin në afsh, ndezur kuq si zjarri,  
- “Eja, ulu!” – e ftoi hileqari;  
“Eja, ulu, miqësisht të bisedojm’,  
Pastaj sipas dëshirës, shpatë a shtiz’,  
Ore David, merr, për vdekje të luftojm!”  
“Jo!” – u përgjigj Davidi ynë me ton;  
“Davidin e Sasunit më s’e mashtron;  
Eja, Mirzamelik, sill armët që ke,  
Qëndro si burrë, pa frik’, dhe pa hile’,  
Vdekjen po të sjell, si mbret mizor që je!”  
Meliku u çua, përreth vështroi,  
Parzmoren veshi, armët mori ngadal’,  
Mbi kal hypi dhe shkoi e qëndroi  
Përballë Davidit, i madh si një mal.

“David” – murmuriti Meliku demon, -  
 -“Gjuajtja e parë, fol, kujt i takon?”  
 -“E jotja është!” – iu përgjigj ai, -  
 Kreshniku David, atij burri të zi.

XXIX

Dhe i qëndroi Davidi përkarshi,  
 I patundur, i patrembur, si zotni,  
 Me syrin pish’, i buzëqeshur, krenar,  
 Si diell i shndritshëm, i zjarrt’, rrezear  
 E ktheu mbrapsht Meliku kalin e tij,  
 U largua, erdhi, dhe pastaj në ij,  
 Me vrull të madh, aq sa krahu i hante,  
 Goditi Davidin, në mes ta çante  
 Gjoksin e tij, që lartësohej krenar.  
 Goditi Davidin me sa pat’ fuqi,  
 “Pluhur u shndrrua Davidi” – tha ai;  
 “Këtu jam” – thirri djali me krenari,  
 Nga kjo me tmerr u mbush Meliku i zi.  
 Për herë të dytë kalin e nxiti,  
 Erdhi, me shtizë pjerrtazi goditi;  
 - “Në pluhur u shndrrua” – thirri përsëri, -  
 - “Këtu jam” – u gjegj djali me krenari.  
 Dhe për her’ të tret’ ngau kalin ai,  
 Mirzameliku, ky mbret mizor, shpirtzi,  
 Erdhi, hodhi shtizën me sa pat’ fuqi;  
 - “Këtë rradhë vdiq Davidi,” – tha ai, -  
 -“Këtu jam” – u gjegj djali me krenari.  
 - “Mbahu, Melik, mbahu ore mbret i zi,  
 E kam rradhën un’ të grah kalin tani!”  
 Kur Meliku përballë tij qëndroi,  
 - “David, fshatar i fortë” – bëlbëzoi, -  
 - Më ler, djalosh, një grop’ të thell’ të gërmoj,

Të futem brenda, dhe kokën të mbuloj  
Me dyzet lëkurë, me dyzet gurë,  
Dhe pastaj godit, sa shpirti të të doj'!”  
- “Mirë, – mbretit të lig Davidi i tha,-  
- “Për ty një gropë të thell' dhe gurë ka,  
Melik, ty asnjë mjet nuk do të shpëtoj',  
Kur Davidi, nga Sasuni, të qëlloj'”

XXX

Sollën veglat, një gropë të thell' hapën,  
Për Mirzamelikun, këtë mbret demon,  
Dhe hyri Meliku, drithmat e kapën  
Në gropën e errët që dukej si hon,  
Pastaj sollën, zvarrë duke tërhequr  
Dyzet gurë dhe dyzet lëkur' rregjur.  
Pastaj nget Davidi kalin shaluar,  
Goditjen e parë për të lëshuar,  
Sakaq u shfaq një grua e moshuar,  
Ishte nëna e Melikut, e veshur  
Në rroba të Mirzas, mëndafsh i çmuar,  
Në këmbët e Davidit ndenji shtruar;  
- “Mua ma jep,” – i tha, - “Goditjen e par'!”.  
- “Mirë” – i tha djali të moshuarës, -  
- “Pranoj, ty po ta fal goditjen e par'!”.  
Për herë të dyt' grahu kalin ai,  
Djaloshi David, ndërkohë përsëri  
Erdhi, u kruspullo në këmbët e tij  
Një tjetër grua - e bukur, trup selvi;  
Motra e Melikut ish, në trup veshur  
Petka të shtrenjta dhe të shkëlqyeshme;  
Në këmbët e Davidit kruspull u ndal,  
- “David” – bëlbëzoi – fshatar i pavler',  
Goditjen e dytë mua a ma fal?”.

- “Mirë” – i tha djali – “e bukur grua,  
 Po ta fal të dytën, meqë po thua!”  
 Për të tretën herë kalin e shpoi,  
 Dhe lutjen e askujt më nuk dëgjoi,  
 Të Luanit-Mher emrin e kujtoi,  
 Pastaj nxorri shpatën që vezulloi,  
 Dhe me goditje vigani qëlloi,  
 Dyzet lëkurë në mes i coptoi.  
 Dyzet lëkurët mespërmes i ndau,  
 Dhe gurët si të ish vigan i çau,  
 U hap një gropë e pamasë, e thell’,  
 U pluhros fytyr’ e pjekur në diell.  
 Kur pluhuri u ngrit më lart akoma –  
 - “Këtu jam” – u dëgjua Meliku demon, -  
 - “David i Sasunit, s’kam vdek’ akoma!”.  
 U çudit djaloshi David, pastaj tha:  
 - “Ore Mirzamelik, fort shpresë mos mba!”  
 Meliku zërin e tij e dëgjoi,  
 U rrek të ngrihej, gjaku e mbuloi,  
 Në mes ish prerë ai në dy pjesë,  
 Iku Meliku, kështu përfundoi

**XXXI**

Kjo na është treguar neve vetë  
 Për djaloshin David si e vërtetë,  
 Pastaj tregimi shumë qartë vazhdon,  
 Që kështu, pasi vdiq i keqi demon,  
 Ushtrisë së tij një fjalë i dërgon:  
 - “Nëpër vendet tuaja – u tha – shkoni,  
 Jetoni të lir’, kryelartë rroni,  
 Në shtëpit’ tona më mos u afroni!”.  
 Pastaj tregimi vazhdon e na thotë,  
 Që Davidi pas vetes tërhoqi zvarr’,

Ohanin dhelparak, princin hileqar,  
Gjithçka, arm' dhe mburoja, i mblodhi mbar',  
Tokës ju kthye plot fuqi si fshatar,  
Dhe në malet e Sasunit përsëri  
Ushtoi gazi, këngët plot gjallëri.  
Më posht' tregimi të na thot' vazhdoi,  
Që pas kësaj në Sasun mbretëroi,  
Një jetë e thjeshtë edhe krenare,  
Deri sa vdiq Davidi i lavdishëm,  
Që la përmbi tokë një trashëgimtar,  
Mherin, djalin e tij që ndriste si zjarr';  
Por forca të fuqishme e shtërnguan,  
Nëpër shpellat e errta e dërguan,  
Të maleve të Sasunit, ku ai  
Rob do të mbahet përjetë, përgjithnji! ...  
O, kreshniku Mher, ti fshatar i thjeshtë,  
Pasues i të lavdishmit Luan-Mher,  
Kreshniku i fundit, fshatar i vërtet',  
Mbrojtës i njerëzve që jetojn' me nder,  
Forca shkatërrimtare, të zeza sterr,  
Në at' shpellë, në at' gropë, në at' terr  
Personin tënd të shndritshëm mbyllën me tmerr,  
Dhe në tmerr nga hakmarrja që s'vonon,  
Të shpallën ty njeri të lig dhe demon,  
Se e dinë që po dole, për ata  
Vetëm përmbysje, mjegull dhe vdekje ka...

### **XXXII**

Kështu, pasi vdiq, u kthye në kujtim  
Brez' i kreshnikëve si Davidi trim,  
Zotëroi vajtimi, fati mizor,  
Në Sasunin e lart', në kët vend malor,  
Tek njerëzit e tij, të thjesht' dhe puntor'.

Kështu, në ëndërr u kthye, në kujtim,  
 Brezi i Luanit-Mher, kreshnikut trim,  
 Dhe pastaj përgjat' shekujve në vazhdim  
 Në Sasunin me male pa numërim,  
 Që kreshnik si Mheri më s'trashëgoi  
 Raca e Ohanit dinak mbretëroi ...  
 Raca e Ohanit fronin zaptoi,  
 Dhe për shum' vite në tokën Armene  
 I ligu dhe servili mbretëroi;  
 Me forcë e dhun' – fare pa dhimbsuri  
 Rrëmbyen nga toka jon' çdo pasuri  
 Dhe na hoqën dinjitet dhe krenari.  
 Dhe për shekuj, përsëri e përsëri,  
 E sunduan tokën princa të këqinj,  
 Zotër Armenë dhe gjithfarë lloje,  
 Fisnikë vendas me sjellje shtazore  
 Dhe mbretër pa fund si bisha mizore.  
 Dhe mbi kokën e njerëzve të lirë,  
 Si një mbulesë të shenjtë, të mirë,  
 Vuri kthetrën e egër të të ligut  
 Zotit të zjarrit, kryqit dhe kamzhikut.  
 Kështu fis' i Ohanit mbretëroi,  
 Për një kohë të gjat' botën sundoi,  
 Deri sa një dit', si yll - ai vetë,  
 U shfaq nga shpellat Mheri i vërtetë,  
 Dhe solli për fisin e hileqarit  
 Rënien, vdekjen dhe gropën e varrit.  
 O Mher i pavdekshëm, sa shekuj t'u desh  
 Në errësir' si burrë të qëndroje,  
 Deri sa të vinte kjo dita jote  
 Dhe të dilje si diell të ndriçoje,  
 Dhe trashëgimtarëve të të ligjve  
 Fundin dhe vdekjen e vërtet' t'u çojë!

**XXXIII**

Dhe në botën e përjetshme ku jetojm',  
Këtë histori shumë shpesh do rikujtojm',  
Të Davidit të Sasunit histori,

Në shekuj, brez pas brezi, dhe përsëri.  
Le të themi më parë mallkimin ton',  
Për Mirzamelikun, për mbretin mizor;  
Le të themi përsëri mallkimin ton',  
Për Ohanin servil, princin puthador;  
Le të themi përsëri mallkimin ton',  
Për të gjith' ata princërit tan' pa nder,  
Që neve na sollën vdekje, zi dhe vrer.

Pastaj le t'i thurrim ne himn, lavdërim,  
Luanit-Mher, viganit, kreshnikut trim,  
Davidit, djalit të tij, kreshnik me flet',  
Mherit, djalit të tij, që nuk vdes përjet';  
Pastaj gjithë popullit të Sasunit,  
Që, mbi malet e kaltërt kish jetuar,  
Një histori të till' duke krijuar;  
Iku pa gjurm', në ëndërr për t'u shndrruar! ..

## PËRBALLË GRUMBULLIT MASIS

Aksel Bakuncit, mikut të shkëlqyer!

Jashtë doli ai herët që pa gdhirë,  
Pas vetes derën mbylli me ngadalë,  
Për herë të fundit pa shtëpinë mirë,  
Dhe drejt kopshtijeve mori të dalë.  
Ishte ftohtë. – Dielli sapo kish filluar të shfaqej  
Në horizontin e mugëtirës së sapozbardhuar,  
Dhe në sfondin ngjyrë zerdeli të agimit të hershëm,  
Nga shumë larg, dukej Masisi, me vello blu mbuluar...

\* \* \* \* \*  
\* \* \* \* \*

Në mbrëmje nuk kish fjetur. – Letrat kish grisur,  
Për një kohë të gjatë kish shfletuar fletoret,  
Ditaret, librat, dorëshkrimet, çfarë pati,  
Shkrime, të mbetura që nga Dorpati.  
Ashtu si jeta e tij e ndërlikuar, e çrregullt, e ngjeshur,  
Ashtu si mendimet e shumëllojshme,  
Mendime, që shkonin drejt brezave të ardhshëm,  
Plane, të lëna përgjysëm, apo të sapo nisur;  
Kujt do t'ja linte të gjitha këto, kujt prej nxënësve të dashur,  
Me qëllim që nesër prej atyre fletoreve  
Me përkëdheli të nxirrte fjalët e tij aq të gjalla  
Dhe me kujdes t'i dorëzonte për shtypshkrim? ...

Dhe pastaj letrat ... Ato fletë të zverdhura,  
Të mbushura me një shkrim të dendur gotik;  
A s'ishte vallë ajo dëshmi e ditëve të stuhishme,  
E mendimeve, e punës dhe zellit të tij,  
E qënies së tij të vendosur kundër luftës?  
O, punë e zell plot durim i çuar dëm,  
I ditëve të tua – ndihmë i jepni shpirtit;  
E ardhme e padukshme dhe e sotme plumb,  
Këngë plumb e jetës pa horizont!  
Netëve gjatë ai kish qëndruar  
Tufën e letrave të vjetra duke shfletuar;  
Pluhuri i harresës mbi to kish qëndruar,  
Dhe dukej sikur, në ëndërr të largët, të shkuar,  
Shihte ai përsëri ditët e tij,  
Vorbullën e tyre të jashtëzakonshme;  
Ato fletë të zverdhura, ata libra të shumëllojshëm,  
Me sa pasion ato krijuar!  
Në thëngjijtë e letrave kish fjalë të ashpra,  
Shkrime me tema edukative,  
Diçka që për jetën e dikujt tjetër do ishte e huaj;  
Kishte shkrime, të cilat, sakaq,  
E quanin atë rrugë poshtëruese,  
Përshkruanin rrjedhën e vështirë të aziatikut,  
Dhe këshillonin me hapa të matur  
Të ndiqnin rrugën e Zotit,  
Një rrugë përulësie, virtutshmërie,  
Me shekuj urtësie të shenjtëruar,  
Që njerëzimi të bëhet si qëmoti,  
I bindur, i ndershëm, dhe me frikë tek Zoti.  
Ndërkaq në thëngjijtë e letrave të zverdhura,  
Në rrudhat e hirit kundërmues  
Papritmas bie në sy një shkrim i trashë;  
Një fletë e vogël e kaltër.  
Ashtu si vesa qëndron mbi lulet, si lot,  
Depërtuese, e hershme, e freskët dhe e plot',

Ajo flet' e kaltër e mallëngjeu me kujtimet  
 E çasteve të ëmbla, që s'i shijoi dot!  
 Kujtoi. – Kur kish ndodhur? – Mos vall' kur vet' ai,  
 Nisur, mbushur me ëndrra dhe shpresa, djal' i ri,  
 Nga Jerevani, deri sa kish arritur në ato brigje,  
 Ishte kapur nga një e pamundur dashuri?  
 Nga largësitë e errta ardhur si një murg,  
 Edukuar me ëndrra dhe jetë të qetë,  
 Veshur me rroben e shenjtë të shërbyesit të kishës,  
 Erdhi përball' teje ai, i padenj' për pasionet!  
 Dhe papritmas – aq qartë, e ndriçuar,  
 A thua sot po ndodhte, madje tani,  
 Ju shfaq atij ajo e shkuar,  
 Porsi një ëndërr, vizion i çmuar.  
 Vajza qëndroi përballë tij, - me bishtaleca të artë,  
 Me sytë, si kupë e qiellit,  
 Si t'ish lindur hyjni me aureolë të shndrritshme;  
 Pë çfarë pasioni mëkatar dhe të ndrojtur  
 Ish rritur, si lule, e ëmbël dhe e paarritshme? ...  
 Ishte e re, gjoksi plot sensualitet.  
 Gishtat e hollë si harpë e dashur.  
 Me dhimbje të pafund shpirtin ja ngarkonte,  
 Figura e asaj mëkatareje, kur e takonte!  
 Kur kish qenë kjo?, dje ishte, apo vite,  
 Dhjetra vite më parë? .. Dhe kur kaloi? ...  
 Koha pastaj si një mur pluhuri e thërmoi,  
 Dhe gjithçka u zhyt në në harresë, shkoi.  
 Dhe çfarë mbeti? – Kjo letër si stoli,  
 Kjo fletëz e kaltër, si ëndrra,  
 Ku ka shkruar ai fjalët e lamtumirës,  
 Për vajzën flokëverdhë – Sharlotë Shulc.  
 Një fletëz ngjyrë kaltër e hapur, sipër zbukuruar  
 Me një figurë misterioze dhe të imët fare,  
 Dhe me germa gotike me pendë të hollë ish shkruar  
 Një varg i shkretë dhe pa talent! ...

Ja, kjo ish gjithçka. – Gjatë, gjatë qëndroi,  
Figurën e imët dhe shkrimin vështroi,  
Desh ta palosë atë letër, që ta ruante në ndonjë vend,  
Ose të prishte figurën,  
Ndërkaq e la; pranë fletëve të tjera e vendosi;  
Me fijen e fundit të vullnetit u shkund nga mendimet,  
Dhe filloi të shfletojë me kthjelltësi të errët  
Të tjerat fletë të vjetra.  
Dhe pastaj, në të zbardhur të ditës tjetër,  
Kur ora e largimit nga shtëpia po afrohej,  
Nga sirtari nxorri një fletore të vjetër,  
Që ta shihte edhe një herë, të çmallohej.  
Gjatë, gjatë e pa fletoren,  
Kujtoi papritur babanë e tij, fortesën e Jerevanit,  
Nënë, fustanellën dhe jelekun madhështor të saj kujtoi,  
Dhe pastaj të shfletojë fletoren filloi!...  
Fillimisht shfletonte ashtu, pa qëllim,  
Pastaj, sytë i ranë mbi një “bajat”\*  
Filloi të lexojë një copëz me durim,  
Pastaj, në mendime u zhyt – dhe deri në të gdhirë,  
Kur rrezja e parë e dritës në dhomë kish depërtuar,  
Ai ishte duke lexuar, lexuar, duke harruar, që  
Së shpejti do t’i linte të gjitha dhe kish për t’u larguar! ...  
Lexoi, lexoi gjatë. – Në nja dy vende  
Vuri re disa gabime  
Dhe me laps i korrigjoi. – Pastaj ngadalë  
Bëri të tjera korrigjime, - pastaj nën ndikimin  
E diturisë së pafund, të mendimeve të errta  
Të qënies së tij, ku mendja kish frikë të depërtonte,  
Nga shqetësimi rritej një ndjenjë frike,  
Si një dyshim i papërcaktuar dhe pa formë! ...  
Tashmë po avitej agimi, dhe ai duhej të flinte,

\* “bajat” - një lloj muzike orientale melankolike, që shpreh trishtim

Ndërkaq vazhdonte të lexonte, - dhe papritmas, frikshëm,  
 Nga shqetësimi një mendim i pamundur ngriti krye,  
 Dhe ju ngul në tru si një topti i çuditshëm dhe i shndritshëm.  
 Çfarë thoshte ai libër dhe çfarë desh të tregonte,  
 Mos vall' që është' e kotë talentin e tij dëm ta çonte?  
 Dhe a nuk ishte ai shumë larg nga të qenët i mirëpritur,  
 Në një vend të keq pune të detyruar, dhe ai libër shkruar,  
 Me gjakun e tij, me gjithë nervin e shpirtit të zhuritur,  
 Me përpjekjen e fundit krijuar,  
 A nuk është vallë rezultat i mjerimit dhe gabimit,  
 Dhe i dëmshëm për brezat që do të vijnë?  
 Me kohë këto mendime të mbrapshta e kishin lënduar  
 Shpirtin e tij që s'gjente prehje; - ndërkaq, çdo herë  
 Që nxirrte librin dhe rrinte duke lexuar,  
 Diçka që s'i gjendej fundi ndonjëherë,  
 Një gjë e çuditshme, e trishtuar  
 Diçka fluturake, diçka e pakuptuar,  
 I shplante shpirtin dhe fytyrën e ngarkuar,  
 Ndonëse lotët rridhnin! ...Oh, ju orë të trazuar  
 Të vetmisë, rebelimit, meditimit,  
 Të një shpirti rebel dhe të papërkultur,  
 Të një mendjeje krijuese me shpërthime të zemërimit,  
 Si e një asketi të trazuar dhe të magjishëm! ...  
 Dhe gjuha Armene, kumbuese, e vrullshme si stuhi,  
 Në shpirt shenjtëruar me zjarrin e mallkimit,  
 Dhe mendimet e pafund, përgjatë viteve thellë ngulitur,  
 Vallë gjithçka është e gënjeshtërt dhe rastësi? ...  
 Vallë pluhur është gjithçka, lajthitje e shpirtit;  
 Dhe gjithçka, që ka ardhur në jetë,  
 Ëndrrat e tija të shenjta, lotët e fshehtë  
 Pa kuptim kan' qenë, si me vorbullën  
 E ditëve të tij të vështira, që tundeshin në vorbull  
 Si varka të vogla letre apo si ashkla duke lundruar,  
 Dhe gjithë jeta e tij ish bërë një çështje e kotë,  
 E çuar dëm dhe pa qëllim dhe me re ngarkuar? ...

Por jo; sido që të jetë – gjithsesi  
Nuk gënjen fëshfërima e kësaj gjuhe,  
Tingulli melodioz i këtij libri këngësh,  
Që duke prekur gurin mijravjeçar të jetës,  
Do ta plasë atë gur, atë mur shkëmbor,  
Do të hapë të paktën një shteg të ngushtë,  
Ku dituria do mund të hyjë dhe të derdhet,  
Si gjaku i pastër kalon nëpër kanalet e hapur.  
Jo, nuk gënjen gjuha; - si vërshimet e vrullshme  
Të përrënjve në pranverë para tij ajo ushton, -  
Dhe ai lexon i mahnitur, me zë të lartë lexon,  
Ndërkohë që jashtë – një ditë e re po agon.  
Por nëqoftëse nuk del i gabuar ky dyshim,  
Dhe ky libër e ka gabim? ... - Ai,  
Me shpirt të trazuar, parathënien e librit hapi,  
Lexoi nja dy rreshta dhe e kapi inati,  
Ta hidhte librin përtej tashmë ishte gati;  
Kur papritur, ju shfaq përpara syve të turbulluar  
Një fytyrë e mirë, që përballë i kish qëndruar!...  
Ish ai – mësuesi. Me fytyrë të mirë,  
I qetë, fjalëmprehtë dhe i çlirë,  
Si një mik i respektuar,  
Dhe i fortë, dhe i butë, dhe pakufisht i shtruar;  
E vështroi atë për një çast, sytë i depërtuan  
Në thellësinë e shpirtit të tij – dhe të brishtat duar  
I vendosi mbi libër në mënyrë vëllazërore  
Dhe murmuriti qetësisht: - Lëre, Khaçatur.  
Shum' i ëmbël ishte zëri, – por në të njëjtën kohë,  
Edhe i frikshëm ishte, si porosi para vdekjes,  
Dhe papritmas kujtoi ai; - në atë rrugë të acartë  
Drejt vargmalit Masis, – një herë,  
Me po atë zë, ai, mësuesi,  
Qetësoi veten, kur atë vetë një fshatar  
Desh ta flakte nga rruga e akullt,  
Pasi ky fshatar i paditur

Ishte i bindur, se e di vetë rrugën,  
 Ndërkoh' që në greminën e vet kish' arritur;  
 Dhe tani, me të njëjtin zë, vendosmërisht njoftonte ai,  
 Se do i qëndronte besnik zotimit të tij. –  
 Dhe i qëndroi. - Me një lëvizje të shpejtë  
 Mbylli librin, e vendosi në kutinë e zakonshme,  
 Pastaj mblodhi letrat dhe me një vështrim  
 Të hidhur – të gjatë, për të fundit herë,  
 Pa letrat, kutinë, pikturat e dhomës,  
 Mbylli arkën, veshi pallton,  
 Kapelen e vuri nën sjetull,  
 Dhe doli jashtë.  
 Tashmë ishte mëngjes. – Mbi kopësht  
 Kish rënë drita ngjyrë zerdeli  
 E diellit Araradian – dhe nëpër mjegullën  
 E kuqërreme mëngjesore,  
 Atje larg, ku fillon e shfaqet vija e horizontit,  
 Po zgjohej Masisi me pamje madhështore,  
 Si një lojë drite, ashtu si një i largët  
 Mik besnik apo vëlla.  
 Natën s'kishte fjetur. – Ish i lodhur, i rraskapitur,  
 Mendimet të ngatërruara, trurin të topitur,  
 I lodhur ish dhe i trishtuar, - kur ndërkoh' jashtë erdhi  
 Mëngjesi i mbështjellë me madhësi;  
 Papritmas e ndjeu veten aq të lehtësuar,  
 Dhe aq, dhe aq të freskuar,  
 Sa që gjithçka, gjithçka që kish mbetur pas,  
 Ju duk si një ëndërr e shkuar;  
 Ju duk e ëmbël dhe e paçmuar, e largët dhe e pavërtet',  
 E shenjtëruar, si kujtim i artë, ndonëse i zbeht'  
 Dhe eci me hapin e zakonshëm, plot vendosmëri,  
 Sikur po shkonte në punë, që kish shumë rëndësi.  
 Përballë – ish fushë e pafund, ndërsa në largësi  
 Dukej Masisi,

Ai vargmal madhështor, nëpër rrugët e të cilit një ditë kish shkuar,  
Ish ngjitur ai vetë dhe ish mrekulluar  
Me bukurinë e akullësisë së tij.  
Dhe tani, mbetur vetëm,  
Ai po shkonte drejt atyre lartësive të kaltra përsëri,  
Drejt vargmalit të pamas' dhe të frikshëm në të vetën madhështi;  
Drejt majës së lartë, të cilën banorët e saj,  
Në mendësinë e tyre, si të shenjtë e kanë trajtuar;  
Po shkonte atje, qetësinë e përjetshme për të shijuar! ...

## LAVDI RRUSHIT, VERËS DHE EDUKIMIT TË MIRË

### I

Në këto dit' të ngrohta kur toka gjëmon,  
Kur ushtrit' e mëdha përplasen me zhurinë,  
Kur që nga Ararati deri tek maj' e lartë  
E Himalajeve, që qiellin takon,  
Nga betejat që zhvillohen, kërcëllimën  
E that' të armëve që vjellin zjarr dëgjion,  
Me një entuziazëm, që duket qartë,  
Unë ndërkohë po thurr këtë lëvdatë.

### II

Unë ndërkoh' po i thurr këtë lëvdatë  
Këtyre ditëve tona plot shtërngatë,  
Kur në mes furtunës turma të larmishme  
Shtyheshin për në beteja të stuhishme;  
Shtyheshin atje në një betej' të madhe  
Sipas mësimëve aq shkatërrimtare,  
Të zeza, mizore, që në tokën tonë  
I pastroi furtuna jon' çlirimtare.

### III

O, Tetor, çlirimtar që solle fitore,  
Posi uji, që del i vrullshëm, me vërtik,  
Jashtëqitjen e jetës jashtë e nxorre  
Dhe na solle neve jetë plot, me bollik;  
Dhe na solle neve jetë me plot ndriçim,  
Me të cilat ngarkuar, tashmë papushim  
Neve po luftojmë edhe po ndërtojmë  
Ditë të dobishme, dhe ditë plot gëzim.

### IV

Të tjera beteja ne kemi para nesh,  
Dhe furtuna akoma më të stuhishme,  
Ndërkaq dielli i sotëm, që përcëllon,  
Të zbresë poshtë në tokë më nuk lejon  
Nga e shndritëshmjia kupë e qiellit ton'  
Asnjë kundërshtar si armik apo demon.  
Oh, të aftë jemi ne të ruajmë fort  
Këtë diellin tonë, që si zjarr ndriçon.

### V

Me kokat tona të ndezura zjarr i gjall',  
Me duart tona të ashpra plot damarë,  
Me beteja të vështira jemi përball'  
Dhe sulme zulmëmadhe kemi ndërmarrë.  
Ky zjarr sot po ndez një gëzim të vërtetë,  
Dhe në botën tonë që shtrihet pa kufi  
Thesaret e prodhimeve sjell në jetë,  
Art, këngë, të korra, fruta e mirësi! ...

VI

Aha, ja përse, - ndonëse atje më tej,  
Jashtë botës sonë që s'ka të mbaruar,  
Ku horizonti i kaltërt s'ka të shquar,  
Veç re të errta, të zymta, grumbulluar,  
Aha, ja përse, - ndonëse ende kemi  
Beteja në të ardhmen për të përballur,  
Me besim të pastër e të papërlyer  
Tani unë jetës lëvdatë po i thurr.

VII

Po i këndoj këtë lëvdat' unë tani  
Rrushit tonë të kuqërrem' dhe plot shkëlqim,  
Verës sonë, të shndritshme dhe plot afsh si zjarr,  
Dhe artizanëve tanë duarflori.  
Dhe edukimit ton' i këndoj un' tani,  
Bukurisë fisnike të edukimit,  
Që këto ditë na dhuron me bujari  
Fruta të shijshme dhe çastet e gëzimit

VIII

Me një besim të pafund të jam drejtuar  
Ty, në diell thekur, bujku mendjendritur,  
Që përpara na shtyn duke brohoritur  
Për një vreshtari të madhe të zhvilluar.  
Të drejtohem ty, që të më udhëheqësh  
Në mendimet e mia, ashtu siç drejton  
Në të gjith' brazdat që hapim në jetën ton',  
Dhe na paraprin me mendjen tënde që vlon.

**IX**

Jo, ne, ish koristët, nuk drejtohem i më,  
Prej hyjneshës që thurr atë këng' të ndritur  
Muzës së muzikës, që ashtu pa peshë,  
Zbriste më përpara, në shekujt e hershëm,  
Shpirt u dhuronte kreshnikëve të lashtë,  
Lavdi u jepte kreshnikëve të lashtë,  
Dhe i nxiste ata kreshnikë të lashtë,  
Drejt një jete madhështore dhe hyjnore.

**X**

O, ju shekuj helenikë madhështorë,  
Kur njerëzimi, akoma ndër pelena,  
Me këng' vazhdonte përkundej e mendonte,  
Dhe me këng' mbillte në dhe bimën që donte,  
Dhe me këng' fillonte kullotat lëronte,  
Dhe ndërkohë me mendjen e vet naive  
Përpiqej, lodhej, dhe vazhdonte kërkonte  
Rrjedh'n e zez' të jetës të parashikonte.

**XI**

Ndërkohë fituesi vazhdonte t'i thosh'  
Olimpistit më të fundit, që në jetë  
Të ngresh, kurdoherë e kudo që të rrosh,  
Shpirtin e veprimt, fuqinë e dijes;  
Për më tepër, ti s'ke përse drejtohesh më  
Nga këngët e muzës, por veten tënde ti  
Po e udhëheq, përpara shkon syhapur  
Në gjurmët e Mendjes, që po të parapri'.

## XII

Oh, prandaj lavdi i thurr Udhëheqësit,  
 Drejtuesit tonë që talent rrezaton,  
 Gjenisë së tij që si dielli ndriçon,  
 Dhe ushtrive me hap të hekurt që ushton.  
 Po të drejtohem un' ty, o, Timonier,  
 Ty, me shpirt gjeniu, gjeni si pak të tjer',  
 Që ndeze këtë diell-zjarr të pashuar  
 Nën qiellin tonë prej erës trazuar.

## XIII

Ty të drejtohem, oh, nga gjumi pushtuar,  
 Por krijes' e gjall' me gjeni të pashuar,  
 Që neve na shtyn vazhdimisht, papushuar,  
 Drejt lartësive nga dielli ndriçuar.  
 Më ndihmo, fuqi më jep, o, Timonier,  
 Të të thurr lavde si diellit të zjarrtë,  
 Që lëvdata të bëhet e fort', e qartë  
 Për shpirtin tënd pjellor, që s'pushon ndonjëher'.

## XIV

Kjo botë e gurtë sa shumë peshë mbart,  
 U bë rrushi, me kokrrën e tij që ndriçon,  
 Dhe vera e pastër që jetën gjallëron.  
 Dhe kënga ngjiti marshin e saj triumfal,  
 Mjeshtëria krijuese në pah kish dal',  
 Dhe edukimi filloi ashtu pa ndal',  
 Për shpirtin ngarkuar me zell gjenial.

**XV**

Por me këngën time s'jam duke lëvduar  
Kët' rrush të zi të shekujve të kaluar,  
As verën plot afsh të shekujve të shkuar,  
As edukimin e hershëm fort vjetruar.  
O, pasion i shekujve të kaluar,  
Që veç mbretërve botën u ke ndriçuar,  
Që skllavërin' e zezë ke kultivuar  
Dhe me edukimin fals e ke pruar.

**XVI**

O, qeli të errta, ndërtuar në mesjet',  
Dhe mësues të ngrysur, fytyra pa jet'  
Që me shkrimet e vjetra ende vazhdoni,  
Me librat shirit-zinj, me shkrime pa vlerë,  
Vjersha me zë të lart', me rimë të paqart',  
Lutje, dedikuar virgjëreshës së shenjt',  
Që në mendjen naive të burrit fshatar  
Pengesë të errta, të ndyra, vendosin.

**XVII**

O, ju murgj me veladona të vjetruar,  
Që rrushin e vreshtave keni shijuar,  
Kokrrat e shijshme prej bujkrobit prodhuar  
Dhe verën e vërtet' po prej tij punuar,  
Nga qelit' tuaja me rima pakuptim,  
Mbi verën dhe birin duke hedhur mallkim,  
Dhe njeriut të thjeshtë, bujkrobit naiv  
Ja fryni kokën me të kotin predikim.

**XVIII**

O, ju hartues të zinj fjalësh të zymta;  
Ti, Shnorhali, bashkë me të dhe ti, Narek,  
Ju, shkrues në pergamen' dhe mendjendritur,  
Ju – të tmerrshëm, ashtu si edhe Darehu,  
Ju – me mendje fëminore, ju – verdhacuk'  
Që për zemrën me shekuj, për shekuj pa fund  
Veç varre keni ndërtuar – këllëfe prej guri,  
Dhe për shpirtin – skëterrë, vite të rëndë.

**XIX**

O, diell i errët i mesjetës sonë,  
Varur në kupën e errët qiellore,  
Nga Mesdheu deri në vendin e ftohtë  
Toka mbushur plot me gur', plisa të ngrohtë,  
Dhe një popull i djegur me zjarr shkruar,  
Brenda kështjellave me gur palatuar  
Të zënë përfund, nga gënjeshtër hutuar,  
Nga fjalët e rreme bukur predikuar!

**XX**

Brenda kështjellave janë grumbulluar  
Parazitë të shturrur dhe imoralë,  
Armë të tmerrshme që me gjak jan' mbuluar,  
Dhe manastire mbushur plot me skulptura  
Me pikat e gjakut të skllavit ndërtuar;  
Manastire me kube mbi re lartuar,  
Mësime të errta që frymën të marrin,  
Shpirtin e bujkrobërve duke lënduar!

**XXI**

Nuk po i thurr lëvdatë gjenisë suaj,  
O, ju murgj pleq, predikues pa ndërgjegje,  
Që me fjalët e errta, që predikoni,  
Një popull të tërë në skllëvër e shndrroni,  
Pastaj ndërtoni me duar mjeshtërorë  
Zinxhir' të ashpër dhe të rrept' shpirtërorë,  
Dhe librat tuaj mbi të rremen shenjtëri,  
Me hymne për dritën, shenjtin plot madhështi.

**XXII**

Zelli dhe gjithë puna juaj shkoi kot,  
Sado të mençur ishit, gjeni dhe të zot;  
Ndërkaq nuk arritët kurrë t'ja fikni dot  
Popullit të varfër fjal'n e shenjt' që flet sot!  
Oh, gjuha e vërtet' e njeriut të thjesht',  
Nga predikimi juaj rëndë sulmuar,  
Ujin e vet të pastër posi qelibar,  
Në shtratin Armen, – ndër shekuj ka dërguar!

**XXIII**

Ju – oborrtarë, ju ishit – në të vërtet'  
Monumente të mësimëve të kota,  
Për jetën e armikut, zemrën dhe dritën,  
N'emër të virgjëris' së shenjt' papërlyem';  
Rrjepacakë të pasionit dhe lakmis'  
Ju, edukimit tonë sot s'i përkisni,  
Prej shekujsh burim i bollshëm i madhështis'  
Që do të shkojë pa ndal drejt përjetësis'!

**XXIV**

Oh, tash jo më, - sipas shkrimeve tuaja,  
Të shekujve të lashtë, por posi përrenj  
Të pastër dhe tinguj-artë të Gortanit,  
Kanë arritur vargjet e trishtimit ton'!  
Dhe fjalët e bukura të gëzimit ton'!  
Kanë arritur ninulla tip rapsodi,  
Nga vjershëtorë fshatarë dhe endacak'  
Dhe këng' popullore që bredhin prak më prak!

**XXV**

Lavd po i thurr tani unë rapsodisë  
Këngëve tona të ëmbla tinguj-artë,  
Që këngëtarët endacakë, të mjerët,  
Kanë kënduar në ata shekujt t'errët.  
Që në botën ton' të vjetër të rreckosur,  
Me dridhje zëri, fjalën e palatuar,  
Jo gurit të errët të manastirit, por  
Dashurisë së vërtet' ja kan' kushtuar!

**XXVI**

Dhe lavd po i thurr tani këngëve tona  
Bredharake, plot me fjalë bukuroshe,  
Që hymn i thurrin verës qoshe më qoshe,  
Bukurisë së kokrrave të brishta të hardhis',  
Vepër e vërtet' e djersës së njerëzis'.  
O, gjuh' e zhdërvjellët e njeriut vulgar,  
Zëri i punës që nën diell lulëzon,  
Lirë e dashurisë, gëzimit fshatar!

**XXVII**

Oh, gëzim i shkretë, i thjeshtë e pa shkak,  
Oh, gëzim i njeriut naiv e të thjeshtë,  
Oh, rrush i shkukur deri në të fundit rresht,  
Oh, ti, verë, nga hardhi e fundit shtrydhur,  
Që larg manastireve në t'errët ndrydhur  
Po rrjedh në ato kasolle krejt rrënuar,  
Në shtëpit' e bujkrobërve të trishtuar,  
Në këngët dhe zemrat e tyre coptuar!

**XXVIII**

O, bujkrobër puntorë, ju që jetoni  
Në kasolle të vjetra pa der', pa çati,  
Ose jashtë qyteteve me mure rrethuar  
Në guva të thella në shkëmbinj gërmuar,  
Me punën tuaj të rëndë dhe të shenjtë,  
Me zell të heshtur, me djersën e paçmuar,  
Dhe këndonit këngët tuaja të zjarra  
Me fjal' të kristalta, me rima të pastra.

**XXIX**

Me fjalë trishtimi tashmë lavd po i thurr  
Të pastrehëve, që trishtimi s'ju nda kurr',  
Këngëtarëve shetitës, që ndër shekuj  
Nëpër fshatrat tona kanë pas' kënduar,  
Ose në qytetet me gurë ndërtuar;  
Qyteteve me shtëpi ku zhurm' tjetër s'ndjen,  
Veç dashurisë së dashnorëve, që zjen  
Larg atdheut të tyre, që gjëkund s'e gjen!

## XXX

O, sklevër plot talent - të poezis' sonë  
 Burime të pastra, - ju, me zërin e art',  
 Që duke gurgulluar arrin deri lart  
 Nëpër vorbullën e poezisë sonë,  
 Duke u zhytur në këngën Hovnatane  
 Dhe në vjershat model Sajat – Noviane,  
 Lindur si burim i vërtet' frymëzimi  
 Për artin ton' të ri plot nota gëzimi!

## XXXI

Oh, tek ju e kanë marr' fillesën e par'  
 Këngët e popullit tonë, këngët plot zjarr,  
 Këngët e arta, si dielli shkëlqimtar  
 Të rapsodëve tan', me talent të papar';  
 Dhe pastaj prej jush është' bërë e pëlqyer  
 Ajo poezi, të cilën prej së djeshmes  
 Rapsodi ynë i vërtetë i Lorit  
 E shndrroi, e bëri kristal të shkëlqyer.

## XXXII

Pastaj ndodhën ngjarje që sollën hidhërim,  
 Këngëtarë të trishtë dhe flokëthinjur,  
 Që thurrën vargje për ngjarje plot me trishtim,  
 Ashtu me zë të butë, si me ngashërim;  
 Por unë nënshtrimin më s'e përballova,  
 Dhe, me zjarrin e ndezur të botës në flak',  
 Këngë të zjarra dhe të nxehta këndova,  
 Vargje me zërin e tokës lyer me gjak.

**XXXIII**

Pas meje erdhën pastaj të tjer' këngëtar'  
Që vendit, tokës, gazit i këndonin mbar',  
Këngëtarë, të dalë nga jeta e re,  
Këngëtarë të punës që sjell veç hare,  
Nga kasollet ku s'hynte drit' e diellit,  
Erdhën nga minierat, erdhën nga burgjet  
Ndërtuar me gur', ku në shekujt e shkruar  
Veç për skllavëri ishte folur e shkruar.

**XXXIV**

Një diell i zi, i rëndë, kish zhuritur  
Për vite me rradh', deri pak kohë më par',  
Tokën tonë të gurtë e të braktisur,  
Kasollet tona ngritur me baltë të thar'.  
Mbi kokat tona – shumë zotër qëndruar,  
Armenë, të huaj, pa kurrfar' dallimi,  
Mbretër, si kafshë të egra, të tërbuar,  
Me ta dhe kryqi, kamxhiku dhe ndëshkimi.

**XXXV**

Si murtajë e keqe ranë mbi Armeni,  
Timurlengu, me sy mizor' që s'njeh kufi,  
Çingiskani, me të panumërtat hordhi,  
Abasid' të ndryshëm me fam' në mizori,  
Dhe mbretërit rus' me etje gjakpirësi!  
O, mbretër gjakpirës, prej ekspeditave  
Tuaja të shenjta shumë kemi parë  
Fatkeqësi të rënda, që kanë ngjarë!

## XXXVI

Dhe ndërkaq bashkë me ju, bisht i pandarë,  
 Nën çadrën tuaj të shenjtë janë parë  
 Zotërinjt' e rëndë të atdheut tonë,  
 Akoma më të tmershëm dhe më vrastarë!  
 O, egërsira, në kështjella qëndruar,  
 Si bisha t'egra nga kafazi liruar,  
 Princër të shthurrur, pa fuqi, plogështuar,  
 Dhe Melikë nga etja për gjak kapluar!

## XXXVII

Thjesht', pa zhurmë, rrugëve të robërisë,  
 Kjo gjuhë e popullit ka udhëtuar,  
 Por kur u shfaq, si diell u pa të shndrrisë,  
 Dhe sot për ne është diell i pashuar;  
 Tani po rrjedh, po rrjedh, si ujvara në mal  
 Burim jetëdhënës, i pastër si kristal,  
 Dhe unë i këndoj me rimë që rrëshqet  
 Këtë këng' të ëmbël, lëvdatë të vërtet'.

## XXXVIII

Lavdi asaj luftës tënde të vazhduar,  
 Rimë e thjesht', që në shekuj je kënduar  
 Rrugëve të popujve të skllavëruar,  
 Duke çarë shtigje pak për t'u ndriçuar;  
 Ke mbrritur tani deri tek ne plot shkëlqim  
 Si yll i zjarhtë, si dielli krijimtar,  
 Duke u ndezur flak', duke u bërë zjarr,  
 Për lavdinë e të gjithë skllëvërve mbar'.

**XXXIX**

Lavdi diellit ton', që tani i zjarhtë,  
Po ndriçon me bollëk me dritë të artë  
Në kasollet tona duke depërtuar  
Dhe të qyteteve bodrume qorruar;  
Që ndër malet tona të vjetra, të larta,  
Është duke dërguar rreze të arta,  
Që njeriun e shtypur, bujkrobin e shkret'  
Ta shndërrojë në zotin e fatit të vet.

**XXXX**

Oh, ju, o vëllezërit e mi të lashtë,  
Poetë bredharak' këngësh popullore  
Sklllevër këngëtar', mendërisht robëruar  
Nga ligjet e një kohe tashmë të shkuar;  
Ja, gjuha e thjesht' e këngëve tuaja,  
Që deri tek un' ka arritur, dhe pastaj  
Duke shkuar tek këngëtarët më të rinj,  
Tashmë po kapërderdhet nga brigjet e saj!

**XXXXI**

O, sklllevër të talentuar, nëse shekujt  
E skllavërisë, pa diell atëkohë,  
S'e mbytnë dot këtë gjuh' aq të përsosur,  
Që me rreziqe pa fund, që s'kan' të sosur,  
Erdhi aq e gjall' deri në ditët tona,  
Nën këtë diellin tonë të zjarrt', tani,  
Ku nuk ka më sklllevër, nuk ka më zotëri,  
Do rrjedh' si uj' i bollshëm në hulli të tij!

**XXXXII**

Dhe tani ajo po shkon rrugës që të çon  
Në oqeanin e jetës që po afron,  
Ku njerëzimi i gjithë botës mbarë,  
Pa rende, pa klasa, të gjith' qytetarë,  
Përveshur në punën që sjell kënaqësi,  
Do punojë tokën e vet të pakufi,  
Tokën e diellit, verës, edhe këngës,  
E fryteve të mendjes dhe shpirtit të tij!

## ELEGJI DHE POEZI TË TJERA

### MËNGJES EPIK

Muzgu drejt në sy po më vështron  
Sot me fodullëk, diçka mendon.  
Mëngjesi shumë shpejt do të zbardhoj',  
Dhe shpirtin me shend do më ngarkoj'.  
Sa mirë është të çohesh herët  
Të shohësh muzgun tek largohet,  
Duke tërhequr dhe ngritur lart  
Tym'n e oxhakut që lartohet.  
E ndjej që ankthi po më ngacmon,  
Rrugën e zgjedhur të dij' kërkon,  
Një rrugë, që akoma më lart të çon,  
Një rrugë e pafund ... !

Dhe ti më bëre mendjehapur,  
Në të fundit pjekurin' time ...  
Dhe un' po shkoj tani syhapur.  
Ndonse e vështir' rruga ime.

Ankthi më shtyn të shoh përpara;  
Luft' e gjatë do duhet bërë,  
Që puna të qëndroj përherë  
E gjall' si diell në pranverë.

Brezat na shohin nga e ardhmja,  
Më vëzhgojn', më thon' të kem kujdes  
Një dor' e padukshme më mbron  
Në rrugën time drejt së ardhmes!  
Po ndahem prej jush me dashuri,

Çkujdesja ime e hareshme,  
Ditët e çlirta fëminore,  
Kohë e rinisë gazmore.  
Po të përshëndes ty me gëzim,  
Dhe aspak me dhimbje, hidhërim,  
O i fundmi ti agimi im,  
Mëngjesi im epik, heroik!

1929

## MUZËS

Tani, përsëri, bashk' me mua je, përsëri,  
Miku im, shoku im, bashkëluftëtari im.  
Këngën tënde jam duke dëgjuar un' tani  
Atë këngë plot mall dhe dashuri pa kufi.

Tani në fjalët dhe në bisedat e tua  
Të paharrueshme, plot zemër e mençuri,  
Në këngët e tua të fuqishme, për çudi,  
Pikëllim të pastër ka dhe dhimbje pa kufi.

Çfar' jam unë tani, e di?; i dashuruar,  
Shpirt që dashuron, por pa mundur të gëlltisë  
Atë trishtim të pastër që i ngjan gëzimit,  
Atë pikëllimin tënd që i ngjan krijimit!

Me hidhërimin e thell' fshehur nga vështrimet,  
Mora rrugën e udhëtarit të trishtuar,  
Atë udhë të mundimshme, që kur ngjitesh lart  
Dhe kthen kokën prapa, sheh rrugën e përshkuar.

Po kur e përshkoi ai gjith' këtë rrugë,  
Dhe dita vallë si u bë kaq shpejt mesditë?  
Ky pikëllimi i tij në mjegull nuk kalon,  
Në djersë është shndrruar, që pastron dhe freskon.

Dhe duke fshirë djersën që i njomte ballin,  
Ai ngjitej sipër, përsëri ecte, pa pushim,  
Por në syt' tani i kish mbetur hidhërimi,  
Dhe në këngën e tij rridhte lehtë trishtimi ...

Ne akoma gjatë bashk' me ty do të jemi,  
Miku im, shoku im, bashkëlufëtari im.  
Dhe, trishtimin e shndritshëm lëre të qëndrojnë,  
Kurr' mos avulloj', mbi ball si ves' të ndriçojë.

### **KËNGË TË DJEGURA**

Kur mbrëmja zbriti si një udhëtar i lodhur,  
Dhe si re pluhuri mbi çatit' u ul shtruar,  
Unë hyra në dhomë zhytur në mendime,  
Dhe nxorra këngët që një mbrëmje kisha shkruar.  
Unë nxorra këngët dhe lexova përsëri  
Shkrime, kujtime të një shpirti të dërmuar,  
Dhe u mvrenjta un' prej këngëve plot hidhërim,  
Dhe prej turpfit trishtimi zbriti mbi ballin tim;  
Kur, papritmas, përmes vargjeve të këngëve  
Shkruar nga un' një nat' nën tingujt e muzikës,  
Më pa dhe me buzëqeshje paksa të mekur  
Më qeshi hijshëm një grua, tashmë e vdekur.

Dhe ndërmjet vargjeve më folën mua dy sy,  
 Dy sy të vdekur, posi dy shpata qortimi,  
 Pastaj më pastroi ballin me dorën e brishtë,  
 Dhe e zbriti mbi sytë e mi lehtë, qetësisht.  
 Dhe më tha ajo përmes vargjeve të mia:  
 “ – Bëhu i fortë, shoku im, shpirtin forcoje,  
 At’ shpirt, lodhur nga trishtimet boshe, pastroje,  
 Që të zhduket terri nga kujtimet e tua.  
 Nëse kujtimi im ende i shtrenjt’ është për ty,  
 Nëse do, që kujtimi im mos të të zbehet,  
 Mbaje të shndritshëm emrin tënd si prej martiri,  
 Qëndro shpirt-paepur, dhe luftëtar, dhe i madh!”  
 O, shok i afërm, ti, miku im, motra ime,  
 Gruaja ime heroike që shkove pa kthim,  
 Përsëri diell ka në terrin e shpirtit tim,  
 Dhe pak hare në fytyrën time plot trishtim!  
 Kur pushoi zëri yt at’ mbrëmje, – qetësisht  
 Unë fërkova ballin dhe nderza zjarr, pastaj  
 Ja lash’ këtë jet’ heroike vullnetit tënd,  
 Dhe dogja këngët që kisha shkruar një natë!

1929

### KËNGA E OQEANIT

Këndo, poet, këndo, këndoje këngën e erës,  
 Këndo këngën e dashurisë dhe të betejës,  
 Si furtunë këndo, porsi bilbili ti këndo,  
 Dhe në shpirtin tënd at’ këngë kurrë mos e pusho!

Po kujtoj oqeanin në koh’ stuhie,  
 Gjoksin që buçet të ujrave të pafund,  
 Humnerën që poshtë zhurmon – dhe erën e tërbuar  
 Që një këngë të egër këndon duke rënkuar.  
 Në këngën e saj ndihej një trishtim i pakufi,

Dhimbja e thell' e një shpirti vigan të shkalluar  
Që nga thellësit' e errta të oqeanit në stuhi  
Me dashuri të pafund thërriste pa pushuar.  
Dalë mendsh, thërriste ai një shpirt pa pushuar,  
Thërriste ai të dashurën duke rënkuar,  
Që me këngë vraponte mespërmes stuhisë  
Dhe fluturonte në pafund, duke kënduar.  
Dhe përmes tufaneve me ulurim' duke vrapuar  
Të dashurën hijerënd' duke kërkuar të arrijë  
Ajo erë e xhindosur, çuditërisht e trishtuar,  
Që nga larg këndonte një këng' fitoreje, të gëzuar.  
Ajo ishte një luftë e çmendur ndërmjet ujit  
Edhe erës, dashuri mes dy armiqve xheloz',  
Dashuri e pavdekshme e një dashnori vigan,  
Që i jep erës këngën e betejës në tufan.  
Ish këng' fitimtare e një pasioni pa kufi,  
Ish këng' heroike e një dashurie që s'mbaron,  
Dhe atë këngë fitimtare mbushur me dashuri  
Ajo er' e shurdhët e merr, drejt sulmit e fluturon.

Këndo, poet, këndo, këndoje këngën e erës,  
Këndo këngën e dashurisë dhe të betejës,  
Si furtunë këndo, pors i bilbili ti këndo,  
Dhe në shpirtin tënd at' këngë kurrë mos e pusho!

Në at' stuhi që fryn nëpër muzg si e tërbuar,  
Që pors i er' e fortë thërret duke gjëmuar,  
Të dogji ty për her' të fundit në jetën tënde  
Një dhimbje pa fund, një dashuri e patreguar.  
Të shkundi ty ajo dashuri, ashtu si era  
Që buçet dhe dallgët rrokullis me vrull të shtuar,  
Në kët' orë beteje prej zemrës sate doli,  
Siç del nga marshimi tabori i zemëruar.

Si shkrepëtim' mbi mendimet e tua ndriçoi,  
Si bubullimë kërciti një gjëmim i vrullshëm,  
Dhe t'u lartësuan mendimet, porsi oqean,  
Dhe gjëmoi dashuria jote shkrir' në tufan!

Këndo, poet, këndo, këndoje këngën e erës,  
Këndo këngën e dashurisë dhe të betejës,  
Si furtunë këndo, porsi bilbili ti këndo,  
Dhe në shpirtin tënd at' këngë kurrë mos e pusho!

Në zjarrin e pashuar të kësaj dashurie të pakufi  
Në këtë luftë të llahtarshme, në këtë betejë të shurdhët  
Le të kalitet shpirti yt, si kamë e mprehtë prej çeliku,  
Le të shkëlqejë mendimi, si mendim i lartë prej fisniku.  
Si energji e pashuar brenda teje le të zzejë ajo,  
Si një xhelozë e fuqishme le të vlejë në gji ajo,  
Dhe do të bëhesh ti më i madh dhe do të bëhet i pamposhtur,  
Në këtë luftë i kalitur - shpirti yt thellësisht i heshtur.  
Nga emocionet, si dhe trishtimet e thella në gjirin tënd,  
Le të bubullojë ajo këngë e dashurisë së pamat',  
Dhe, duke dëgjuar atë këngë që kërkon të triumfojë,  
Shpirti yt drejt betejës me vrap le të shkoj', le të fluturojë.

Këndo, poet, këndo, këndoje këngën e erës,  
Këndo këngën e dashurisë dhe të betejës,  
Si furtunë këndo, porsi bilbili ti këndo,  
Dhe në shpirtin tënd at' këngë kurrë mos e pusho!

## POETIT TË VDEKUR

Ata po thonë që ti ke shkuar  
Dhe që je mplakur, dhe je larguar,  
Që të kan' braktisur dhe harruar  
Në këto dit' të çmendura shndrrimesh.  
Por shih - po thërret dikush, e dëgjon,  
Ësht' një shpirt, që akoma ty të don:  
- Rikthehu, ore, rikthehu!

- Rikthehu, dhe kemi për t'dhuruar  
Edhe zjarr, edhe gaz e dashuri,  
Si një endacak i dashuruar  
Ti sërish, sërish kthehesh në shtëpi ...  
Ballit do rrëshqas' një flad plot freski,  
Dhe fryma e kohës do më freskoj',  
Shpirtin do mbush' me ndjenja pakufi,  
Dhe për këng' të reja do frymëzoj' ...  
- Rikthehu, ore, rikthehu!

N'ato rrugë, në të cilat dikur  
Kalove zemërthyer dhe shkove,  
Ecën turma nga dielli pjekur  
Dhe hapen dyer të reja pafund ...  
Në tokën, ku një ditë qave ti  
Dhe u brengose në at' zjarr të zi,  
Ku ka pranver' me diell plot shkëlqim  
Dhe krismë, edhe zjarr, edhe ndërtim ..

- Rikthehu, ore, rikthehu! ...

DY SONETE  
KUJTIMIT TË ARPIKUT

I

Miku im, i shtrenjti im, shoku im heroik,  
Ti jetove, shkove ti dhe më nuk je tashmë,  
Ndërkohë jeta vazhdon dhe mbrapsht nuk kthehet më  
Dhe askush nuk ka thën' që nga lart ka zbritur posht'.

Këtu para meje përsëri lule dhe jet',  
Si lulet e hapura të pranverës tënde,  
Sërish përpyekje, mundime, pa rreshtur do ket',  
Për të rregulluar jetën e njerëzve tan'.

Vazhdimisht, pa gjumë, në rrjedhje të përjetshme,  
Si dallg' e oqeanit madhështor që s'pushon',  
Gjuha e revoltës tonë tani po zhurmon.

Dhe mua më jep forcë dhe krah' luftarakë  
Përsëri kjo ditë e sotme, që merr fuqi  
Nga pasioni, dhe shtyhet larg në pakufi.

II

Bashk' me ty jetuam në një shekull të stërmadh,  
Kur njerëzimi i tërë, me plot ngazëllim,  
Si një mburoj' triumfi tani lart ka ngritur  
Emrin e njeriut, që ndrit si diell n'agim.

Me shpirtrat tanë të dërmuar, të brengosur,  
Një ditë morëm rrugën për varrimin e tij,  
Ku si mburoj' lufte rrinin, si të ngurosur,  
Anës rrugës - turma me njerëz të trullosur.

Ai s'ish mort, or shok, por një agim që u ndez,  
Që u përhap përmbi këtë planet të vjetër,  
Dhe ishim ne, që e përshëndesnim kët' mëngjes.

Dhe tash, duke futur në të imazhin e tij,  
E ardhmja shkëlqente me të kuqen e zjarrit,  
E kuqe si gjaku, si flamur i triumfit ...

1928

## NË HOLLIN E PALLATIT TË DIMRIT

Një natë të errët në këto dhoma,  
 Kur stuhi e borës jasht' po tërbonte,  
 Një mbret – arlekin bërë si porfiri  
 Kish marrë në pyetje Dekabristët.  
 Me ngërdheshje të akullt, mustaqe spic  
 Shtërngonte gishtat e tyre që dridhen,  
 Dhe prej syve të tij të kaltërt, ata,  
 Për një çast, fat i pakthyeshëm i pa.  
 Po me atë shprehje, me të cilën shpesh  
 Kofshën e së dashurës të shihte desh,  
 Duart mbi gjoksin e saj kryqëzuar,  
 “Pestelin” të ulej kish urdhëruar.  
 Syt' e kaltër shpatës duke ja ngulur,  
 Ndoshta një “ah!”, thellë në shpirt ndaloi,  
 Dhe tepër i afërt, me mirësjellje  
 Me “Rrilevin” një bisedë zhvilloi.  
 I thirri një nga një, u foli ashtu,  
 “U hapi” një herë at' shpirtin atnor,  
 Provoi një herë se mos ndikonte  
 Me madhështin' e një mbreti përrallor. ...  
 Me syt' që fshihnin zjarre të tërbuar,  
 I bekon me buzëqeshje të stisur,  
 Dhe prej andej për rrugë pa kthim i nis  
 Drejt burgut, trekëmbëshit, drejt Siberis'.

1929, X, Leningrad

## VAHAGUT

Փրկութեանդ արեւ Վահագնիւ տեսար  
E patë Vahagun, diellin e shpëtimit tuaj ?  
H. Hovhanisjan

Zot i zjarrit, flakë edhe zjarr shëmbëllen,  
Eja, Vahag, eja. – Tashmë po shoh mirë,  
Që ata po gajasen dhe po zgërdhien  
Mbi trupin tënd të zbehtë, pa gjak, të shtrirë.  
Vallë “mit” ishe ti? ... Erdhën dhe kënduan  
Një mbrëmje të lashtë rapsodët pleq për ty,  
Që ti je fuqia, zjarri edhe flaka,  
Që shpëtimi neve do na vijë nga ty.  
Dhe ne e besuam, të pirë dhe me ver’,  
Që ti do vish, me shpirt dhe me trup si Fuqi,  
Por erdhën ata, me gjak, me zjarr këtë her’  
Dhe tokën tonë të lashtë e shndrruan në hi ...  
Dhe kur zvarrisën trupin tënd të cflitur,  
Për ta hedhur ushqim për tuf’n e uritur,  
Bazat e jetës sonë ranë në humner’  
Ku akoma i dëgjon duke kërcitur ...

1916

**ATILA**

Топчи их рай, Аттила!

Вяч. Иванов

Nëpërkëmb paraajsën e tyre, Attila

**I**

Nga thellësit' e shekujve prapë zgjuar,  
Fushave të kësaj toke kaloj tani,  
Syt' kam drejtuar nga zjarret në largësi,  
Nga thellësit' e shekujve prapë çuar.

Më varrosën mua me arkivol prej ari  
Një mbrëmje të largët ata hunët e mi,  
Dhe asnjë mbret, askush vendin tim nuk e di,  
Askush nuk luan me hirin tim tek varri.

Mbretin Atilë e kishin lën' harruar;  
Dhe me kujtimin e tij shaka sajnin,  
E mendonin të vdekur, ashtu kujtonin,  
Por un' – ngritur jam, sërish duke marshuar!

Dhe flakët e zjarrit, kuq dhe portokalli,  
Tek yjet përsëri po arrijnë tashmë,  
Dhe ju kujtoj, me mua mos u tallni më,  
Me mbret'n e Hunëve, Atilën perëndi.

Dhe sërish duke djegur jam, po shkatërroj,  
Qytete dhe fshatra para meje rrafshoj,  
Dhe këtë her', fuqin' e vërtet' do ushtroj,  
Një mbrëmje të kuqe në Romë do vërshoj!

Dhe me grushtet e mi të fortë si hekur  
Kishat tuaja nga themelet do rrënoj  
Dhe para meje mbretërit do detyroj  
Në gjunj', si krimba, të hiqen zvarr', si dikur!

Ata – palaço dhe për t'u mëshiruar,  
Qorra, që qeshën, në cirk duke qëndruar,  
Kur Teodosi tha se kish ëndërruar,  
Që shigjetën e Atilës kish thërmuar.

Ata, të cilët një ditë të verbuar  
Nga vdekja ime, papritur, pakujtuar,  
Rrinin si shum' qetë duke ëndërruar  
Për veten dhe njerëzimin e dërmuar.

Dhe nuk e dinin, që unë nuk kam vdekur,  
Që unë nuk vdes, që kam dalë përsëri,  
Që përsëri do fle, do zgjohem përsëri,  
Unë – Vdekja, Shkatërrimi, Antikrishti!

## II

Sytë e mi të ngushtë shohin përsëri,  
Se si posht' thundrave të kalit tim krenar  
Po avullojn', si kujtim i turbullt, i vrar'  
Ndërtesat kristal që në ëndrra keni par'!

Hej, që nga lindja e deri në perëndim,  
Kudo do mbjell unë tani zjarr dhe rrënim,  
Unë – mbreti, zoti, vdekje dhe shkatërrim,  
Un' – kamzhiku i së vërtetës pa dallim.

Dhe le ta dinë këta zotër të vdekshëm,  
Dhe fort të mbahen ata për të fundit her'

Që un' kam dalë, do jem dhe do mbes' përher',  
Unë – i padyshimti dhe i përjetshëm!

Dhe njerëzit që do vijnë, brezi tjetër,  
Përjet' të kujtojn' në lutje a rapsodi,  
Që në atë tok' bari më nuk do të mbij'  
Ku ka shkelur kal' i Atilës së vjetër!

Dhe të mbajn' mend, që etja për të pushtuar,  
Ëndrra e vjetër për të djegur, shkatërruar,  
Kurrë nuk më vdes, kurrë nuk m'është' larguar,  
Mbi mbretin Atil' askush s'ka triumfuar!

### III

Por kur ndonjë mbrëmje, i nginjur, rri me nge,  
Kur nga kjo lojë ky trup i lodhur më ngjet,  
Përsëri bie të shtrihem për disa vjet,  
Në gjirin e arkivolit prej ari fle.

Dhe gjigandët e mi me mendje të marri,  
Pa lutje dhe pa fjalë, ata përsëri,  
Varrosin në arkivolin tim prej ari,  
Bashkë me mua, dhe varrmihësit e mi.

Që askush mos ta gjej' trupin tim në tokë,  
Që askush dhe askurrë të mos e dijë,  
Se ku është varrosur - huni Atilë,  
Që e hodhi lavdinë tuaj përtokë!

Që sërish, kur nga zjarri i dheut të zi  
Yjet e qiellit do t'i qahen gurit,  
Gjithnjë besnik i ëndrrës së tij të vjetër  
Mbreti Atilë do të ngrihet përsëri!

## ELEGJI, SHKRUAR NË VENEDIK

### I

Tokën e Italisë e brodha unë,  
Pashë Venedikun, gondolat mbi ujë...  
Vërdallosej andej ashtu i hutuar,  
Poeti ynë në ëndrra harruar.  
I paprekur nga shkëlqimi i harlisur,  
I bukurive të tilla përrallore,  
Ai me këngë një shpirt, një shpirt të vjetër,  
Nanuriste, shpirtin që akoma dridhej.  
Atje dielli me takime të buta  
Atë det të qetë ashtu ledhatonte,  
Por një brengë atë tashmë e mundonte,  
Një brengë e vjetër që në shpirt i vlonte.  
Me shpirtin e vjetër, me lirën e vjetër  
Dhe me gishtat e tij, tanimë pa fuqi,  
Vazhdon e përkëdhel një kujtim të largët;  
Dhe ashtu ëmbël, ëmbël, ashtu ëmbëlsisht  
Ai përkëdhelte atë kujtim të mbetur,  
Dhe cili ish kujtimi? – tym edhe mjegull.

## II

Ëndërronte ai atë Arpaçajin,  
 Dhe Gymrinë e tij të vjetër atje larg -  
 Dhe atë, që e vjetër ish, kujtim, çdo gjë -  
 Atij i dukej sikur e tashme ishte.  
 Ai mua më kish thënë: - larg, shumë larg,  
 Ku është një fushë, fusha e Shirakut,  
 Ndodhet një kasoll' e vjetër, e rrënuar,  
 Që flakës së zjarrit i kishte shpëtuar.

Atje qetësisht rrjedh një i urt' përrua,  
 Dhe plepat, që drejt qiellit kryet lartojn',  
 At' këngën e tyre tani i kujtojnë  
 Dhe kryet që tunden e shkunden papushim.  
 Gjethet e thara ata po i lëshojnë,  
 Kasollen e vjetër me to po mbulojnë,  
 Ashtu si këngët e trishta të pasvdekjes,  
 Që dënesin shurdhët dhe pa zë vajtojnë.  
 Ajo është kasollja e tij. - Dhe atje  
 Këngë kish thurrur, kish ëndërruar ai.  
 Atje ka lule plot, gjethe të zverdhura,  
 Atje ka ëndrra, dhe këngë, dhe dashuri. -

## III

Ai kishte shetitur, bredhur kish ai  
 Nëpër shumë dete edhe kontinente  
 Dhe ngado ai kish shkuar, kudo, kudo  
 Të njëjtën gjë kish parë. - Nëpër qytete  
 Uzina, fabrika pa fund kishte parë,  
 Dhe puntorë, të heshtur, pa fjal', mizëri,  
 Puntorë në tufa mbledhur, si bagëti.  
 Dhe n'ato qytete plot zhurm', pa qetësi,

Me ëndrra dhe shpresa të kota ngjyrosur,  
Turma të heshtura, memece, pa ai  
Dhe zotërinj, barkmëdhenj dhe të krekosur.  
Në jetë kish parë ai veç zotërinj  
Dhe turma plot me njerëz të vetkënaqur,  
Që janë të aftë jetën ta jetojnë,  
A thua se ata janë të përjetshëm.  
Dhe ai i urrente ata zotërinj,  
Por më tepër ato turma si bagëti,  
Ata, të cilët jeta i ka mallkuar  
Dhe në skllëvër edhe robër i ka shndrruar.  
Dhe ai thoshte, përsëriste: – Mbi tokë  
Kafshë, ujk është njeriu për njerinë.  
Se ligji i jetës është i përjetshëm,  
Për të dikush është 'leck', tjetri hekurosës. –  
Dhe thoshte ai: - i tillë është njeriu,  
Dhe do mbetet i tillë, gjithnjë po ai,  
Deri sa vjen çasti dhe mendjen ja ndriçon,  
Dhe e bën të kuptojë se drejt vdekjes shkon.  
Përgjatë gjithë jetës në këtë botë  
Vetëm këtë gjë ai kishte kuptuar –  
Dhe për këtë mashtrim, mashtrim i përkryer,  
Ai kish qarë se kot kish ëndërruar.

#### IV

Dhe kish bredhur ai, jetim dhe i plakur,  
Në këto qytete me zhurmë ngarkuar,  
Që mbushur ishin me ndërtesa hekuri,  
Fabrika me tym të trashë e të dendur.  
Diku aty rrotull, një buldozer me zell  
Zhvillonte përreth një betejë të dhunshme;  
Një çast qetësi – një grevë kish filluar,

Betej' heroike që s'kish të pushuar ...  
 Ndërkaq shpirt' i tij, përjetësisht i ndrydhur  
 Në luft'n e heshtur për ndërtimin e botës,  
 Zvarrisej në mesin e saj posi kërmill,  
 Dhe lëvizte ose tundej si një grimcë.  
 Një tjetër iluzion kish pasur ai,  
 Një tjetër ëndërr, dashuri si qëmoti –  
 Dhe për shpirtin e tij e dliret qëndronte  
 Vetëm ajo e hershmja. – Oh, sa do donte  
 Në shtëpinë e largët të ishte kthyer,  
 Të shihte përsëri përroin e vjetër,  
 Ku këngët e tij në heshtje murmurisnin  
 Veç ëndrra të kota dhe fjalë trishtimi. –  
 Atij, ndërkaq, jeta jonë sovjetike  
 I dukej e mërziqshme dhe e gënjeshtërt;  
 Frymëmarrja e saj për të ish e huaj  
 Dhe gjuha e saj e ftohtë, e pa kuptim.  
 Drita jonë atij i dukej e ftohtë,  
 Dielli ynë – i dukej errësirë,  
 Qytetet tanë – me tmerre pa fund mbushur,  
 Dhe fushat tona i ngjanin shkretëtirë ...  
 Në sytë e tij Tetori ynë dukej  
 Një revoltë rebele e pakuptimtë,  
 Kujt i shërbente ajo prurje, çfar' synon,  
 Që veç një ëndërr është dhe iluzion?  
 Dhe nga vorbulla jonë, dalë mbi tokë,  
 Ajo puna jonë, punë prej kreshnikësh,  
 Atij i dukej si një ëndërr e kotë;  
 Që të shtyp nën të, e rëndë dhe e qetë.  
 Si lojë fëmijësh ai e shikonte  
 Rebelimin ton', betejën që gjëmonte, –  
 Dhe kudo ku jetë po ndërtojnë tani –  
 Ai shikon veç vdekje dhe fatkeqësi.  
 Dhe forca, forca jonë e porsalindur,

Vrulli ynë vigan që jetën gjallëron,  
Atij i dukej veç një hordhi e errët,  
Një hordhi rrënuese, që veç shkatërro.  
Dhe në këtë botën tonë Nairiane  
Përballja jon' me atë botën e vjetër –  
Atij i dukej ndodhi e pavërtetë,  
Pë të një çast i turbullt, i ngatërruar,  
Siç ndodh kur zgjohesh nga një gjum' i rënduar.  
Dhe ai thoshte: - Përjetë, deri në varr  
Atë kujtim do ta vajtojë si i marr',  
Dhe ditë të shndritshme kurrë s'do të vijnë  
As në shpirtin tënd dhe as në këtë botë.  
E shkuara s'ish kujtim i kësaj bote,  
Në shpirtin e mplakur, e ardhmja – gënjeshtër,  
Dhe si këngëtar i ëndrrave të vjetra,  
Veten e kujtonte për një Nazon të ri,  
Trubador, që larg tokës së tij amtare,  
I syrgjynosur, bridhte pa fund, pa njeri. –

## V

Dhe e dëgjoja atë ashtu i qetë,  
Dhe unë mbyllja sytë atëhere kur –  
Shfaqej dikush duke kënduar një këngë,  
Që është e vjetër, si vajtim i trishtë  
I këmbanave të atyre ditëve,  
Kur një kishë e lashtë Nairiane  
Bujarisht përhapte ëmbël përmbi tokë  
“Bekimin” e saj dhe “lajmin e Mirosjes ...”.  
Përballë më hapej një kube e errët,  
Ku dielli, si në fije teli varur  
Ndriçonte qytete dhe fshatra mbuluar  
Nga tym i zi dhe vdekja asfiksuese.

At' bot' pikëllimi dhe helmi mbulonte,  
 Atje vetëm myshku dukej se gjallonte;  
 Atje fajdexhiu dhe prifti jetonte,  
 Atje ish dhe kamzhiku, që fshikullonte.  
 Dhe ai përrua i qetë, si në përrall',  
 Që ai e ëndërronte me aq shumë mall –  
 Që kullotat ushqen me ujin që shpërndan,  
 Që aq shumë i donte bariu Hovnan.  
 Fushat e tjera - ... toka të thara fare  
 Dhe në ato fusha – bujku-kafshë barre,  
 Veshur një këmish' të rrjepur dhe baltosur,  
 Shpirtin gjithnjë memec, djegur dhe shkrumbosur.  
 Dhe orën, atë orën në mes të fshatit  
 Që jetës nga sipër si kulloçkë i qëndron  
 Dhe priftin e vjetër dhe tymin e vjetër,  
 Dhe lutjet me zë të Ihsanit me mjekër.  
 Kurse qytetet? ... Këtu tanimë të ngjan,  
 Se ndodhet boshti që gjith' jetën gjallë mban;  
 Të del përpara një Barseh, o një Arsen,  
 Gjysëm tregtar dhe gjysëm bankier e gjen.  
 Ja, ku më del, para meje është ai;  
 Fytyrën e dhjamosur jam duke ja par';  
 Hundën si feçkë derri, një bark të fryrë;  
 Fëmijën e tij në një gjimnaz e dërgon,  
 Plot shtëpi, dyqane të mëdhenj zotëron,  
 Di të hajë mirë, të pijë me masë,  
 E ndërkaq nuk ngopet, më shumë dëshiron  
 Të thithë djersën e turmave të pa fund,  
 Të të shumëvuajturve, që në botë  
 Veç punojnë, punojnë, lodhen dhe s'pushojn'.  
 Ja, kush është boshti. – Dhe ndërkaq përreth saj,  
 Ashtu si hëna rreth e rrotull tokës vjen, –  
 Rrotullohet dhe jeta Nairiane  
 Duke u kënaqur me shkëlqimin e saj ..

Me fjalën e tij të urtë dhe plot shije,  
Dhe nëpër lëvizjen e gishtave të tij –  
Prej Ujit të Bekuar deri tek Pashkët –  
Aty rrethrotullohet jeta e “kombit”.  
Aty rrethrotullohen librat, fletoret,  
Vijn’ përqark shkolla, teatri edhe kisha,  
Zotërinj, karroca plot, shilte dhe kuaj,  
Kujdestarë dhe rrogëtarë të çdo lloj.  
Rrethrotullohen aty predikatorë,  
Që sipas rrethanës, vendit edhe kohës  
Mund të jenë avokatë ose shkrues,  
Mund të jen’ drejtues, ose redaktorë.  
Ata janë udha, dhe kripa e jetës,  
Ata janë shkëlqimi i asaj bote,  
Ku që nga lart dallon, “diellon’ një “Armen”,  
Është gjysëm tregtar dhe gjysëm bankier.  
Ai është sipër, sipër, si një diell,  
Kështu e miklojn’ ata, e mburrin atë,  
Dhe ai, bujar, derdh pa kursim përmbi ta  
Mirësinë e tij, shkëlqimin e zjarrtë.  
Dhe ai atyre u ngjan vetë ligji,  
I përjetshëm mbi tok’, ashtu si dielli,  
Që dhuron ditët e kthjellta dhe plot shkëlqim  
Që u falte edhe dritën, edhe jetën. -  
Ja dhe iluzioni, thjesht optimizëm,  
Që si ëndërr përkundej në shpirtin e tij;  
Ndoshta kjo botë dukej “pak” si e errët,  
Por ... “e pastër ish dhe Nairiane”.  
Kjo jetë atij i dukej e lavdishme,  
Një parajsë plot me kujtime të ëmbla.  
Dhe ishte kjo, pikërisht, kjo ish, që ai  
Një fat jashtëtokësor po llogariste ..

## VI

... Dhe po i tregoja unë atij, se si  
 Po shndrohej toka jonë papushim tani,  
 Dhe çfarë fuqish tashmë janë çliruar  
 N'atë botë që ai kish ëndërruar.  
 Dhe i tregoja për kopshtin tonë të madh  
 Dhe mëngjesin e vërtet' që me gaz të zgjon,  
 Dhe atë, që shpirti me dëshir' ma këndon,  
 Dhe atë, që është e re dhe po afron.  
 Dhe po i thoja; - Në tokë, diku larg,  
 Ku bota jonë është sovjetike,  
 Tashmë një jetë e re po lind për ne  
 Dhe një tjetër betejë tani po vlon.  
 Që atë, që ish e errët, e padukshme,  
 Dhe që fshihej prej kohësh brenda në mjegull –  
 Tashmë e ka shndërruar në një top të zjarrtë  
 Dhe jetën ndez, si t'ishte diell i artë.  
 Që ashtu si përmbytja vjen në pranverë  
 Dhe zinxhirët e dimrit krejt i shkatërrojnë –  
 Ashtu ajo stuhi e largët, uragan,  
 Gjëmoi në këtë të zbrastën botën ton'.  
 Ashtu si minerali kur del mbi tokë  
 Sipërfaqet nga cipa ngjyrë ndryshojnë,  
 Forca të tjera nga poshtë po kërkojnë  
 Sipër të ngjiten, nën diell të qëndrojnë, -  
 Ashtu edhe stuhia e kuqe flakë,  
 Që "Tetor" ka filluar të quhet tani  
 Solli në tokën tonë një zhvillim të ri  
 Dhe botë të reja para nesh shpalosi.  
 Dhe ajo botë, ajo forca e jonë;  
 Oh, ndryshe është, e paparë më parë;  
 Dhe që ajo të vinte, duhej më parë  
 E vjetra e mbetur pastruar nga jeta.

Kjo është' një forcë e re, për ju e huaj,  
Gjithnjë gërryese, edhe kundërshtarë,  
Ashtu si përball' drurit – metali i shkrir',  
Ashtu si përball' ujit – grimca e zjarrit.  
Kjo është' ushtria jonë, e dalë nga posht',  
Nga terri pa vesh i asaj botës suaj,  
Që djersën tonë në gur e mur e shndrronte  
Dhe ne na mbetej veç gjaku që kullonte.  
Jeta jon' e errët ish në botën tuaj,  
Bodrum pa der' ish, një dimër pa pranverë.  
Erdhi beteja, i ftohti u largua  
Dhe në vend të dimrit – ne pamë pranverë.  
Neve ditët tona, agim'n e shekullit  
Tashmë prej Tetorit e llogarisim ne;  
Dhe nga dashuria fatkeqe, e pamend,  
S'mendojmë të tërhiqemi ndër male ne. -  
Dhe në zemrat tona – nuk ka vend për qarje;  
Tashmë ne i besojmë jetës që po lind;  
Neve na magjepsin puna dhe beteja  
Edhe lodhja e frytshme që prej punës vjen.  
Nëpër rrugën tënde të asaj far' bote  
Bashkudhëtar nuk ke, i vetëm udhëton –  
Kurse ne jemi shumë, ushtri e pafund  
Që tani pa u trembur ndërton, dhe ndërton  
Botën ton' të re, të shndritshme dhe të madhe.  
Dhe ne themi; - Neve jemi themeli, ne,  
I gjithë jetës dhe njerëzimit mbi dhe!  
E gjithë bota për ne është një atdhe;  
Dhe puna dhe djersa, që sot çlirojmë ne,  
Oh, do t'i dhurojë një botë krejt të re  
Atij, të cilin jeta e ka mallkuar,  
Atij që është' skllav, lakuriq dhe pa shtëpi,  
Atyre që tani pa pushim luftojnë,  
Atyre që tani punojn' të krijojnë  
Një njerëzim të ri pa dhimbje, pa horra ...

\* \* \* \* \*  
 \* \* \* \* \*

Kënga jonë – ja, kjo është!; dhe ne tani  
 Në botën tonë boshe Nairiane  
 Kemi sjellë forcë, vrull, dhe vullnet të ri,  
 Me qëllim që jetën n'at' bot' ku jetoni,  
 Që ju po e prishni, po e asgjësoni,  
 Ta rindërtojm' dhe ta rilindim përsëri. –  
 Dhe të panumërt jemi, shumë jemi ne,  
 Në tokën tonë jemi, kudo jemi ne,  
 Dhe nga dashuria fatkeqe, e pamend,  
 S'mendojmë të tërhiqemi ndër male ne.  
 Tashmë prej lëkurës sonë po dalim ne,  
 Tashmë të lodhur, pa gjum' po rënkojmë ne,  
 Që kumbimi i zërit tonë të çmendur,  
 Në Kilovatë dhe Volt të shndrrohet për ne.  
 Atje ku fusha ish e shkretë, ku s'kish jet',  
 Ku veç thatësir' kish dhe zjarr vdekjeprurës,  
 Tani ujësjellësin ne po ndërtojmë  
 Që edhe këto fusha ne t'i prarojmë.  
 Atje, ku fladi lehtë të fshikullonte,  
 Ku dëshiroje që i lir' të jetoje –  
 Tashmë fabrika ne kemi ndërtuar,  
 Me makineri që jan' duke punuar.  
 Dhe çdo kilovat që atje është' prodhuar,  
 Dhe çdo volt që atje është numëruar,  
 Oh, ata voltë janë zëri i jetës  
 Dhe kilovatët figur' e botës janë.  
 Oh, në fushat tona të thara, pa ujë,  
 Ku quhej triumf lëvizja e karrocës,  
 Ushtria jon' e re prej burgjeve e dal',  
 Atje tani dëgjon makinën kur kalon.  
 Kur oxhaku furnnaltës nxjerr tym atje lart

Dhe shpërndan at' shkëndi që si zjarr xixëllon',  
Ajo është panxha, putra jon' e hekurt  
Që at' botën tuaj të vjetër shkatërron ...  
Atje, rreth nesh ende vazhdon e përkundet  
Moçali i ndotur i thashethemeve;  
Dhe sa vjet akoma do vazhdoni, sa vjet  
Mendoni se vrullin ton' do ta frenoni?  
Kujton se nga e jotja ëndërr e vjetër,  
Plot kujtime t'buk'ra, atje nuk ka gjë më?  
Oh, jo! – Qëndrojmë tanimë ballpërballë  
Në tokën tonë akoma – ne, dy botë.  
Dhe e vjetra, e vjetra – ende ekziston.  
Vjersha jote – akoma, akoma është!  
Dhe bëhet ajo e gjatë, e gjat' pa fund,  
Për sa koh' të vjetrën s'kemi shkatërruar.  
Fryma jote atje vazhdon të jetojë,  
Dikush këngën tënde vazhdon ta këndojë,  
Për aq koh' sa në jetën ton' do qëndrojnë  
Iluzioni – ky kopshti yt poetik.  
Dhe është, është, është ai tanimë,  
Është kopshti yt dhe çifti i plepave,  
Që makinerisë tonë, ballpërballë,  
Në këtë duel tani i kanë dalë.  
Dhe kjo luft' që zhvillohet pa zhurm', e shurdhët,  
Ky duel i këtyre ditëve tona,  
Oh, është' akoma edhe më shqetësues,  
Se barrikatad e zhurmshme të Tetorit ...  
Oh, bota juaj – ende ekziston, ende,  
Akoma e ulur qëndron, mbërthyer fort,  
Dhe këngët e tua kënduar deri dje  
Akoma shumica kanë ndikim atje.  
Por ajo bot' me vdekje është dënuar,  
Dhe myshku i jetës, dhe llumi i pafund  
I kopshtit tënd, nga përroi jan' rrethuar

Dhe herë rezistojn', herë jan' larguar.  
 Kur llamba elektrike të mposhtë terrin  
 N'ato kasolle zhytur në errësirë  
 Kjo është lufta jonë përball të zbratzës  
 Botës suaj të varfër Nairiane.  
 Dhe kazma jonë, që dhe malet shkatërron,  
 Tunele të gjat' tejpertej duke shpuar –  
 Ajo pa pushim jo veç malet shkatërron,  
 Por dhe botën tuaj nga frika pushtuar.  
 Shkatërron, shkatërron ajo pa pushuar,  
 Duke shembur kështjellat me gur ndërtuar  
 Dhe thërret në jetë breza të rinj, të gjall'  
 Dhe ushtri të reja duke nxjerrë në ball'.  
 Dhe po dalin, po dalin ata përditë,  
 Dhe sa vjen e shtohen nga dita me ditë;  
 Ashtu si metali nga fundi i tokës,  
 Ashtu si përrenjtë e vrullshëm në pranver'.  
 - Ajo është vorbulla jonë puntore,  
 Që po rrjedh – po vjen gjithnjë më e fuqishme,  
 Që peshën e rënd' të kësaj lufte nesër  
 Me shpatullat e saj të gjera ta mbajë.  
 Dhe ja, po vijnë, po vijnë ata tani  
 Me buçima të mprehta tokën e mbulojn',  
 Dhe për më tepër këngët tona, gjithashtu,  
 Plot entuziazëm, të forta tingëllojn'.  
 Po dridhet toka nga kjo ngjarje e pa par'  
 Dhe nga ky entuziazëm, kjo energji,  
 Dhe e ardhmja jonë që shkëlqen porsì zjarr  
 Tani hapet qartë para syve të mi ...

VII

Sa shumë e shndritshme duket kjo e ardhme! ...  
Parashoh se si nesër, njomur plot me ves'  
Kjo toka jonë e madhe sovjetike  
Do na shpaloset para syve një mëngjes.  
Ja, tani plot fshatra dhe qytete të rinj,  
Lidhur mes tyre me rrjet' hekurudhore,  
Dhe e përditshmja jon' tani që me mëngjes  
Mbushur me gëzime dhe hare rinore.  
Ja dhe ndërtimet e reja, shtëpi plot gaz,  
Ku dritë ka, dritë ka, dritë ka pa mas'  
Aq shumë! ...  
S'ka më tani kasolle Nairiane,  
Ku drita madhështi ish, nëqoftëse kish.  
Dhe shekuj pa fund dhe vite të panumërt  
Porsi një insekt kish jetuar njeriu,  
Ku një zot i keq nga lart qiellit zbritur  
Bekonte atë jetë gri të zvenitur ...  
Por ja doli jeta nga gjumi të zgjohej,  
Po gumëzhin dheu nga korrja e drithit;  
Dhe përqark, përqark, rreth e qark kësaj toke –  
Bota e madhe është, mure ndarëse s'ka.  
Një fushë miqësore është kjo botë  
Kjo bot' është' juaja, ashtu edhe djersa ...  
Kudo përqark jetojnë njerëz në paqe,  
Paqe vëllazërore dhe të përjetshme.  
Dhe ja njeriu, njeriu që prej kohësh  
Nga plagët e vjetra trupin ka shëruar;  
Ja dhe shikimi, shpirti i tij - i qetë,  
Dhe çapi i tij – i sigurtë në jetë ...

\* \* \* \* \*  
 \* \* \* \* \*

Ja dhe iluzioni yn' i pakufi,  
 Ëndrra jon', mjeshtër. Për të do mund të thoshe,  
 Kjo ëndërr është ëndërr e atij lloji,  
 Sa që nuk tregohet dot me llafe boshe,  
 Për të cilat oh, shekuj, shekuj me rradhë –  
 Ne kemi luftuar dhe kemi luftuar.  
 Dhe vazhdojmë të luftojmë. – Ndonëse ti  
 Në këtë ëndërr tonën nuk ke besuar.  
 Ti qëndron këtu veç duke ëndërruar  
 Përroin e qetë, kopshtin e shurdhuar,  
 Ku rri një qingj i urtë, që veç blegëron;  
 Ndërkaq ajo këngë – nuk është kënga jon' ...

### VIII

Dhe dëgjo, dëgjo, dëgjo me kujdes mjeshtër,  
 Për atë që shkoi më kot ti ëndërron  
 Është e kot', e kotë shpirtin ta dehësh  
 Me ëndërr të kot', ëndërr që nuk ngushëllon.  
 Më kot tërbohet ky shpirti yt ziliqar  
 Përballë tokës sonë që tash po rilind;  
 Toka jonë nuk është Roma e shturur  
 Dhe vetë ajo – s'është një Nazon i ri.  
 Rob i errësirës, i gënjeshtres boshe  
 Ti mallkon forcën tonë të re që po lind. –  
 Ti po largohesh nga ajo forc' të shpëtosh  
 Dhe jo prej atyre, dhe jo nga mbretërit.  
 Dhe nëqoftëse vjen në vendin tonë ti  
 Dhe vazhdon të mbetesh po i njëjti njeri  
 Nuk do i ledhatoj' Dielli yn' i ri

Ato këngët postmortore që këndon ti.  
Akoma të pranon ajo bot' e vjetër,  
Që vazhdon të përtypë myshk edhe morra,  
Por ai diell dimëror i pafuqi  
Si zor ta ngrohë atë shpirtin tënd tani.  
Do mbetesh i trishtuar dhe i plakur ti,  
Dhe në shpirtin tënd të ftoht' dimri po ai  
Dhe i pashpresë dhe jetim do mbetesh ti  
Si në këtë Venedikun e largët, ti ...

## KAPEDAN SHAVARSHI

### I

Në rrug' qetësi, errësir' e thellë ish,  
Mëngjesi pranë ish, por ende zbardhur s'kish;  
Ndërsa në bujtinë kryetar Shavarshi  
Pinte, pinte pa pushim, me mllef mbushur ish.  
Kapedan Shavarshi. – Një burrë krenar ish.  
Në fytyrë, një të çarë kame kishte,  
Që fytyrës së tij i jepte zbukurim,  
Ca më shumë, kur me nerv dhe pak i pir' ishte.  
Ajo e çarë – dhe mustaqet. – Të verdha,  
Kaçurrel, dy tufa të zjarrta, dy përrenj,  
Që, rëndë, rëndë mbi nofulla i zbrisnin  
I jepnin pamjen e një “trimi të çartur”.  
Dhe sytë e errët, gjak në drit' të syrit,  
Dhe vetullat si një shuk i trashë qimesh ...  
E mbante veten – për mashkull të pamposhtshëm,  
Mrekulli, dal' nga soji mbretëror Armen.  
Shavarshi vazhdonte pinte. – I pa fjalë,  
Në krye të tryezës, si re e rëndë;  
Pinte, dhe pas çdo gote të boshatisur  
Sa vinte bëhej akoma më i ngrysur.  
Shavarshi s'ish vetëm. – Pranë tij qëndronin

Luftëtarë trima, shokë dhe në pije  
Në famën e kreut të tyre besonin,  
Pinin, pinin pa fund – dhe këngë këndonin.  
Jegor i Igdirit, i Karsit Haroni,  
David i Mushehut, Haçak nga Sakoni,  
Prej të cilëve dikur trembej vet' – Droni,  
Që sot i kish thirrur që herët me mëngjes.  
I kish kërkuar, në gjashtë të mëngjesit  
Shavarshi me çetën pranë tij të vinte;  
E dinin, që detyrë do t'u ngarkonte, -  
Ndërkohë Shavarshi - të pinte vazhdonte.  
Ngrysur rri Shavarshi. Një dyshim i errët  
Si brirët e dhis' i shponte atij zemrën;  
Në krye të tryezës, si re e errët,  
Pinte pa pushim dhe vështrimi – i vrerët.  
I kish thirrur Droni në gjashtë të mëngjesit;  
Mendonte Shavarshi, - përse i kish thirrur?  
Një detyr' të rëndësishme kam, – i kish thënë' -  
Dhe e la që nga dyshimi t'ish i prirur  
Ai edhe shpirti i tij. – Përse s'i tha  
Se në çfarë detyre po i dërgonte?  
Në tru i lëvrinin me mijra dyshime;  
Mendonte – të shkonte apo të mos shkonte?  
I zihej besë Dronit? Po? Kush e njihte?  
Ish i zoti për mijra tradhtira. Droni.  
Është e vështirë të grindesh me atë.  
Nëse jo për respekt – do ta bësh prej zorit.  
Di të hakmerret. – A nuk ishte vallë dje,  
Që Shavarshin kërcënoi me shkatërrim?  
Përse? – Sidoqoftë duhej kujdes me të,  
Vrasjet ndaj armenëve ishin në veprim.  
Të ashtuquajturat masakrat Ruse.-  
Djema të kollarisur,  
Duart në doreza, në fytyra – pudër.

Nuk kanë parë armë, as edhe grindje. –  
 Veç vajza lakuriq kanë parë ata ...  
 Dhe pikërisht ata, ata çapaçula,  
 Të aftë veç në banjo të shkojnë pa njeri –  
 Duan, që në duart e tyre në vegla  
 Kapedanët trima të shndërrohen tani.  
 Duan të zotërojnë tokën, ushtrinë,  
 Siç mëson shkolla të bëjnë qeverinë;  
 Por si mund të lejojë t'i hypin përmbi?  
 Grua është, apo mace ai ?...  
 Kurse Droni, ky kapedan i Izdirit  
 Që mbahet hero prej shpirtit të patrembur  
 Droni – bashkë me ta është  
 Dhe dëshiron të bëhet ministër.  
 Ministër i luftës. – Mirë! Mirë!  
 Po pastaj? Çfarë do të bëjë më pas ai?  
 Dhe nëse, u bë ministër –  
 Ka mundësi të japë gjithë sekretet.  
 Ka mundësi të mbledhë gjithë Izdirët,  
 T'i kapë të gjith' ata, t'i çarmatosë,  
 T'i asgjësojë, trupat qenve t'ua hedhë,  
 Që shtabi i tij të marrë gjith' fuqitë ...  
 Shavarshit në kok' mendimet j'u bënë lëmsh;  
 Koka j'u rëndua; mbushi gotën, piu.  
 Në shpirt një dyshim i shurdhër që e brente  
 Sa vinte shtohet, përbrenda e gryente.  
 Por, Droni – ish mbret. – Jo më larg se dje  
 Ai vrau dy prej djemve të tij,  
 Pasi, të pirë, i kishin pështyrë,  
 Mu përpara tij dikujt në fytyrë.  
 E zbritën nga karroca, dhe e pështynë;  
 Pastaj na doli, që ministër na kish qen' ...  
 Ata djem - të pirë fare kishin qenë;  
 Dhe për të pirin – ministër, e çfar' pastaj?

E pështynë dhe në karrocë i hypën,  
Në karrocën e ministrit, - o Zot, mallkim!...  
Por nuk u bë qameti, nuk u prish bota;  
Se mos ministri botën kishte shpëtuar? ...  
Por nuk ish kështu, në të vërtetë Droni  
Ish ndjerë i poshtëruar, i çnderuar;  
Në mirëbesim, në polici i thirri –  
Ashtu si s'i ka hije burrit të veprojt'.  
Pastaj edhe gratë e tyre i thirri;  
Erdhën edhe fëmijët, - pastaj qetësisht  
I kishin nxjerrë ata prej dhomave jasht'  
Dhe pas shpine u kishin qëlluar ... Vetëm  
Në prani të njëfarë burri të pirë ...  
Hesht e mos u ndiej. Sekret. Asnjë fjalë.  
Ku i dihet Dronit? ... Për çfarë kushedi,  
Na mbledh që pa gdhirë kështu në fshehtësi? ...  
Njeri – Tefiku ish, vëlla i Jegorit,  
Jegori e fal Dronin? – Jo. –  
Tashmë ulur pranë tij – pinte pa pushim  
Dhe ashtu i pir', puthte shokun pranë tij –  
Haronin e Karsit. – Mirë! Mirë!  
Jegori sidoqoft' njeriu i tij është'.  
Gati-gati e kishte si vëlla, hallall;  
Po kështu edhe kur grinden.  
Hej, ky ministri yt ... Ky Droni yt.  
Hej ky kapedan trim ...  
Tryezën goditi fort me grusht Shavarshi –  
Toka u drodh.  
Goditi dhe piu. Përsëri. I ngrysur.  
Dhe asnjë fjalë nuk nxorri. Kokën  
E rëndë, mbështeti mbi duart mbledhur grusht;  
Ashtu i palëvizur – mbeti. Përqark gumëzhinte.  
Haçaku këndonte. – Vajtim ish apo këng'?  
Turqisht, ajo që Shavarshi dëgjonte, - kur?

Mbi kok' një mjegull e dendur i rëndonte;  
 Në shpirt dyshimi akoma i çukiste.  
 Donte të ngrihej, at' bukë të pështynte,  
 Bukën prej tij ngrën'; - tryezën ta përmbyste. -  
 Tashmë po afrohej agimi dhe ndërkohë;  
 Ai vazhdonte të vuante, nuk dinte,  
 Vërtet ta zbatonte urdhërin e Dronit?  
 Deshi dhjetëshen ta nxjerrë, t'i japë zjarr,  
 Por e frenoi veten; u mendua ca.  
 Fundi i fundit brekë burrash veshur ka,  
 Në vena – gjak ka, s'është kos – vetes i tha.  
 Dhe nëse Droni është mbret. – Qoft' me shëndet!  
 Por këtu ai burrë nuk mund të bënte  
 Çfar' t'i thoshte mendja, çfar' të dëshironte. –  
 Por mbase? – e bën kurdi i Shavarshit? –  
 Shavarshi u kujtua. - Kurdi ish bashk' me të;  
 Në tru ju hap një diskutim i madh -  
 Ecnin nëpër fshat... mjegull... natë pa yje...  
 Angullima e qenve të shqetësuar...  
 Përpara – gjëja e gjallë, bagëtia,  
 Marr' nga fshatrat armene, turke, dhunuar.  
 Në fshatra kish rënë këmban' e mënxyrës;  
 Mbulesën nga koka fshati kish larguar ...  
 Tundeshin karrocat, kuajt turfullonin.  
 Nëpër karroca – fëmijë, gra, ngarkuar...  
 Mjegulla po tretej ngadal', porsi zefir,  
 Trokëllima e kuajve porsi këngë...  
 Përpara - gjëja e gjallë, nga pas – kurdi,  
 Kurdi i Shavarshit; - Turma,  
 Të cilat i kish dëbuar –  
 Shkulmi i luftës –  
 Dhe shpërndarë nëpër botë.  
 Shumica prej tyre kish humbur shtëpinë, vendin,  
 Familje, fëmij', nënë, baba, dhe tani -

Të gatshëm ishin të shkatërronin gjithçka  
Për një kal' të mir' apo një thes me miell.  
Kush mund t'i përballonte, kushdo mund të ish;  
Rus, turk, armen – a nuk është e njëjta gjë?  
Vetëm që gruaja urie të mos vdes' –  
Vetëm që fëmijës fryma të mos i mbes'.  
Nga Hnusiku – në Alashkert. Pastaj Karsi.  
Ftohtë dhe uri, tifo lakuriqësi.  
Sa shumë, sa shumë vdiqën,  
Nga uria ose s'u kthyen nga fronti.  
E gjithë rruga mbushur – kufoma, vdekje.  
Kush mbeti, mbeti. Më së fundi mbërritën  
N'atë tokën ruse, për të cilën ata  
Kishin derdhur kaq shumë gjak...  
Erdhën. U derdhën gjysëm lakuriq. Dhe çfar'?:  
Mbetën në tokë, krejt në qiell të hapur,  
Nga prapa i ftohti, nga para uria –  
As edhe një ndihmë, asgjë prej gjëje.  
“Vëllezërit ruso-armenë”... Ha – ha...  
I pritën – më keq se turqit, po, e vërtet!  
“Vëllezërit ruso-armenë”... “Atdhe”, “Armen”,  
Të ngopur veshët kësisoj, të sigurtë.  
Por përse i pritën aq keq, përse aq keq,  
Si të huaj, si armiq, si për mëshirë;  
Vall', armenët jan' të paturpshëm, hileqar', -  
Mendonte Shavarsh – armenët jan' të këqinj,  
Armenë të shndrruar, rusifikuar; - As  
Kan' par' luftë me sy dhe në kohë lufte;  
Dhe kjo s'ishte arësyeja, që  
Të tmerruar porsi bagëtia,  
Ata braktisën frontin, lan' Erzerumin,  
Pastaj Karsin, Alekpolin ..., medet për ju, ...  
Koka e Shavarshit vlonte nga mendimet;  
Shavarshi buzëqeshi hidhur;

Piu; dhe mendimet sërish j'u ngërthyen  
 Me njeri tjetrin më keq, akoma më keq;  
 Vetëm Haçaku vazhdonte të këndonte,  
 Dhe hidhërimi rridhte butë, notonte...  
 Dhe papritur Shavarshi - aq shpejt -  
 A thua ish njeri, a thua kafshë ish -  
 U përmend; - mëngjesi kish zbardhur, i freskët, -  
 Kishin rrethuar fshatin e Talinit turk.  
 Tashmë kish tre orë - që luftonin;  
 E kishin rrethuar fshatin nga të katër anët;  
 Ishte një agim i heshtur, kur  
 Fshati u zgjua papritur nga një tym i dendur;  
 Natën djemtë e Shavarshit  
 Zjarr i kishin vën' një fshati të vjetër - dhe tani  
 Nga të katër anët ata u vërsulën brenda,  
 Duke shpërndarë përreth tyre tmerr, vdekje, vdekje.  
 Zhurmë, krisma, qarje, trokitje thundrrash,  
 Vetë, qëndruar mbi kal', në dorë mauzerin,  
 Papahan pjerrët ul mbi sy, me një dorë  
 Kapur fort në jelen e kalit, ecte ngadalë...  
 Dhe papritur... ngriu kali i Shavarshit; Çfarë?  
 Çfarë mrekullie e çuditshme, Shavarsh!...  
 Nga dera përball' një ëngjëll doli, jo, një grua;  
 Kalin frenoi fort Shavarshi - dhe shtangu.  
 Peri e paraqsës ish, nuk ish grua, jo;  
 Grua të tillë Shavarshi nuk kish parë;  
 Me sy të tmerruar gruaja pa përreth;  
 Sytë të zinj i kish, të zinj dhe të pastër.  
 Flokët e zinj derdhur mbi supe, gjoksi i hapur,  
 Alabastër, bardhë si dëbora  
 Shkëlqente gjoksi i saj, si dritë e agimit  
 Në horizont, kur davaritet mjegulla.  
 Shavarshi kish frenuar kalin, ish shtangur;  
 Pamja ishte prekëse, mbuluar

Me copë lëkure të zez', kali ndën të,  
Ngritur frikshëm lart mbi dy këmbët e pasme,  
Përplaste një këmbë mbi tokë, tërbonte,  
Nga sytë zjarr, shkrepëtim', shkëndija, tym lëshonte;  
Shavarshi e dëgjoji hingëllimën e kali,  
Dhe u ngreros, fryu gjoksin, fryu, fryu, fryu...  
Pamja ish e mrekullueshme; Vetë – i mrekulluar,  
Përpara tij një grua shtat'hedhur, si shenjti Gjergj;  
Dhe sytë e gruas - mbushur me tmerr,  
Sy të zinj si nata. Dhe të dukej se ish - iluzion.  
Ishte veç një çast, që zgjati gjatë,  
Si një shekull. – Shavarshi për një çast  
Desh t'i zbriste kalit, ta linte të lirë,  
Duka pasur frikë, se gruaja zhdukej,  
I ikën nga sytë, ç'bëhet, avullohet,  
Në mjegull pranverore, re, vesë shndrrohet –  
Dhe mbetet vetëm ai dhe kali i tij,  
Në mes të fshatit që ulëret nga tmerri. –  
Por ndodhi çuditërisht papritur, pa kuptuar,  
Një gjë e çuditshme; - Gruaja, duke gulçuar,  
Si një shkumë e bardhë, si një dallgë e bardhë –  
U shemb në tok', para kalit të Shavarshit u shtri; -  
“Mëshirë” – i thirri gruaja; - “Mëshirë o trim,  
Fati të zgjodhi të jesh trimi im, më merr mua,  
Unë të dua ty, Armeni im, Armeni trim”  
Zëri rrodhi i pastër, i kthjellët si burimi, ...  
Çfar' ishte vallë kjo? – kllapi, ethe ëndërrimi?  
(I përmytur nga djersët, kali  
Lëpinte buzët e hapura  
Dhe me zor i bindej frerëve);  
Kur papritmas përballë, nga kasollja përballë  
Jashtë saj një ushtarak doli, në dor' një kamë, -  
Pastaj kujtonte Shavarshi një klithmë të tmerrshme;  
Pastaj mjegull, mjegull, mjegull...

- S'e jap, - briti ushtaraku, - s'e jap, Shavarsh, imja është; -  
 Nga duart e mia më iku bushtra e qenit...  
 I ngrysur ra përmbys, - dhe shkëlqeu kama,  
 Dhe Shavarshi ju duk, se ishte i pirë. -  
 Dhe kujton Shavarshi – gruan e plagosur, pranë,  
 Rrokullisur dhe zhytur ish mbi gjakun e saj – dhe –  
 Shkëlqimin e mauzerit të tij, shkëlqim'n e tij,  
 Dhe kufomën e ushtarit – para kalit të tij...

\* \* \* \* \*  
 \* \* \* \* \*

Po kjo ç'ishte, ç'ishte kjo, ç'ishte, ëndërr ishte, iluzion, alucinacion?  
 Si i marrë, mbi trupat e tyre, ngau kalin e tij,  
 Dogji, shpartalloi, rrëzoi, rrënoi, rrënoi,  
 E ktheu fshatin në një fushë me të korra të përgjakura.  
 Shpartalloi, pa pyetur në ishin pleq, gra, vajza, fëmijë, -  
 Deri në mbrëmje vonë, deri në mbrëmje vonë vrau, preu;  
 Pas kësaj hëna dukej sikur në gjak notonte,  
 Kurse fshati i ngjante një kufome, lidhur pas yzengjive të kalit të tij.  
 Në tru kish mjegull – e kuqe, ngjyrë alle, dehur me gjak,  
 Në tru i digjej trupi i gruas turke, siç djeg një plag',  
 Pastaj u deh Shavarshi; dhe ujku dehet me gjak,  
 Kurse Shavarshi – ishte një ujku, që kish humbur një femër –  
 Një të bardhë, të pastër, të mrekullueshme, një zemër ...

Shavarshi

Grushtin e përplasi mbi tryezë, piu, dhe kur  
 Fshiu mustaqet me grusht – u kujtua për jelen kalit,  
 Ndërkohë Haçaku vazhdonte këndonte.

II

Tashmë nëpër rrugë po shpërndahej errësira,  
Po afrohej mëngjesi, mëngjes i turbullt pa mas', -  
Ndërsa kapedan Shavarshi  
Vazhdonte të pinte, pinte i mbushur me maraz.  
Djemtë ishin pirë. – Tatiku,  
Kish përqaftuar si një dashnor Haronin,  
Duke e puthur atë me qindra herë –  
Kurse Jegori ish duke sharë Dronin.  
Ndërkoh' Shavarshi mendonte. – Filli i mendimit,  
Që prej këngës së Haçakut ishte ngatërruar,  
Duke i sjell' ndërmend kujtimet, jetën e shkuar,  
Përsëri tek Droni dukej se kish përfunduar.  
Tashmë mëngjesi dukej se po zbardhte; – tashmë  
Si një bojë e kuqe e hapur mbi Jerevan  
Derdhej mëngjesi i turbullt dhe i mjegulluar –  
Dhe sharjet e Jegorit e përshëndesnin atë,  
Vetëm ato sharje: Në qytet akoma flinin  
Flinin një gjumë të thellë, gjumë të trazuar,  
Dhe vetë mëngjesi ishte një zgjim i sforcuar,  
Që zbriste sërish nga shtrati i pa qetësuar.  
Qyteti ende flinte rëndë, i heshtur, memec,  
Vetëm aty poshtë, para bujtinës, në rrugë  
Një zë gruaje, fëmije apo shërbyese  
Çirrej dhe dukej sikur sharronte ajrin -  
Shavarshi mendohej; Duhej të vendoste menjëherë  
Duhej të shkonte, a të mos shkonte; kishin mbetur  
Vetëm dy orë. – Dhe ai vendosi; -  
Ai do të ikë, por vetëm ai; dhe çeta,  
E tëra, do ta priste e gatshme jasht' qytetit,  
Të qëndrojë e fshehur pranë vreshtave, pastaj –  
Pastaj të bëhet e gjallë. Vetëm katër ushtar'  
Do të vinë bashkë me të që me mëngjes; -

Jegori, Haçaku, Davidi, Haroni;  
 Për momentin – janë mjaftueshëm; Po të dojë  
 Le të sulmojë Droni!; -  
 Por kush është vall' ... dora e tij... truproja...  
 Kush mund ta ndalojë? Është e mundur papritmas  
 Të asgjësojë këtë apo atë prej djemve?  
 Rrotulloi Shavarshi sytë e mjegulluar –  
 Solli ndër mend atë pamje të përgjakur  
 Në prag të godinës së policisë, në rërë,  
 Pranë njeri tjetrit rënë - dy kufoma;  
 Tefiku nga Izdiri, pran' tij Agasi,  
 Të heshtur, përlyer me gjak; vetëm  
 Mbi zverk – ca plagë të vogla;  
 Me zor u dukeshin nga kurrizi... Ashtu! –  
 Mbi mauzer vendosi  
 Dorën e tij Shavarshi;  
 Gjaku i hipi në kokë –  
 E dehu...

\* \* \* \* \*  
 \* \* \* \* \*

Erë s'ish ajo që rrugës vërshëllente,  
 Por as dhe predhë që errësirën çponte;  
 Bashk' me djemt' e tij në at' bujtin' tërbonte,  
 Pinte Shavarshi, pinte dhe turfullonte.  
 Ish ai çast, kur dorën çoi tek mauzeri,  
 E nxorri, e tërhoqi; - dhe atë mëngjes herët  
 Ndjellakeq, me ashpërsi këndoi mauzeri  
 Këngën e gjakut, mjegullës, vdekjes dhe shfarrosjes...  
 Pastaj të tjerët atij i mbajtën ison,  
 Jegori, Tatiku, Haçaku dhe Sakon, -  
 Dhe qyteti, i boshatisur, që ende gjumë flinte  
 U zgjua i shatisur nga zhurma e armës që shtinte.  
 Si përçartja e kllapisë së të sëmurit me tifo,

Si zhurma mëngjesore që i paraprin tmerrit  
Duke skicuar tinguj shqetësues;  
Ashtu dëgjohej simfonia e mauzerit.  
Qëllonin edhe djemtë – por nga dritaret;  
Pranë njeri tjetrit qëndruar, vështrimet nga agimi;  
Plumbat fluturonin batore nga shtëpia në shtëpi,  
N’atë ambient mëngjesor, që si ata i dehur ish.  
N’atë ambient të turbullt mëngjesor, plot mjegull,  
Përmbi qytetin, që si në përçartje jetonte,  
Shpirti i kapedan Shavarshit pezull qëndronte,  
I pirë, i ngrysur, i ashpër, si vetë dimri,  
Që shndrruar në stuhi bore, gjithçka asfiksonte,  
Dhe botën, jetën, gjithçka tjetër – në ethe shndrronte;  
Grupi qëllonte dhe shihte tutje, larg, - në sytë  
U dallohej gjak, mjegull, vdekje, ankth i gjakderdhjes ...  
Shpejt pastaj erdhi Shavarshi; në dor’ mauzeri –  
- Shkojmë, - u bërtiti djemve, - dhe vrik doli jashtë;  
I ngjirur, i doli prej fytit zëri.  
Pastaj – mërmëritje; pastaj –  
- Jegor, - i bërtiti, - më dëgjon?; Droni na kërkon,  
Pran’ vëllezërve në qiell të na dërgoj’ dëshiron, ...  
Dhe mauzer i Shavarshit përsëri gjëmoi –  
Këngën e shkatërrimit, vdekjes, gjakut këndoi.  
I tmerrshëm dukej Shavarshi, me mauzer në dor’,  
Duke u lëkundur, shkonte ai nëpër mjegull;  
Nga pas – djemtë e tij, të gjith’ – me armë në dorë,  
Të gjith’ – ashtu si ai – të pirë. Në rresht të par’  
Çapitej, kërcënues, vetë ai, krah për krah  
Me shokët – ecte; shpirti flakë i kishte marrë;  
Pastaj një dridhje e fortë atë e përfshiu;  
Shpejt koka i erdhi në vend, shpirti ju zbraz –  
Pikërisht atje, në trotuarin e rrugës. – Djemt’  
E kishin kapur dhe e mbanin atë. – Në rrugë,  
Dhe tashmë kënga e mauzerit ishte mekur, –  
Vetëm një gërhimë e rëndë ajrin gërvishte. –

Dikush, rënë aty afër, dukej si i vdekur;  
 Grua ishte, burrë, fëmijë? – nuk dihej ç'ishte,  
 Dhe përse ndaj lindjes së diellit të Nairi  
 Duke gërhitur ishte drejtuar ai fatzi?  
 U qetësua Shavarshi. – Dhe kur,  
 Duke fshirë mustaqet, kaloi para tyre,  
 Dy fëmijë si të lajthitur,  
 Me sy të çaplyer, çakarritur, –  
 Si qen të uritur, që bredhin fushave,  
 Me barqe të fryrë si gratë shtatzëna,  
 Me duar porsì kthetra të vëna  
 U vërsulën mbi të vjellat e Shavarshit,  
 Dhe filluan të lëpijnë makutërisht,  
 Të rënin përmbys në trotuar, qenërisht;  
 Dhe në syt' e tyre dallohej uria,  
 Shtazarake, e pakufishme, uria...

\* \* \* \* \*  
 \* \* \* \* \*

Ecte nëpër rrugë kapedan Shavarshi,  
 Nga pas – vinin djemt', të pirë edhe ata.  
 Tashmë po zgjohej qyteti i përgjumur,  
 Mëngjes i zakonshëm po shndërrohej agimi.  
 Nga dyert njerëzit po dilnin një nga një  
 Ecnin pa folur, në fytyra shqetësim. –  
 Në trotuar, me grupin e tij, Shavarshi  
 Shpërndante rreth vetes frikë, ankth, drithërim.  
 Dhe papritmas – sërish mauzerin nxorri,  
 Të parin që hasi me britma e mori;  
 Shpejt ktheje fytyrën, turirin nga muri,  
 S'e sheh, po eci un' në trotuar – po un'! –  
 Po ecën Shavarshi. – Djemtë të zbavitur  
 Qeshën me të lart', u dallua Haroni, -

Njeriu me të shpejt' u kthye nga muri,  
Dhe kaloi Shavarshi, sytë skuqur - gjak.  
Dhe pastaj – çdo njeri që rrugës takonte  
Urdhër i jepte nga muri të shikonte;  
Në të gjith' fytyrat veç frikë lexonte  
Dhe kjo për të nderim i madh do të thonte;  
Dhe për këtë shkak – tepër krenar ish ai.  
Përgjat' gjithë rrugës që ai përshkoi,  
Për deri sa hasi në një njeri,  
I cili fytyrën ta kthejë nuk denjoi ...  
- Fytyrën, - thirri Shavarshi, - nga muri shpejt,  
Në mos po surratin tënd tani ta shqyej...-  
Por ai njeri i çuditshëm  
Nxorri mauzerin – dhe përballë tij qëndroi.  
Shavarshi u hutua , mos ishte ëndërr, kllapi, -  
Deshi të tërheqë këmbëzën e mauzerit,  
Kur papritur nga pas një dorë e rëndë  
E goditi fort me grusht Shavarshin.  
Shavarshi rënkoi, mbi trotuar u lëshua;  
Rruga ju lëkund para syve, ju errësua;  
Dhe ju duk Shavarshit për një çast, se ai burrë  
Fort ja shtërngoi trurin me një darë hekuri...  
Dhe zërin e mauzerëve të djemve të tij  
Shavarshi s'e dëgjoji më, dhe nuk ndjeu aspak,  
Se si Jegori, papritur - pakuptuar,  
Ra përmbys përmbi të - porsi gur rënduar .  
Nuk pa Shavarshi as atë, se kush më pas,  
Nga të mbeturit e çetës, atë e tërhoqi;  
Atij veç i dukej, se dikush me hekur  
Po i digite veshin.  
Dhe vetëm në shtëpi, kur sytë i hapi,  
Dhe u përmend pak – e kuptoi se kush kish qenë  
Njeriu, të cilin rrugës ja kish sjellë fati;  
Ish kumbari i tij i madh – kapedan Simbati.

## VIZIONI I VDEKJES

### Kujtimet të pavdekshëm të akademikut Tamarian

Sa shumë i ngjan çast i vdekjes kandilit që po shuhet

\* \* \* \* \*  
\* \* \* \* \*

... Kapakët e syve, mbrëmë, kur ashtu ngadalë ju kopsitën –  
Të kapur nga flak' e kaltër e shkëndijës së fundit të trurit,  
Të dukej sikur ai të kish parë një qytet plot me diell ...  
Ja dhe harta e qytetit, që me at' sahatin diellor ngjan,  
Punuar në mermer të pastër në qoshe blu ngjyrosur,  
Sheshe të gjera, rrugica pa fund, plotësisht tendosur,  
Ndërsa në qendër një altar graniti që në qiell kryet mban.  
Në një çast madhështor, që u duk sikur zgjati me shekuj,  
I vërsjuan në tru – në zemër, si shpërthime që ndriçojnë',  
Rreshta kollonash pa fund, tarraca, shkallë të mermerta,  
Dhe lulishte të praruara, shatërvanë që këndojn' ...  
Kulla ngritur lart në qiell dhe qemere të harkuar,  
Korniza gdhendur, dritare me delikates' punuar;  
Dhe mermere me ngjyrë trupi, dhe granit rremba-rremba,  
Dhe gur shtufi plot me lule dhe bazalt i kaltër i latuar ...

\* \* \* \* \*  
\* \* \* \* \*

Drejtoi dorën që i dridhej nga i kaltërti iluzion,  
Aq shumë afër ishte, aq shumë – gati për ta prekur tani –  
Por papritur ju rëndua dora gjeniale dhe e shkathët,  
I ra poshtë – mbi gjoksin e thatë... heshtje. Vdekje.

## PA TITULL

Na ish një kritik. – Dje, me gojën që shkumë i lëshonte,  
Lëvdata më thurte dhe armiqtë e mi shkatërronte,  
Ndërsa sot i bindur është se së shpejti do të vdesë  
Mbi vargjet e tij heroike, duke më lajkatuar.  
Eh, le të vdesë, mbi ç'do lloj vargu që ka dëshiruar,  
Veç – të vdesë...

1919

## MUZËS

Fillimisht, një vajzë e thjeshtë na ishte ti,  
Që përpara më dole në të vështira dit'.  
Kur mbi kokën time binte një i lehtë shi,  
Dhe në jetën time nuk kishte zjarr të shenjtë,  
Dhe rrallë shkëlqente edhe e hënës drit'.

Më përkëdhele ëmbëlsisht, më ledhatove,  
Si dritë e hënës natën vajzën ledhaton,  
Ëndrrat edhe shpresat e shpirtit më këndove,  
Lira t'u bë e pafuqishme dhe më s'këndon  
Dhe u thye, siç thyhet shelgu kur e rëndon.

Si njeriu që jep shpirt, e zbehtë ishte ti,  
Dhe qepallat s'dinin të qeshnin, të gëzonin;  
Të trishta i kishim ledhatimet un' e ti,  
Si dritë e hënës ish e jotja dashuri,  
E zbehtë, e trishtuar ish, në të s'kish zjarrmi.

E ku ta dija n'ato dit' të trishtueshme,  
Se në venat e tua pa jet', kush e dinte,  
Në ato barrikadat e pakalueshme  
Mbrotur prej grave luftarake të lavdishme  
Gjak i përvëluar heroik të ziente.

Që gjatë ditëve ti do çelësh përsëri,  
Ashtu si lulja ndën diell çel dhe lulëzon,  
Që tër' këngët e lirës tënde deri tani  
Të mbushura paskan qen' veç me trishtim të zi  
Të ditëve të vështira, plot me asfiksi.

Bashk' me mua siç duket do të vdisje dhe ti,  
Prej shiut rraskapitur dhe prej mallit djegur –  
Po të mos kish shkundur ajo furtun' me furi,  
Dhe të mos kishte përcëlluar ajo stuhi  
Fytyrën tënde të pastër, plot zjarr jetësor.

Papritmas u shfaqe me vrull të madh, e hijshme,  
Ti, përpara kopshtit plot me bimë harlisur;  
Mbushur me afshin e ditëve të stuhishme,  
Në dor' borinë e betejës së lavdishme,  
Dhe u ktheve në aq e re dhe e panjohur

Ditët e shkuara, të vjetra, mallkove ti,  
Aq pa zjarr dhe aq të vdekura, aq pa lavdi,  
Dhe, së bashku me predhat lëshuar, me furi,  
Si një amazonë e kuqe, plot energji  
I re boris' për përplasje, për betejë, ti.

Në ato orë e bukur si yll shndrisje ti,  
Si marsh luftarak, dhe e tmerrshme, dhe e hijshme;  
Brenda meje si gaz kënga jote vrullonte,  
Dhe deri larg kjo këng' oshëtinte, kumbonte,  
Posi kënga e fitores së madhërishtme.

Ti ishe e re, vetë rinia ishe ti,  
Në damarët e tu vërshonte gjaku i ri;  
Dhe këndoje ti e qeshur dhe e gëzuar,  
Dhe zëri yt me besim gjithnjë të pashuar –  
Gjëmonte gjatë betejës së paharruar.

Dhe ashtu e re, e qeshur, plot gaz e gëzim,  
Në fushat e zjarrta bashk' me mua kalove,  
Këndove pa u lodhur, këndove pa pushim,  
Këndove pa u shuar, me zell dhe s'ndalove,  
Deri sa beteja pushoi ndër llogore.

Kënga ime, lira ime, gruaja ime,  
Si diell mbuluar nga mjegulla e kohës,  
Ti e sinqertë ishe me mua, si motër,  
Ti ishe e shndritshme dhe e pastër si dritë  
Të pështyva, mbase, në fytyrë një ditë ...

Një natë të errët të tradhtova unë ty,  
Një të dashur të ftohtë vendosa të kërkoj,  
Që ëndrra të hekurta mua të më këndoj'  
Ca këngë pa shpirt dhe pa pasion, dhe mua  
Në një botë të re, të hekurt, të më dërgoj. –

Frymën tënde të shndritshme, të pastër, të gjallë,  
Dëshirova unë me betonin ta ndërroj,  
Dhe shpirtin në një rrotë çeliku ta shndërroj,  
Fytyrën ta kthej pa kthim nga ty, dhe si poet  
I botës pa pasion të shndrrohem, të jetoj.

N'atë vrull të zjarrtë fëminor zgjodha që ti  
Shoqja ime e jetës të ishe, s'e zgjata,  
Dhe kënga m'u shndërrua pa shpirt dhe pa fuqi,  
Dhe në burgun e sendeve unë humbata;  
Dhe kokën ma mbuloi një mjegull e ftohtë.

Dhe, me zemrën thyer nga njeriu dhe toka,  
U enda unë pa shtëpi, edhe pa gjumë,  
Gjaku m'u shndërrua në raki me shije gjaku,  
Dhe zellin dhe mendtë i humba dhe më shumë;  
Dhe pastaj kalova në një rënie pafund.

Në jetën time s'munda unë ta përballoj  
Emrin tënd të shkëlqyer si flamur, dhe kokën  
Një errësirë e pakëndshme ma mbuloi,  
Dhe kuptova që je ti, e dashur e vyer,  
Që më ndjek me dashurinë e pashpërblyer.

Dhe ulëriva un', si kafsha kur jep shpirt,  
Kur vdekjen pranë ndjen dhe nga tmerri ulërin  
Drejt teje zgjata duart unë me përmallim,  
Se malli më pushtoi, i thelli pikëllim,  
Për frymëmarrjen, zjarrin dhe afshin tënd në vlim.

Si ai që jep shpirt, ajër duke kërkuar,  
Kokën vendosur në jastëk me arom' gjaku,  
Ashtu në prak vdekje dhe i djegur prej mallit,  
Me zjarr dhimbjen e shpirtit duke e pastruar,  
Prita rikthimin tënd, mbeta duke shpresuar

Këtu do të rikthehesh ti tani përsëri,  
Nëpërmjet një rruge me shumë vështirësi;  
Me vete në dorë një lirë të rëndë mban,  
Përkrah meje qëndron si më parë, por tani,  
Më e vendosur dhe më kryelartë je ti.

Dhe nuk je aq e shkujdesur dhe e lehtë ti,  
Si ajo Amazon', që kam njohur në rini; -  
Ndonëse me shpirt e palodhur je përsëri,  
Prej kokës tënde kurrë nuk është larguar,  
Porsi fantazëm – një shqetësim i tërbuar.

Tashmë luftë ka rreth teje përsëri  
Dhe më tepër armë do nevojiten,  
Dhe për të gjithë këtë luftë tani  
Armë të reja do të farkëtosh ti.

Dhe duhet akoma më e vendosur të jesh,  
Më e vëmendshme, dhe më tepër kujdes të kesh.

Do këndosh pa u lodhur dhe papushim tani,  
Me fytyrën dhe ballin me djersë njomur ti, -  
Dhe, ashtu si plugu në arën plot me gurë,  
Njeriut të sotëm mendjen do t'ja plugoni,  
Deri sa të vij' ora që në sulm të shkoni.

Dhe kur të vijë ora – përsëri, përsëri,  
Si në të shkuarën grat' komunare dhe ti –  
Me lirën, harpën e shtërngatave në dorë,  
Me këngën madhështore të sulmit në buzë  
Në rradh' bashk' me mua e patrembur do qëndrosh.

Dhe kur të bie, nga zemra ime qëlluar  
Do vdesësh bashkë me mua, buzagaz, e qet';  
Do të ftohet lira jote duke lënguar  
Përpara vdekjes për herë të fundit në jet',  
Përshëndetje të ardhmes duke i dërguar.

# HOMO SAPIENS

## I

Në Qershor të verës së vitit trembëdhjetë,  
Në qytetin e Nairit në një rrugicë të qetë  
Po kalonte, me shqetësimin që i dukej në fytyrë,  
Një djalosh rreth moshës gjashtëmbëdhjetë. –  
Vinte i pakët. Trup mesatar. Shpatullat e ngushta.  
Flokët kaçurrela i kish, ballin e zbehtë.  
Një këmishë sateni të zi mbi trup ngjeshur,  
Të dalë boje, të paktën tre vera veshur.  
Mbi kokë një shapkë shkollari me fije të verdha qepur  
Që tufës me kaçurrela të dendura i rrinte e ngushtë.  
Ai ecte kokëulur, çapitej ngadalë,  
Në ambientin indiferent, porsi një kalë.  
Ai doli nga shtëpia. Ishte mesditë.  
Pak më vonë u duk i jati tek vinte për të drekuar.  
Ai s'e donte të atin.  
Ndërsa për të atin i biri ish kthyer në enigmë.  
Babai. – Kujtoi i zemëruar. – Dje ai,  
Kur vetë u kthye në të ngrysur në shtëpi –  
Uluriu dhe shfryu gjatë. – Pastaj vendosi kushtin,  
T'i nënshtrohej provimit përsëri ose të mos vinte më në shtëpi.  
Djalit ju drodh shpatulla mekanikisht,

Kujtoi shkollën, babain, pamjen e ngrysur, -  
Veten tek qëndronte përpara tij kokëulur,  
Me turp, dhe lot që i rridhnin në fytyrën plot pluhur ...  
E largoi mendjen nga babai, psherëtiu -  
Dhe e la çapitjen. - Vështrimi i tij  
Për një kohë të gjatë u ngul mbi rrugicë. Po flinte.  
Ngjyer me shafranin veror,  
Rrugica ishte përhumbur në gjumin e vet.  
Rrugica... Dy rradhë shtëpi njëkatëshe,  
Te verdha, gri, rozë, përsëri e verdhë.  
Ndërsa në mes traseja. - Me pluhur, e ngushtë,  
Si rrugët fshatareske të sajës.  
Herë-herë kalonin njerëz nga trotuari,  
Ecnin ngadalë dhe hynin nëpër shtëpi.  
Dhe përsëri shkretohej trotuari.  
Zagushi. Pluhur. Qetësi. -  
Rrallë nga ndonjë dritare ose nga ndonjë shtëpi,  
Jashtë dukej për një çast një kokë gruaje,  
Që i thërriste komshijes përkarshi,  
Dhe përsëri rrugica binte në gjumë. Qetësi.  
Djali ecte ngadalë, pa vështruar  
Çfarë kish përçark. - Këmbët mekanikisht  
E çonin atë përpara. - Për të  
Rruga s'kish asgjë për të admiruar.  
Ai po shkonte drejt kopshtit. - Nën sjetull  
Mbante një libër. - Mos u tmerro,  
Lexues. - Mbi kapakun e librit  
Shkruar ish: "HOMO SAPIENS". -

## II

Ai lexoi për një kohë të gjatë ndenjtur në hijen  
 E atij lisi të vjetër, në trungun e së cilës,  
 Verën e vitit të kaluar kish gdhendur me thik'  
 Një dashnor i përvëlur emrin "Arpenik".  
 Ai lexonte i pa shqetësuar, duke i përpirë  
 Faqet, kapitujt. Njera prej faqeve të librit -  
 Titanike, a thua vetëtimë po shkarkonte,  
 Që po ja digjte shpirtin, pasionet e tij.  
 Koka po i ziente. Shpirti po i dridhej.  
 – Dëshironte që të dilte jashtë, të fluturonte; -  
 Me nxitim i kthente fletët  
 Dhe lexonte, lexonte, lexonte.  
 Nuk kish kopësht; Bota për të kish avulluar; -  
 Kopshti në të pavërtet' ishte shndrruar;  
 Kish një grua, kish një njeri të talentuar.  
 Ish veç një botë e trishtuar.  
 Dhe ndodhte të ish një shpirt i pafajshëm. Dhe një tru  
 Akoma i padjallëzuar, i kthjellët, i pastër.  
 Një fëmije të shkretë provincial i qëllonte  
 N'atë qytet të shkretë Nairian të jetonte.  
 Ai vazhdonte të lexonte. Thellohej pa kthim  
 Në vorbullën e ëndërrimeve. – Nga faqet e librit  
 Një burrë vigan atij i shfaqej në përfytyrim,  
 Në shpirtin e të cilit, mendimet, dëshirat  
 Ishin të fuqishme, shkatërrues të gjithçkaje që synon  
 Të jetë më e lartë se ambienti i mjerë që e rrethon,  
 Ashtu si nga moçali duket – Elbrusi, - dhe si një mjegull  
 Ngjyrë rozë në shpirtin e tij tani  
 Po përhapej një pikëllim i pakufi...  
 Ai lexonte si i babëzitur – dhe vazhdonte, me guxim,  
 Tashmë edhe vetë në ato rrugë të "madhërishe".  
 Dhe i dukej sikur në kokën e vet

Shkëndijonin vetëtima, - dhe në shpirtin e tij  
Zjarre ndizte një grua jo e vërtet',  
Një vajzë e jashtëzakonshme... i pangopur nga faqet  
Vazhdonte lexonte pa fund, deri sa u lodh.  
U ndje pak i uritur, por në xhep...  
Gjithsej kishte... veç dy kopekë.

### III

Tashmë ishte mbrëmje, kur ai, i rraskapitur,  
E vendosi librin mënjanë. – Vështroi përreth  
Rrugica ish e shkret'. – Me një lëvizje të papritur,  
Të denjë për një gjeni, fshiu ballin e dirsur –  
Dhe mori të dalë nga rrugic' e boshatisur.  
Një dyqan i vogël ndodhej atje, kopshtit përkarshi,  
I cili shiste bukë. – Bleu një çerek kile  
Dhe duke e futur në xhep, u kthye përsëri  
Në atë rrugicë të shkretë. – Vështroi përreth –  
S'dukej këmbë njeriu. – Priti dhe pak, s'pa njeri –  
Dhe filloi të hajë fshehurazi. – Në mendje  
I shfaqej akoma ai, mbinjeriu gjeni. –  
Mbrëmja zbret me shpejtësi, në kopësht vjen Nevarti...  
Me nxitim përfundon “të ngrënët”. Me një lëvizje  
Mekanike fshiu ballin e dirsur përsëri ...  
Dhe papritmas mori vendim, që duhej të shndërrohej  
Në një poet të talentuar, ai, vet' ai.  
Papritmas ai vendosi përfundimisht. –  
Më pas brodhi nëpër kopshtije qetësisht,  
Dhe paskëtaj hyri në një klub, ku disa  
Studentë po luanin bilardo, të pir'.  
Duke u ngritur prej andej dalëngadal'  
Kur pas pak ndodhej jasht' në rrugë përsëri –  
Tashmë lulishtja ishte mbushur. Pa përball', –

Nën hijen e pemëve po kalonte ajo vajza, -  
Vajza e ëndrrave të tija, mbretëresha e tij,  
Nevarti i tij i jashtëzakonshëm... U afrua,  
Provoi të fjalosej pak me të, pasi kërkonte  
Me idet' e tij të shkëlqyera ta mrekullonte ...  
Por vajza atë s'e përfilli,  
Një herë kokën nuk e ngriti ...

\* \* \* \* \*  
\* \* \* \* \*

Më pas ai djalë u shndrrua në poet,  
Dhe shkroi at' novel', që ju po lexoni...

## DJALI ME FLOKËT KAÇURRELA

Sytë e lodhur i kam mbyllur për një çast  
Dhe jam duke parë - aq qartë, aq qartë  
Një pranver' që po vjen, me një dit' të shndritshme,  
Një qiell të kaltërt, dita fort e zjarhtë.  
Dielli tashmë është ngritur pak më lart,  
Dita vjen me tinguj, porsì një organo,  
Dhe nga qiell i kaltërt, i kaltërt pa mas',  
Duket sikur derdhet këngë pa fund dhe gaz. -  
Rruga mbushur me pem' frutore të çonte  
Nga Erevani i Ri drejt Araratit;  
Si kan' rrjedhur vallë gjithë këto vite  
Deri në kët' dit' të bukur pranverore?  
Në të dy anët e rrugës së madhe, ja,  
Tashmë shtëpi, rrugica dhe punishte ka,  
Lulishte të gjelbërta, pemë me bollëk, -  
Po kush vallë i mbolli të gjitha këto?  
Shtëpit' shtrihen deri larg pran' njera tjetrës,  
Punishtet, po ashtu, varg njera pas tjetrës,  
Nuk ka tym, as pluhur, as drit' nëpër shtëpit' -  
Veç njerëz plot dhjam, me fytyrë që u shndrrit.  
Duke dal' nga qyteti tashmë i zgjuar  
Nëpër rrugën e gjerë me pem' mbuluar,  
Duke mbajtur në dor' një flamur që skuqon,

Çeta e pionierëve po marshon.  
 Përplasia e këmbëve të tyre ushtonte,  
 Daullja me ritmin e hapit gjëmonte,  
 Ecnin me hap të sigurt', me rradhë ngjeshur  
 Me sy të kthjellët, me fytyrë të qeshur. -  
 Ata kalojnë varg nëpër xhade, pastaj  
 E ndërpresin atë rrug' me asfalt të zi,  
 Dhe drejtohen të shkojnë pran' asaj lugine  
 Ku i zhurmsëm rrjedh Zanguni plot gjallëri.  
 Zanguni plot gjallëri për poshtë vrullon,  
 Me ujin e pastër që pa fund gurgullon,  
 Por atje tani – veç një mur-gur i vjetër  
 Dhe gurë, rënë në mjedisin e gjelbër. –  
 Gurë të vjetër, prej kohësh të harruar,  
 Pa emër, pa shkrime; gurë që flen' atje,  
 Dhe ku mbretëron një e brishtë qetësi  
 Dhe kujtimi fluturon në përjetësi.  
 Nga lartësit' e kaltërta qielli qesh,  
 Dielli me tinguj të pafund depërton,  
 Dhe çeta me hapin e shkujdesur marshon,  
 E dehur nga zjarr' i diellit që gazmon.  
 Hapi i tyre me forcë dhe qart' gjëmon  
 Daullja me një tingull të trash' bubullon,  
 Dhe mbi sytë e fëmijëve po lodron  
 Rrezja e diellit që pranverën gëzon.  
 Pran' atyre gur've të vjetër memecë  
 Me brohorima gazmore kalojnë ata,  
 Dhe jeta u buzëqesh, dhe u thot' pastaj:  
 Pranvera ju thërret me një mall të paskaj!  
 Ata marshojnë. – Dhe nga grupi i tyre,  
 Me sytë fiksuar mbi gurët e qetë,  
 Papritmas u nda dhe pranë gurëve del  
 Një djalë sykaltër dhe flokë kaçurrel.  
 Shallin e pionierit lidhur në qaf,

Këmbët deri tek gjuri imcak zbuluar,  
Ballin e lartë, sytë plot drit' ndriçuar,  
Pantolla të bardha, këmishë të kaltërt;  
Vështroi me sytë e pastër, të shndrritshëm,  
Gurët e varrezave për një çast ai,  
Pastaj gërvishi pak pluhurin e ngjeshur  
Që ndodhej mbi një gur të vjetër ngjyrë hi.  
Pa pastaj nga posht' vetullave harkuar  
Gurin që nga pluhuri ishte mbuluar...  
Mbi gur: – "Jeghishe Zarenc, Poet, lindur në  
Qytetin Maku" – një dorë kishte shkruar.  
Me sytë e hapura fort po lexonte,  
Dhe qeshte, a thua se diçka kujtonte,  
Mblodhi pastaj një copë stofi jeshile –  
Dhe shkoi të ndjekë shokët, të marshonte.  
Duke qeshur me zë të lartë dhe gazmor,  
Ai i bashkohet shokëve përsëri –  
Dhe, si përjetësim i kohës së shkuar,  
Ka mbetur në fushë një varr i rrënuar...

\* \* \* \* \*  
\* \* \* \* \*

E dëgjon, atje është varrosur shpirti im,  
Shkele me hapat e tu, bëje të ndrijë,  
O, ti, djalosh flokëdredhur i së ardhmes,  
Djalosh flok'art' i së ardhmes ton' të mirë...

## NËPËR UDHËKRYQET HISTORISË

Nëpër udhëkryqet e historisë gjatë jemi vërtitur,  
Sa andej e sa këtej, pa ide e pa timon,  
Që nga kohët e vjetra e deri tek kjo e tashme e ndritur,  
Që digjet para nesh dhe na ndriçon të ardhmen ton'.  
Që nga ai mëngjes imagjinar, kur legjendari,  
Stërgjyshi ynë imagjinar ndezi zjarrin e tij  
Përballë këtij Masisi në këtë madhështoren  
Fushë Araratiane, - si një bised' e pafund  
Është shtrirë kjo rruga e jonë e patreguar,  
Si shteg i shtrirë pafundësisht përgjatë shekujve,  
Dhe sot është duke shkuar dhe duke u zgjeruar  
Drejt shtigjesh dhe hap'sirash të panjohura dhe pa fund.  
Por gjithnjë përmes errësirës rruga jon' ka kaluar,  
Ka kaluar pa u njollosur dhe pa u lavdëruar,  
Ka kaluar pa buzëqeshje dhe pa u flakëruar,  
Vazhdimisht me shkëlqimin e të tjerëve është mbuluar,  
Dhe përskuqur, – ah, sa shumë fatkeqësi për të treguar!  
Si një bisedë e pamend, dikur na patën treguar  
Për at' lavdinë e paraardhësve tanë të shquar,  
Por nga largësia e ditëve tanimë unë shoh  
Veç skllavëri, pluhur, harresë dhe vdekjen e mallkuar  
Dhe një rrugëtim të pakuptim!  
Dhe unë, ja shih, një poet që është duke skalitur

Me k'to geramat tona të vjetra vargjet duke renditur;  
Me çfarë fjalësh të këndoj dhe me çfar' zelli të tregoj  
Të shkuarën e pa shkuar, historinë ton'; që gjithashtu,  
As një rapsod lavdin' e dikurshme të mos e harrojë  
Dhe me atë trishtim të pakuptimtë pas të mos shihnte, -  
Dhe po ashtu të mos krenohet më kot, që, pa ne, bota  
Shkretëtirën pa jetë do ta shndrronte në një lulishte!  
Në udhëkryqet e historis' na kanë paraprirë  
Paraardhës të përfytyruar që kurr' s'i kemi parë,  
Në largësitë e errta pa rrugë të dallueshme,  
Që së bashku me lëkurën e tyre veshur me gëzof  
E rrokullisën fatin tonë kollotumba  
Nga njeri vendi në tjetrin, - oh, vuajtje të pakufi, -  
Shënuan për ne rrugët vdekjeprurëse  
Dhe për ne totem u bë – ujku!  
O, stërgjyshër! - Ja këtë jam duke parë tani. –  
Në thellësitë e shekujve të shkuar, me rrugë të errta,  
Të uritur, të zgjebosur dhe lakuriq, drejt Masisit krenar  
Ecën ujku ynë legjendar!  
Që në ditët e para ju sulën dhe ju shqyen atij  
Brinjët e dobta – nga ana e kopesë së kafshëve;  
Dhe me brinjët e skuqura vazhdoi të ecë ai,  
Me fytyrë drejt tokës së fatkeqësive të ardhshme. –  
Nga ku ka ardhur ai, ai ujk?,  
Dhe përse që në ditët e para  
Vështrimin e frikshëm drejt dritës së hënës ka drejtuar,  
Duke shprehur tmerrin e madh në britmën që ka lëshuar?  
Dhe a e njeh ai vallë, atë bishë të coptuar,  
Rruga e së cilës tanimë është e përcaktuar  
Në at' librin e të ardhmes – që për mijra e mijra vjet  
Rrugë e pa rrugë, të ecë kuturu ka vazhduar, -  
Nëpër udhëkryqet e errta të historisë  
Ashtu do t'i endë ai për shumë shekuj me rradhë  
Brinjët e tij të shqyera – drejt kush e di çfar' largësish,

Drejt çfarë fushave të skuqura dhe të përgjakura!  
 Oh, ujku ynë nuk është' krijuar prej bakri  
 Dhe as prej mermeri, dhe aq më pak prej guri;  
 I dobët, brinjët shqyer, ai kalon nëpër  
 Stepa pa fund, deri sa një çast gjen qetësi  
 Përballë këtij Masisi si në përrallë,  
 Në kët' fushën Araratiane të pamatë,  
 Dhe i shtrirë përballë hënës sa gjerë-gjatë  
 Ulërin pa rreshtur dhimbjen e tij nëpër natë;  
 Ulërin dëshpërimin, dhimbjen e tij të mprehtë,  
 Urin' e tij shtazarake, - dhe ulërim' e tij  
 Është kthyer në hymnin tonë të pavdekshëm;  
 Dhe për shekuj kumbon mbi historinë tonë!

Pastaj për shumë vite na udhëhoqën ca mbretër  
 Të pa aftë, jopopullorë, pa asnjë merit',  
 Lavdi e të cilëve, shkruar në librat tan' të vjetër,  
 Kish qenë veç kotësi dhe lajkatim hipokrit. –  
 O, ju, paraardhësit tanë të hershëm,  
 Në shumicë Hajk dhe Dertat legjendarë,  
 Princër pa lavdi, skllevër lakmish të kota,  
 Mbretër jopopullorë dhe të pa aftë;  
 Ju, që për shekuj të tër', mijravjeçarë,  
 Posi fantazma të pa formë keni jetuar  
 Dhe në pallate qiellore keni qëndruar,  
 Zjarrin e shpirtit në zjarre të huaj duke kërkuar,  
 Që në tërë mijëvjeçarët e ekzistencës suaj  
 Asnjë trashëgimi për pasardhësit s'keni krijuar;  
 Kush, cili historian do t'ju lexojë juve faljen,  
 O, ju, kopshtije pa fruta dhe shkretëtira të thella!  
 Pastaj na udhëhoqën për shumë vite të tjer'  
 Feudalë të shthurrur si dhe princër të kotë,  
 Me nuanca mijra llojesh fytyrën përlyer;  
 Dhe ato të pastrat burime tona të pavdeksisë

U turbulluan me armiqësi dhe gjëra pa vlerë,  
Me kotësinë e lakmive të ulta e pa kuptim  
Duke na mbështjellur qafën me zinxhirin e skllavëris',  
Duke mbjellur, kultivuar për gjithë popullin tonë –  
Farërat e gjërave pa rëndësi, të kotësisë,  
Të paarësyeshmëris' dhe dhembshurisë shtirane,  
Dhe vendosën mbi fytyrën ton' vulën e robërisë,  
Ushqyer me qumështin e hidhur të jetës mjerane!

Por ishin disa, ata që erdhën pas princërve tanë;  
Kalorësit e fundit të mjerimit tonë të thellë,  
Ushqyer me qumështin e paraardhësve bredharak';  
O, ti, doktrinari Minas, apo ti, Israel Ori, -  
Cilat pasione jan' kaq të forta dhe madhështore,  
Me të cilat juve jeni ushqyer në dhe të huaj,  
Dhe që, dhe që, dhe që ju, të kthjellët, të qartë në qëllim  
Keni synuar që këtë jetën tonë pa ngushëllim  
Ta nxirrni nga ato skaje të errta ku nuk ka gëzim,  
Dhe brezave pasardhës t'i çelni një rrugë plot ndriçim; -  
Dhe tani ne do t'ju këndojmë himne mbushur me lavdi –  
Që në mendimin apo ëndrrën tuaj dukej fantazi!

... Dhe ja, e parë nga ato malet tona të larta,  
Ku digjej zjarri i shpresës sonë të fundme,  
Përreth – mbrëmje e errët dhe një mjegull e dendur,  
Përreth – shkëmbinj të errët dhe plepa të lartë, -  
Dhe në mjegullën që ngrihet – shfaqen pallate,  
Të vegjël, të vajtueshëm, të mjerë;  
Në muret e tyre të errta një fill ari ruajtuar,  
Dhe as edhe një, as edhe një gozhdë;  
As edhe një copë hekur, apo përzierje kallaji,  
As edhe një kollon' mermeri, apo së paku gëlqere,  
Që prej shiut avull lart të nxirrte në çastin e shpërthimit  
Dhe tymi i saj të përzihej me këngën e rebelimit!

Pallati – kështu: - Ndërsa përposht – kasolle,  
 Nëntokë, nëntokësor, kudo shpërndarë,  
 Varrosur si rradake të shurdhëta, si rradake pa tru,  
 Të ngjashme me një kope të mjerë  
 Që në orën për kullotje papritmas si vetëtimë  
 Hidhet përjetë nga gëzimi dhe ngre një re pluhuri –  
 Dhe vendi ngelet një masë e pluhurosur  
 Prej shekujsh pa ujitur dhe e pa ajrosur!  
 Dhe ata, – udhëheqësit tanë budallenj,  
 Ata princër të mjerë, të fundit zotërinj,  
 Ikën nëpër nat' dhe udhëtuan të vetëm  
 Drejt veriut, drejt strofullave veriore  
 Si arinj zemërngirë dhe nga dielli djegur;  
 Ashtu kish qen' edhe ujku yn' pre në rrugët e vjetra,  
 I rraskapitur, brinjët e dala jashtë dhe pa dhëmbël!

Unë po i shoh ata. – Përpara syve të mi  
 Ja me të gjithë shtatin e tyre të rrënuar  
 Prej kasolleve të tyre dhe maleve të lart'  
 Po ecin nëpër rrugë pa drejtim dhe pa ide.  
 Duke kërkuar nëpër horizontet e gjerë,  
 Të ardhmen, rrugën e drejt' për brezat që do vinë -  
 Çfarë po mbartin ata të tjerëve për t'ua dhënë,  
 Çfarë prodhime të tokës dhe mirësi jetësore?...  
 Vallë çfarë lloj thesaresh, çfar' prodhimesh dhe ngarkesash,  
 Çfar' thesare të çmuara të shpirtit dhe të fuqisë?...  
 Hiç asgjë. – Ata po dërgojnë, si një dhurat' në dorë,  
 Karvane me dhimbje dhe mund që i shtohen vobegsisë.

Dalë në kërkim të një shtegu drejt së nesërme,  
 Një horizonti dhe një drejtimi të së ardhmes,  
 Ata mbartin vetëm dhimbjen pa personalitet  
 Dhe gëlqeren mbytëse të lavdisë së vdekur  
 Fytyrën tonë mijravjeçare duke rrjepur!

Dhe me shkëlqimin legjendar të lavdis' së fikur  
Mjerimin mizor mijravjeçar duke mbuluar –  
Ata depërtojnë në veri dhe kudo munden,  
Eunuku, soj i fëlliqur dhe i rrëgjuar!  
Bëjnë ca premtime që kurrë nuk do t'i mbajnë  
Në emër të së shkuarës gjoja të lavdishme,  
Dhe u prijnë atyre për në Tokën e Shenjtë,  
Në emër të birit, shpirtit dhe atit të shenjtë!

Kështu ecim ne pa e varar' mendjen dhe pa mendim  
Nëpër rrugët me kalldrëm të historis', si mirazh;  
E presim rrugën përsëgjati,  
Dhe kjo rruga jonë  
Kur do jet' e vërtetë, kur do ndriçojë, oh, kur,  
Kur do ndizet nga dritat e së ardhmes së ndritur? -  
Dhe kush, dhe kush do t'i japë të ardhmes tonë  
Drejtimin e duhur edhe kuptim?!

Dhe pas tyre, ja, pikërisht mu përballë meje  
Një dorë, që fuqi po i jep këtij lapsit tim –  
Po i kthehet historisë son' të pambaruar  
Dhe ka hapur faqen e parafundit të librit;  
Dhe kanë dal' publikisht – figura të pa formë –  
Zotërinjtë tanë të djeshëm pa pikë vlere. -  
O skllëvër të fajdes', sahanlëpirës, gatues  
Të përbuzjes dhe të mjerimit në errësi;  
O, grabitës të thesarit trashëguar prej nesh,  
Që në skaje të largëta keni gjetur strehim;  
Ndërtuat për vete kështjella dhe pallate,  
Për ne mbollët vetëm furtunë;  
Dhe të sotmen injorancën tuaj mjerane  
Si sperancë të fundit  
Në shitje na e nxorrët!  
Dhe humbi lavdia juaj. Pallatet tuaja

Si mirazhet në shkretëtirë  
 U zhdukën një ditë – dhe as edhe një dorë  
 Nuk la gjurmë pas jush në ballin e historisë!  
 Si pluhur - kaluat, porsi erë,  
 Dhe as edhe një, as edhe një rregjistër  
 Nuk ka për të shënuar në faqet e tij ndonjëherë  
 Iluzionin tuaj pa bazë, të turbullt dhe pa dinjitet!  
 U ç'bë lavdia juaj. - Dhe ajo, që akoma ju ka mbetur  
 Në largësitë e skajshme të kësaj bote,  
 Do të shkatërrohet një ditë në çdo vend,  
 Dhe në ditët e shndritshme, që do vijjnë,  
 As edhe një rapsod kurrë në këngët e tij  
 Një mallkim për ju nuk do të lëshojë;  
 Ju, që vetëm mjerim mbillni në shpirtrat e lënduar  
 Dhe që në të ardhmen – do korrni një harresë të trishtuar!  
 Kurse populli, që na doli se ish i talentuar,  
 Që na doli se ish mjeshtër, se ish ndërtues i mirë,  
 Për të ndërtuar qytete, parqe për të rregulluar,  
 Ka ndërtuar ura me formë të harkuar, -  
 Që nëpër shekuj ju mbajtën përmbi shpinë  
 Derisa agimi tashmë ka zbardhuar;  
 O, ju zotërinj të mjerë, të fëlliqur dhe soj-sojesh,  
 Tirania jonë e mallkuar!  
 A ka qoftë edhe një grimcë të vogël të vërtetë  
 Në këto veprat tuaja pa pikë talenti?;  
 Njerëzit, puna e së cilëve është e ndershme,  
 Duhet sjellë në tryezën tuaj, gjakpirës! –  
 Oh, jo! – Jetën e tij prej bujkrobi ai ka jetuar,  
 Në thellësit' e errta diellin duke ëndërruar, -  
 Dhe ndër shekuj me rimat e tij të thjeshta ka kënduar  
 Mendimet e tij të vërteta dhe të madhërishtme.  
 Krijoi ai përrallat e tij, - dhe në  
 Legjendat e lashta, me talentin e përsosur –  
 Idenë e kuqe të jetës së tij të ardhshme

Dhe mendimet e tij të pavdekshme ka vendosur.  
Megjithatë, thellë brenda robërisë,  
Nëpër rrugët gjarpërushe të historisë,  
Ka luftuar me shpirt, ka luftuar ai vazhdimisht,  
Dhe s'është përkulur në vitet e errta të vështirësisë. –  
Brenda kubeve të gurta të robërisë së thellë,  
Ndën tiraninë kombëtare apo të huaj,  
Fryteve te krijimit të shpirtit tonë të pamposhtur  
Ai i ka hapur rrugën vazhdimisht.  
Është pikërisht kjo rrugë, që përballë tër' atyre,  
Mbretërve të fëlliqur dhe zotërinjve të pavlerë, –  
E detyroi shpirtin tonë – aq të ngarkuar,  
Sa ta ç'bëjë bujkrobërinë.  
Ajo rrugë, siç duket tashmë, zvarritet  
Që nga ditët tona deri në mesjet'n e largët,  
Deri në shekujt e hershëm, ku me vështirsi  
Dallojmë ne rrjedhën e ngjarjeve në histori.  
N'ato rrugë të thepisura kanë kaluar  
Njerëz të paemër, të thinjur, fshatarë skllëvër, -  
Që kanë mbajtur në gjoks ide frymëzuese,  
Mendje krijuese, fjal'të zjarra, që akoma  
Qjellin s'kan' arritur, formë ende s'kanë marr',  
Por do të ngrihen një ditë të formësuar;  
Oh, thesare të fshehura të shpirtit gjenial,  
Dhe rima të talentit akoma pa zbuluar!  
Kjo i dha shpirtit të tij një lakim të pakufi  
Dhe, po kjo, lavdinë tonë e ka kufizuar, -  
Por a mundet vall', nëpër zinxhirët e robëris',  
Ai ta ruante zjarrin e tij të mallkuar?!  
Në ditët e mbretërve dhe të princërve është endur  
Nëpër zinxhirët e bujkrobërisë ai i heshtur,  
Dhe në shumicën e rasteve si rob është zvarrisur  
Dhe robëria e ka mbajtur të heshtur, goj'puthisur. -  
Dhe nën shtërngimin e robërisë që kish vënë poshtë

Secilin prej sklevërve, at' pamjen e vdekjes mizore  
 Atij ja kanë mbështjellë me një vello keqardhjeje,  
 Ndonse thesar i paçmuar, ndonse depozit' hyjnore  
 E zjarrit të pashuar të shpirtit të tij, shpirtit gjeni,  
 Atij zjarri krijues, - që prej të gjithëve fshehur rri  
 Dhe ndizet vetëm fshehurazi dhe në mënyr', ashtu si  
 Krimineli ndez llambat e tija kur shkon në urinim.  
 Kështu u paralizua përballë shtypësve mizor',  
 Gjenialiteti i madh kolektiv i njerëzisë, -  
 Dhe u kthye përsëri njerëzia tashmë po ashtu,  
 Si zotërinjt' e tij, të rremë dhe pa personalitet!  
 Por më pas, kur ndryshoi drejtimi i rrjedhës në shekuj,  
 Kur përgjatë shekujve u shua shkëlqim' i kallajit,  
 Megjithatë ajo purpur' verbuese e mbretërve -  
 Dhe po në atë vend të mbretërve,  
 Ari ka fituar pushtet edhe shkëlqim,  
 Dafina të përgjakura ka shpërndarë,  
 Për të mbajtur në këmbë ca pushtetarë,  
 Ku shkëlqimi dhe lavdia ndoshta është blerë;  
 Ai u zvarrit përsëri si paraardhësit  
 Nëpër galeritë në një punë të pabukë,  
 Duke shërbyer tashmë atje deri në vdekje,  
 Duke u familjarizuar me jet'n prej skllavi.  
 Dhe me këtë punë të pabukë n'ato galeri,  
 Si edhe më par', me punën si bujkrob në fusha -  
 Atij i ra përsipër si një goditje nga larg  
 Barra e dyfishtë, mundimi dhe robëria.  
 Mbi kokën e tij përplasur ai kamzhik i ri  
 Është bërë dy copësh, ashtu si dhe mustaqet, -  
 Dhe shpërblimi i shpirtit, i cili është i shenjt' -  
 Për të kish qenë gjithmonë i ndaluar.  
 Por, në jetën e tij të vështirë, për herë të par'  
 Përgjatë rrugëtimit mijravjeçar -  
 Ai pa këtu një agim rrezear,

Që mes përpjekjesh rrugën kish çar!  
Dhe kështu – nëpër udhëkryqet e historisë  
Kaluam neve pa udhëheqje dhe pa ide,  
Të përskuqur në zjarrin e pafund të të tjerëve, -  
Dhe rruga jonë pa shkëlqim  
U bë rruga e vdekjes, e kotësisë;  
Dhe sot nuk kemi mundësi t’ju thurrim ne lavdi  
O, stërgjyshërit tanë të moçëm dhe të mjerë,  
Historia jonë e paformë dhe e pavlerë!  
Dhe, ja tani, të sapodalë nga gjumi pa ëndrra,  
Ne po mallkojmë indiferencën tuaj të errët –  
O, konstruktorë të poshtër të së shkuarës sonë të vjetër  
Dhe heronj të pa lavdi të historisë sonë!  
Në këtë planet të larmishëm,  
Që nga fillimi i botës e deri në fundin e saj  
Duket sikur ne jemi të parët njerëz,  
Që edhe nëse duam një herë – të tradhtojmë,  
Të paaftë jemi për lavdinë dhe të kaluarën tonë historike,  
Dhe jemi tashmë të varur përkundrejt të ardhmes  
Çuditërisht lehtë, çuditërisht indiferent  
Si të çveshur lakuriq dhe pa të shkuar!  
Siç duket neve jemi si ajo gamilja kokëfortë,  
Që në kundërshtim me fabulën e Krishtit –  
Duhet të hyjmë fillimisht nëpërmjet vrimës së ngushtë të gjilpërës,  
Për në parajsën e dliirë të së ardhmes!  
Ndoshta neve ngjajmë, siç duket, me atë pasunarin,  
Me kotësi në të kaluarën tonë pasuruar;  
Do të trashëgojmë neve humbjen e shekujve tanë,  
Që të gjith’ të dobtëve nga lart u është kufizuar!

# NAUSIKËS

Kujtimit të gruas, Arpenik Zarencit

## COPËZA

### I

E ngjashme me Najadat, ashtu posi Najadat  
Ajo mua më thërret me zërin e trishtuar,  
Magjin' e dashuris' pa pushim duke premtuar  
Dhe brengën dhe ankthin e humbjes duke lëshuar ...

Nga ditët e shkuara pa kthim të fëmijërisë sime,  
Mes grimcave të kuqe të viteve të mia –  
Mua gjithnjë më ngjan, që mbërthyer prej trishtimit  
Vazhdon të më presë Nausika ime...

Fillimisht, si breng' e jetës ende të panjohur,  
Në detet e kaltërt me varkë duke lundruar,  
Si imazh kalimtar, apo ëndërr e paçmuar –  
Që nga larg më thirri Nausika ime.

Shënim:

Nausika – Në poemën “Odisea” të Homerit Nausika është vajza e bukur e Alkinos, mbretit të Fakias, e cila takon Odiseun të hedhur në ishull pas mbyrtjes së anijes...

Dhe pastaj nëpër ditët dhe nëpër vitet pa kthim,  
Mes grimcave të kuqe të çasteve të mia, -  
Ëndërrova vazhdimisht, se mbërthyer në trishtim,  
Vazhdon të më presë Nausika ime...

Herë si vashëz, herë me pamje fëminore,  
Herë porsi grua parë veç në ëndërrime, -  
Her' virgjëri e papërlyer, her' Manon Lesko -  
Kështu m'është shfaqur - Nausika ime.

Herë bardhoshe fare, si statujë mermeri,  
Herë si vazo prej argjile mikeniane, -  
Her' ngjyr' ebaniti shndrruar në egjiptiane,  
Më magjeps që nga larg Nausika ime. -

Herë me ije të lëmuara, si argjend i derdhur,  
Herë, si një gjarpër femër të kam ëndërruar,  
Herë, me sy të gjelbër, në një një grua shndrruar, -  
Në virgjëreshë të papërlyer Nausika ime.

Her' me petka fëshfëritse, her' me mbules' valëvitse,  
Herë të tjera, si me vellon e hënës e mbuluar, -  
Her' e veshur plotësisht, her' e zhveshur lakuriq,  
Grua e shpenguar - Nausika ime!

Me zërin e fyellit nganjëherë më thërret,  
Tjetër herë me tingujt e ëmbël si të lirës, -  
Her', si prej shekujsh njohur, her' si të posanjohur  
Me zë të shpenguar - Nausika ime.

Në lartësitë e pafund, në luginat poshtë tyre,  
Apo brenda rërës së artë të brigjeve të detit, -  
Herë në detin që gjëmon, herë në liqenin që pushon -  
Çapitjen tënde unë dëgjoj, Nausika ime.

Dhe çdo çast unë pres për ty,  
Dhe ëndërroj, që rruga të jetë ëndërr me ty, -  
Në çdo vend, në çdo çast me ty,  
Vizioni im femëror, Nausika ime!

Dhe në këngë talent, talent edhe në të shkruar,  
Në çdo fushë të jetës prapë e talentuar, -  
Edhe në veri, dhe në Lindjen e lashtë,  
Dhe në jugun e verdh', Nausika ime.

Në rrugë të gjata, në çdo çapitje apo marshim,  
Vrojtues i ngjarjeve gjigante, apo shtiracak  
Unë jam në pritje, që unë, ose ti, pa dallim,

Të njohim njeri tjetrin, Nausika ime.  
Çdo mëngjes që çel, sa her' që zbardhon,  
A brenda çdo ëndrre qw kam parë, -  
Sa herë që një derë prej erës të hapet qëllon –  
Unë pres me ty të përballem, Nausika ime.

Që nga fëmijëri e kaltërt – deri në mesditën e jetës time,  
Në ditët e mia të kaluara posi në ëndërr, -  
Unë vazhdoj të pres, që – ti do shfaqesh përballë meje,  
Iluzioni im i përjetshëm, Nausika ime.

Dhe me gjithë librat e mi, dhe me këngët e pavdekshme,  
Dhe zjarrin e vrullshëm të kësaj të zjarrtës etjes sime, -  
Gjithçka kam bërë, akoma çfarë duhet të bëj unë, –  
Vetëm për të të gjetur ty, Nausika ime?  
Dhe deri në atë ditë të zezë, deri sa të ngryset,  
Deri sa të ma kesh shterruar gjithë energjinë time  
Unë në rrugëtim do gjendem, në kërkim për dritën time,  
Dashurinë time të paarritshme, Nausika ime...

Dhe në thirrjen e poetit, dhe në ethet e pasionit,  
Dhe në këngët me arom' gjaku, dhe në ëndrrat dashurore, -  
Besimin e kotë paskam përkundur, ëndërr fëminore,  
Se mua ende je duke më pritur, Nausika ime!

Për trëndafilat mbledhur përgjat' viteve që më s'kthehen,  
Nga vendi i një ëndrre që avulluar është pa kthim, -  
Në fundin e ditëve të mia, si dhurat' e pa çmim -  
Ti do të më buzëqeshësh mua, Nausika ime!

E ngjashme me Najadat, ashtu posi Najadat  
Po më thërret ti mua me zërin e trishtuar,  
Magjin' e dashuris' pa pushim duke premtuar  
Dhe vdekjen, dhe ankthin e humbjes duke lëshuar!

## II

E ngjashme me Najadat, ashtu posi Najadat  
Me zërin e trishtuar më thirri ajo mua, -  
Magjin' e dashurisë pa pushim më premtoi  
Por veç at' ankthin e vdekjes më la ajo mua!

Nga shtatë shërbëtore - engjëjt e saj rrethuar,  
Nga dashuri e tyre dhe zilia e zjarrrë,  
Kur me vullnet të lir' vdekjes i ish dorëzuar,  
Pranoi dashurinë time fatkeqe - Nausika ime!

Brigjeve të detit të hidhërimeve duke kaluar  
Veç ti u bëre bregu im i artë, shpresa ime -  
Por në fat të zi u shndrrua dhe në krim vdekjeprurës  
Dashuria ime fatkeqe për ty, Nausika ime!

Dhe në ngjyrë rozë, si një koral ngjyrë rozë,  
Brenda grimcave të kuqe të hidhërimeve –  
Ti më buzëqeshe, ike, u shndrrove në hije,  
Oh, dashuria ime vrastare, Nausika ime!

### III

...Tashmë naiv i shndrruar porsi Najadat,  
Me zë të butë, joshës, porsi Najadat  
Duke premtuar pranverën, joshjen pranverore –  
Kush është që mua më thërret, kush është?!

Posi Ulisi, mbështetur në direk i përmalluar,  
Prej këngës së Najadave të pagjuma robëruar  
Dhe pas kujtimeve të tija plotësisht dorëzuar,  
Unë atyre brigjeve përsëri ju kam afruar!

Mos vallë si Ulis i rikthyer përsëri,  
I pafuqishëm, brenda ëndrrës me sy hapur, -  
Do ta shoh atë ishull, ku me aq dashuri,  
Më takoi një ditë - Nausika ime?

Ja, të njëjtat Najada – dhe e njëjta këngë' magjike, -  
Por akoma më e ëmbël dhe më e pakufishme!  
Dhe afrohen të njëjtat këngë të magjishme,  
Por... përse ajo duket tani kaq e trishtme?

Janë po ato brigje të kaltërta, - dhe në shesh shtruar  
Janë po ato vajza, - dhe Nausika...  
Por ajo më pa pa lëvizur dhe me sytë fiksuar  
Në të shkuarën e pakthyeshme – ashtu si në ëndërr!

Dhe duke u zhytur, si një koral ngjyrë rozë,  
Mes grimcave të kuqe të viteve pa kthime,  
U largua pa kthim, edhe u shndrrua në kllapi, –  
Ashtu si e shkuara fëmijëri - Nausika ime!

#### IV

Të ngjashme me Najadat, ashtu posi Najadat  
Më thirrën ato mua me zërin e trishtuar, -  
Magjin' e dashuris' pa pushim duke premtuar  
Dhe duke më lënë - veç ankthin e vdekjes!

Brigjeve të detit, në aventurat kaluar,  
Një e quajtur Nausik' më pati takuar,  
Mbërthyer pas brengës të saj më pas qe larguar,  
Ndoshta tjetër Ulis, ndoshta me tjetër dashuruar!

Në përrallë, pas këngëve të saj të kaltërta mbërthyer,  
Si një Nausikë e dashurisë së dikujt tjetër –  
Në një princesh' që ruante Uliksin e saj ishte kthyer,  
Brenda grimcave të kuqe të hidhërimeve!

Dhe duke menduar një princeshë djegur prej mallit tim  
Sa shumë, sa shumë e bukur dukej kjo Nausikë –  
E fundosur, e përhumbur, porsi koral i kuq,  
Brenda grimcave të kuqe të hidhërimeve!

Endur në brigjet e kaltra të aventurave të mia,  
Brenda çasteve të mia të ëndrrës së kuqe,  
Gjithnjë në dashuri e dikujt tjetër princeshë u shndrrua  
Çdo Nausikë që unë takova!

Por në tokën e tjetërkujt në princeshë shndrruar  
Çdo Nausikë prej meje tashmë e harruar  
Përsëri u kthye, më uthi e dashuruar –  
Mes grimcave të kuqe të këngëve të mia!

Në ëndrra të pafund ato duke ëndërruar,  
Mes grimcave të kuqe të ndjenjave të mia –  
Atë ç'kish mbetur jasht' nga këngët prej meje shkruar –  
Vajzë që s'të dashurova, ty ta kam dhuruar!

Në vitet që shkuan, i djegur prej mallit,  
Prej meje s'është ëndërruar vetëm Nausika  
Të cilën prisja unë, – por humba gjithçka,  
Që në ëndrra dashurova, si një ëndërr!

N'aventurat e brengave të kuqe kërkuar,  
Kërkush s'më buzëqeshi, as edhe një Nausik', -  
Dhe çfar' kisha botës së tyre për t'i ofruar –  
Vajzë që s'të dashurova, ty ta kam dhuruar ...

Çfarë mbeti akoma jasht' nga këngët prej meje shkruar –  
Mes grimcave të kuqe të pasioneve të mia –  
Dhe çfarë kisha botës së tyre un' për t'i ofruar –  
Në jetë ta dhashë un' ty, Nausika ime.

Rrugëve të jetës, n'ato ditët tonat të vështira,  
Gjithçka që për mua ishte mall, zjarr – unë ty ta dhashë,  
Që ëndërr të mos mbetet më, që ato mos ëndërroj më,  
Që as edhe një Nausikë të mos më thërrasë më.

Ndonse përsëri, përsëri, ashtu porsi Najadat,  
Vazhdojn' të më thërrasin me zërin e përmalluar,  
Magjinë e dashuris' pa pushim duke premtuar,  
Veç ankthit të vdekjes asgjë s'më kanë ofruar.

As ledhatimet e mia, mbi ty bujarisht shtruar,  
Brenda ëndrrave të kuqe të mbrëmjeve të mia, -  
As trishtimet e pafund, shprehur në vargjet e mia, -  
Nuk e shterruan mallin tim, Nausikë. –

E ngjashme me Najadat, ashtu porsi Najadat, -  
Me britma përmallimi ti mua më thërret,  
Dhe do më thërrasësh mua, për aq sa të kem jet',  
Dashuri duke premtuar, por e di, ankth – më pret!

Dhe do thërrasin ato, deri sa pa frymë të mbeten,  
Në çastet e mia të fundit brenda ëndrrës time  
Më puth ti mua, ndonëse për Ulin dëshiruar,  
Frymën e fundit duke mbajtur Nausika ime...

# YLBERI

## I

Vajzë si dritë abazhuri, me sy si një shenjtore,  
Si ëndërr e trupëzuar, delikate, transparente,  
Vajz' e kaltërt, shpirti ngjyr' agate' apo qumështore  
Vajzë si dritë abazhuri!

Dhe çfar' të bëj, çfar' të bëj, që në shpirtin tim të mos vdesë,  
Që agate' e syve të tu të mos fiket n'shpirtin tim;  
Dhe çfarë të bëj, që ylberi me tre ngjyra të mbesë,  
Që të mos tretet, të mos fiket larg shpirtit tim!

Vajzë si dritë abazhuri, me sy si një shenjtore,  
Si ëndërr e trupëzuar, delikate, transparente,  
Vajz' e kaltërt, shpirti ngjyr' agate' apo qumështore  
Vajzë si dritë abazhuri!

## NGA TMERRI I RËNIES

Tashmë un' jam një poet; dhe - Zarenc është emri im -  
Ndër shekuj do jetoj', i lartë dhe i madh, plot shkëlqim.

Unë vij prej shekujsh dhe fitimtar jam duke shkuar  
Përsëri drejt shekujve, drejt të Ardhmes së ndriçuar.

Çfarë kërkon prej meje ky trishtim i kaltër si zjarr?;  
Çfarë kërkon ky shpirti yt, Nairi mijravjeçar?

Dhe aromën tënde para meje përse përhap ti  
Dhe brengën time e ndez me vuajtje të pakufi?

Dhe përse para meje u shfaq ajo vash' e vjetër,  
Me syt' e gjelbërt plot drit' dhe e hijshme në zbehtësin' e saj.

Dua të zhvishem, të helmohem, të mbetem pa fuqi,  
Ashtu si shuhet një pishtar, si i humburi fëmi.  
Dhe pa u lëshuar asnjë shigjet', nga tmerrri i rrëzimit,  
Me vrap u ktheva unë tani – unë tërhiqem përsëri.  
Dhe syt' e mi, përball' një tabllo me blu pikturuar, –  
Përsëri mbi turmat e dala mendsh janë fiksuar.

Ato kanë dalë përsëri, janë shumë, janë zjarr,  
Dhe qytetet tuaja, drita plot, do t'i rrënojnë mbar'.

As edhe një magjepsje bota e juaj më nuk do të ketë,  
Në vend të saj vdekje, shkatërrim, plagë dhe hi ka për të mbetë.

Prej hirit nuk do duket shkëlqim i hidhur i shtëpisë suaj,  
Dhe as zinxhiri i ëmbël dhe i kaltër i dashuris' tuaj.

Të gjelbërit sytë e tu eptorë nuk do ndizen më, -  
Ato në hi do shndrrohen, flakën e zjarrtë s'do kenë më.

Dhe askush më s'do kujtohet, që përgjat' shekujve, dikur,  
Prej zhgënjimeve të llahtarshme, shpirti im u bë si gur.

Që përgjat' shekujve m'është bërë si një grua-lubi,  
Që tej e ka flakur shpirtin tim që shkëlqen si yll i ri.

Ata do vijnë, do shkatërrojnë, dhe s'do ngelet më asgjë,  
As parajsja e ferrit tuaj, as parajs' e lumturisë.

Dhe asnjë grua nuk do të dëgjojë për zhgënjimin tim,  
Që në vend ëndrrash të qelbura e shndërroi shpirtin tim

Dhe asnjë fjal' e thën' në vjershat e mia s'ka për të treguar,  
Që unë jam shndrruar rob, dhe që shpirti mua më ka lëshuar, ...

Unë jam poet – dhe tani këngët e mia të zjarra  
Do fluturojnë drejt së ardhmes si shigjeta të arta.

Dhe kam ardhur prej shekujsh dhe triumfator un' po shkoj  
Drejt shekujsh të rinj, drejt të ardhmes së kuqe që shikoj...

## LETËR MIKUT TIM POET, N.N

Shkruar nga Erevani

Ja ku po të shkruaj unë përsëri,  
Ty, o shoku im i mirë, miku im, -  
Ty, o poet i madh ndonse anonim,  
Përsëndetje poetike, miku im. -  
Po të shkruaj me rimë të thjeshtuar,  
Me ritëm të qartë, vetëm me një jamb,  
Po të shkruaj un' ty i përmalluar,  
Si Pushkini Delvigut i ka shkruar!

Në shpirtin tim i qetë jam un' tani  
Dhe idetë të qarta, plot kthjelltësi.  
Mbi shpirtin tim ka zbritur si me magji  
Një e madhe, e çuditshme qetësi.  
Ndërkohë as vetë nuk e di se si,  
As çfarë ish ajo që më ndryshoi,  
Mos vallë një hap heroik ish ai,  
Apo vallë ish koha që kaloi?

Jam bërë serioz dhe vetbesues,  
Kam hequr dorë nga fëmijëria!  
Mbrëm' në dhomën time teksa qëndroja,  
Aleksandrini fillova po lexoja;  
Un' po lexoja... Ndërkohë shpirtin tim  
Një gëzim shumë i madh po e pushtonte;

Aq shumë i madh, me aq shumë shkëlqim  
Sa veç dielli mund të rrezatonte.

Dhe Aleksandrin thjesht' duke kënduar,  
Edhe një herë unë e kuptova,  
Se përse vepra prej tij skulpturuar  
Në zemrën e brezave ka jetuar.  
Se përse në horizont të shekujvet  
Ai nuk zhduket, dhe se përse ai  
Përjetësisht shkëlqen dhe lartësohet  
Dhe askurr' nuk do i humbas' shkëlqimi.  
Përgjigjen po të nis tashmë i mplakur  
Të asaj pyetjes tënde të vjetër;  
Nëse don që këngën të ta dëgjojnë  
Bëhu fryma e kohës tënde patjetër.  
Lidhu me fije nervore çfarëdo  
Me ditët e tua dhe shekullin tënd,  
Jetën më zë të plotë e dashuro  
Dhe lirën tënde kurr' mos e tradhëto.  
Duhet të shkrihesh me shekullin e ri,  
Kështu po të them!... Por, a ka vall' tani  
Një vepër aq të vështir' dhe pakufi  
Aq të thjeshtë, po aq të ndërlikuar?  
Ka njerëz në këtë botë, që besojn',  
Se kush bërtet, kush zërin e ngre më fort  
Me ethet e kohës veç ai jeton,  
Dhe xhelozin' e klasës që e rrethon.  
(Një herë e një kohë, për fat të keq,  
Edhe unë ashtu kisha menduar,  
Por pasi ngrita lirën e bekuar,  
Tashmë po përpiqem për të shpëtuar  
Nga ai pasion,... ndoshta... ndoshta po...  
Në të ardhmen mbase dhimbje do ndiej,  
Ndonse kjo e lehtë dhe e thjeshtë ish  
Dhe e padëmshme, edhe e dobishme!?)

Përreth nesh, shih, shih, sa shumë fytyra,  
Sa shumë njerëz, trumbetat kanë marr',  
Punës i këndojn', ritmin trumbetojnë,  
Këndojnë këngë që aq fort ushtojnë.  
Po këndon sot, shih, ditë e natë,  
Një ushtri e tërë me poetë,  
Ndërkohë sot këngë shumë pak ka,  
Ndonse letër dhe bojë shkrimi ka.

Ushtria jonë - e madhe është sot,  
Pasi të gjithë ushtarë sot quhen;  
Marrim qytete edhe fshatra ne plot;  
Por shkruajmë edhe këngë neve sot.  
I këndojm' dashuris', vdekjes që na pret,  
I këndojm' betejës, punës së vërtet',  
Në këngët tona, ndërkohë, sot nuk ka  
As dashuri, as mendim, as edhe jet'. -

Përkundrejt shekujve tanë të mëdhenj  
Çfar' jan' këngët tona bëlbëzimtare!?  
Ne, që një jetë të re duke ndërtuar jemi,  
Këngë të veçanta dhe të thella sot nuk kemi.  
Çfarë deri tani ne kemi shkruar,  
Ka qenë vetëm një parathënie  
Për një këngë gjigante të bekuar,  
Që do të vijë, por akoma s'është.

Mos u beso ti poetëve tanë  
Të vetëkënaqur, që shumë' jan' shtuar,  
Dhe që vjersha i thurrin njeri tjetrit  
Pas këngëve të tyre dashuruar.  
Shumë e vogël duket e ardhmja jon',  
Nëse në këngët e tyre e shikon; -  
Oh, shekujt tanë heroikë ç'thoni  
A ja vlen ato këngë t'i dëgjoni?...

Por vjen ai, poeti i madh, ai,  
 Poeti i ri prej nesh ëndërruar,  
 Që do t'i këndojë njeriut të ri  
 Madhështis', zjarrit dhe thellësis' së tij.  
 Me lirën e tij prej bakri punuar  
 Frym'n e këtij shekulli të madh këndon,  
 Shpirtrat me zjarrin e shenjtë përvëlton –  
 Dhe lirën e vet kurrë nuk e tradhton!  
 Ja tashmë dhe shekulli ynë gjigand  
 Duke gjëmuar, përball' të shkuarës,  
 Është lartësuar, porsi mburojë,  
 Ka emrin e fuqishëm të Leninit.  
 Dhe atje ku më par' burg i errët ish,  
 Bujkrobëri, ku flinte veç heshtja, ish –  
 Lëvizin posi stuhi të furishme  
 Turma të pa fundme, të madhërishme.  
 Posi një stuhi e vrullshme që ushton  
 Është baza e detit socialist  
 Si një oqean është sot jeta jon'  
 Ku rrymat përplasen aq fort fatalisht  
 Si dy male përballë njeri tjetrit  
 Dy klasa të fuqishme janë ngritur,  
 Andej frona të vjetër po rrëzohen,  
 Ndërsa këndej rende të rinj ndërtohen, -

Dhe tashmë në këtë shekull plot energji  
 Në këtë oqean si mal lartësuar  
 Jetojnë njerëz të shumtë, mizëri,  
 Të trishtë, të duruar, të gëzuar;  
 Njeriu si më parë vazhdon jeton,  
 Me shqetësimet që jeta i ofron;  
 Pasionet të forta e turbullojnë,  
 Njëmijë shqetësime në shpirt i vlojnë, -  
 Dhe çfar' vendi... këtë zjarr, këto të gjallat  
 Emocione plot për të kënduar?

Me një sy, me një këmb', apo pa duar  
Njerëzit tani jan' duke kënduar;  
Njerëzit po këndojn', sikur organo  
Në gjoksin e tyre kanë vën' tani,  
Që vetëm britma nxjerr, britma ku nuk gjen,  
As pasion, as gëzim, as dashuri.

Ndërkaq ti vërtet vallë nuk e kupton  
Që në këtë shekullin tonë gjigant  
Plot me emocione dhe pasion  
Njeriu është shumë më i pasur?  
Çfar' është duke parë ai tani,  
Çfar' ka jetuar dhe çfar' ka shijuar,  
Dhe çfar' konsideron ai dashuri;  
Dhe me çfarë gëzohet vallë ai?

E ka parë ai të jashtzakonshmen  
Kryengritje të madhe të Tetorit,  
Ditët e viteve të rebelimit,  
Ditët e zjarrta edhe të stuhishme? –  
Gërmadhat e së vjetrës i ka parë,  
Baladat fatkeqe që bien pa kthim,  
Të Leninit vdekjen vall' e ka parë,  
Atë humbje të thellë e të pakthim?

Përse ndërlikohet kaq shumë gjithçka ...  
Së bashku me këtë të gjithën - gjithçka  
Njeriu mbetet përsëri po ai,  
Njeriu që ka shpirt, që ka dashuri.  
Këndoji njeriut, po ke mundësi,  
Sidoqofshin emocionet e tij, -  
Por për një këngë të tillë, kaq të mir' ...  
Duhet e ëmbla, e Aleksandrit lir'.  
Duhet e Aleksandrit lir' e bekuar,  
Dhe së bashku me lirën e tij në dor',

Edhe një shpirt i ndritur dhe madhështor,  
 Pa fund i madh dhe i pakufizuar. –  
 Mendja e tij duhet të jet' e shndritur,  
 Që në ditët e përleshjeve plot zjarr  
 Të dij' të ndaj' madhoren nga vogëlsit'  
 Dhe të gurgulloj' e pastër qelibar. –

Që mes zhurmave të ditës së sotme  
 Ditën që po vjen të dijë ta dalloj'  
 Dhe shpirtin e tij në rob të mos e shndrroj'  
 Të mashtruesve të zhurmshëm të dal' boj';  
 Shih me shpirt, se çfar' do të thotë të kthesh  
 Të shkuarën në të ardhme të pritshme,  
 Se çfar' do të thot', se dikur ajo dit'  
 Do të arrij' e lartë dhe e shndritshme!

Dhe vjen ai, poeti i madh, ai,  
 Poeti i ri prej nesh ëndërruar,  
 Që do t'i këndojë njeriut të ri  
 Madhështis', zjarrit dhe thellësis' së tij.  
 Me lirën e tij prej bakri punuar  
 Frymën e shekullit ton' të madh këndon,  
 Shpirtrat me zjarrin e shenjtë përvëlon –  
 Dhe lirën e vet kurrë nuk e tradhton!

Un' mbarova. – Nata është e thellë. –  
 Dhe në këtë çast të thellë të natës  
 Mbi kokën time ngadal' ulet heshtja...  
 Foleja e të diturit Minervë.  
 Dhe zemra ime merr frymë gjallërisht,  
 S'ka pik' dyshimi në ndjenjat fisnike. –  
 Prandaj, prano, o miku im, sinqerisht,  
 Njëmijë përshëndetje poetike!...

## NË ATDHE

Male me dëbor' dhe liqene kaltëror'.  
Qiej të lartë, si ëndrrat e një shpirti.  
Qiej të thellë, porsì sytë fëminor'.  
Unë isha vetëm. Me mua ishe ti.  
Kur shushurimën e liqenit dëgjoja  
Dhe në largësitë e thella shikoja, –  
Zgjohej brenda meje një brengë e vjetër  
E ëndrrës tënde të shenjtë, si s'ka tjetër.  
Thërriste në malet me dëbor' mbuluar,  
Thërriste dikush në muzgun e trishtuar.  
Dhe nata zbret, largësitë duke mbuluar,  
Terrin hyjnor të shpirtit duke më trazuar!...



CIP Katalogimi në botim BK Tiranë

Zarenc, Jeghishe

Poezi /Eghishe Zarenc ; përkth. Berzh Piranjani.

- Tiranë : M&B, 2024,

256 f. ; 14x21 cm,

ISBN 978-9928-82-000-6

1.Letërsia armene 2.Poezia

821.19 - 1



ISBN 978-9928-820-00-6



9 789928 820006 >